# “E VËRTETA E INXHINIERËVE TË KËNETËS SË MALIQIT”

BOTIM ME RASTIN E 71 VJETORIT TË EKZEKUTIMIT TË TYRE

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

**E Vërteta e Inxhinierëve të Kënetës së Maliqit**
Ripublikuar në 2019, Tiranë
ISBN 978-9928-4553-3-8

**Autoriteti për Informim mbi Dokumentat e ish- Sigurimit të Shtetit**
Adresa: Garda e Republikës së Shqipërisë,
Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë, Shqipëri

**Konsulentë Shkencorë**
Prof. Dr. Gjergj Sinani
Dr. Mirela Sinani

**Redaktimi i materialit, përpunimi dhe formatimi për botim**
Dr. Mirela Sinani

**Design**
Grid Cartels

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
“E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit” : botim me rastin e
71-vjetorit të ekzekutimit të tyre / Autoriteti për Informimin mbi
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. – Tiranë : AIDSSH, 2019
... f. : me foto ; ... cm
ISBN 978-9928-4553-3-8

1.Sundimi komunist, 1945-1991  2.Persekutimi politik
3.Inxhinierë  4.Dokumente  5.Shqipëri

323.28(496.5) (093.2) (086)

*Botimi u përgatit në bashkëpunim të ngushtë me AIDSSH në kuadër të projektit “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”, me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe Qeverisë Italiane.*

*Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si pasqyrim i qendrimit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit.*

Ambasciata d'Italia Tirana

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

UNDP
*Empowered lives. Resilient nations.*

# “E VËRTETA E INXHINIERËVE TË KËNETËS SË MALIQIT”

BOTIM ME RASTIN E 71 VJETORIT TË EKZEKUTIMIT TË TYRE

Ripublikim 2019, Tiranë

# Falenderime

AIDSSH, falënderon për bashkëpunimin dhe punën
për përgatitjen e këtij botimi

Prof. Dr. Gjergj Sinani

Dr. Mirela Sinani

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi

M.Sc. Kejsi Ziu

Dr. Edlira Papavangjeli, PNUD

Elona Dini, PNUD

Gjon Radovani

Ardita Repishti

Ornela Arapi

# Përmbajtja

**Në vend të hyrjes** 7

- Çfarë ishte e ashtuquajtura "organizatë sabotatore" në tharrjen e kënetës së Maliqit? 8
- Dënimi i inxhinierëve të Kënetës së Maliqit dhe procesi i montuar gjyqësor 17
- Përmbajtja e dosjes 21

**Fjala e Kryetares së AIDSSH, znj. Gentiana Sula** 26

**Fjala e Avokates së Popullit , znj. Erinda Ballanca** 28

**Fajtorë pa faj**

Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist. Sonila Boçi, historiane 30

**Spiunë dhe sabotatorë**

Sakrifikimi i inxhinierëve të Maliqit dhe akuza për mision agjenturor amerikan gjatë regjimit komunist shqiptar. M.Sc. Kejsi Ziu 51

**ANEKS** 77

# Në vend të hyrjes

Në datën 21nëntor 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, në sallën e konferencave të Fakultetit së Inxhinierisë të Ndërtimit, organizoi takimin “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”.

Aktiviteti përkujtoi të dënuarit politikë që punuan për tharjen e kënetës së Maliqit, në përvjetorin e 71-të të ekzekutimit të tyre pas një farse gjyqësore të hapur në nëntor të vitit 1946.

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes së Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë, Prof. asoc. dr. Gëzim Hasko.

Kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, mbajti fjalën e rastit mbi nismën e Autoritetit në organizimin e takimeve përkujtimore që hedhin dritë mbi të shkuarën, duke ridimensionuar raportin tonë dhe të shoqërisë me të kaluarën totalitare komuniste.

Në punimet shkencore të përfaqësuesve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe të Akademisë së Studimeve Albanologjike u theksua nevoja për t'u përballur me transparencë me të shkuarën, duke konsoliduar demokracinë.

Për takimin përkujtimor AIDSSH ka zbardhur materialet arkivore që gjenden për këtë gjyq, përmes një CD me materialet e dixhitalizuara dhe zotëron një dosje të plotë me lëndë arkivore, foto, studime për ngjarjen dhe pjesë filmike për të.

Familjarë të të ekzekutuarve që morën pjesë në takimin përkujtimor ofruan gjithashtu ndihmën e tyre me kujtime, foto dhe relike të tjera.












*Foto nga aktiviteti i organizuar nga AIDSSH më 21 nëntor 2017, në përkujtim të inxhinierëve të ekzekutuar në vitin 1946.*

# Çfarë ishte e ashtuquajtura "organizatë sabotatore" në tharjen e kënetës së Maliqit?

Cilët ishin personat që u akuzuan si pjesëtarë të saj? Çfarë formimi kulturor dhe profesional kishin ata? A kishte realisht një organizatë të tillë apo ishte një skenar që i shërbeu regjimit të kohës për të arritur qëllime të caktuara?

Këto janë disa nga pyetjet me të cilat, sot, kushdo që kërkon sado pak të vërtetën e kësaj ngjarjeje, kthen sytë nga e kaluara dhe përpiqet të gjejë përgjigje. Përgjigjet e plota shpesh është e vështirë të gjenden në dokumente, pasi dokumentet janë të mangët ose edhe të falsifikuar. Ato mund të formulohen vetëm pas një njohjeje të plotë të të gjitha fakteve të dokumentuara e të analizuara me kujdes.

E ashtuquajtura "organizatë tekniko-sabotatore", sipas akuzës që ndërtoi shteti i asaj kohe, kishte në përbërjen e saj këta persona:

Abdyl Sharra, 35 vjeç, lindur në Vlorë 1911, me banim në Durrës, me profesion inxhinier, i martuar, me dy fëmijë.

- Kishte kryer shkollën teknike të "Robert College" në Stamboll dhe Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Romë.
- Pas çlirimit i ati i tij u arrestua ca kohë, kurse i vëllai u dënua nga gjyqi i popullit si kriminel lufte.
- Ishte emëruar me detyrën e kryeinxhinierit në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.
- Më 1 tetor 1946 u arrestua.

*Akuza:* "armik i popullit, si nxitësi kryesor i sabotimeve në stil të gjerë për ndërmarrjet e mëdha që bënte pushteti popullor".
*Dënimi:* Varje në litar

Kujtim Beqiri, 30 vjeç, nga fshati Velçë i Vlorës.

- Bir i një familjeje patriotike. I ati i tij kishte qenë pjesëmarrës aktiv në ngritjen e flamurit në vitin 1912 në Vlorë si edhe në Luftën e Vlorës më 1920.

## Abdyl Sharra



*Akuza*: "armik i popullit, si nxitësi kryesor i sabotimeve në stil të gjerë për ndërmarrjet e mëdha që bënte pushteti popullor".

**Dënimi: Varje në litar**

## Kujtim Beqiri



Bir i një familjeje patriotike. I ati i tij kishte qenë pjesëmarrës aktiv në ngritjen e flamurit në 1912 në Vlorë si edhe në Luftën e Vlorës.

**Dënimi: Varje në litar**

## Zyrika Mano



U akuzua për lidhje dhe kontakte të herëpashershme me agjentët e UNRRA-s dhe me anëtarin e Misionit Civil Amerikan në Shqipëri, Harry Fultz.

**Dënimi: Pushkatim**

## Pandeli Zografi



Me detyrë gjeometër në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: Burgim i përjetshëm**

## Mario Guarnieri



Shtetas italian, me detyrë gjeometër në kënetën e Maliqit.

**Dënimi: Burgim i përjetshëm**

## Eugjenio Skaturo



Shtetas italian, me detyrë llogaritar në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: Pushkatim**

## Mihal Stratobërdha



Gjeometër në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: 10 vjet burg dhe punë të detyrueshme.**

## Anastas Risto



Punëtor në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: 2 vjet burg dhe punë të detyrueshme**

## Vasil Mano



Inxhinier në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: Pushkatim**

## Jani Vasili



Punëtor në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

**Dënimi: 1 vjet burgim me kusht që të mbajë sjellje morale e politike të mira.**

- *Abdyl Sharra, me urdhër të Ministrisë së Punëve Botore u ngarkua me drejtimin e punimeve në urat e qarkut të Krujës;*
- *Në shkurt 1945 punoi për ndërtimin e dy urave të mëdha: urës së Mifolit dhe urës së Penkovës;*
- *Punoi në Durrës për riparimin e urës së drunjtë në skelë;*
- *Në prill 1946 u caktua për drejtimin e punimeve në tharjen e kënetës së Maliqit.*
- *Në korrik 1946 u transferua në Ndërmarrjen Shtetërore të Ndërtimit, Tiranë dhe u ngarkua të drejtonte punimet në kanalin e Urës së Hasan Beut në Berat.*
- *Punoi deri më 1 tetor 1946 kur u arrestua.*



*Abdyl Sharra dhe Zyrika Mano përpara trupit gjykues, nëntor 1946.*

- Në vitin 1932 filloi studimet në Shkollën Teknike në degën elektrike.
- Në vitin 1940 përfundoi studimet me Medalje të Artë në inxhinierinë civile, në profilin rruga-ura, në Universitetin e Vjenës.
- Në korrik të vitit 1946, si inxhinier, u ngarkua me detyrën e drejtorit të punimeve për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* Varje në litar

Vasil Mano, inxhinier në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.
*Dënimi:* me pushkatim

Zyrika Mano, bashkëshorte e inxhinierit Vasil Mano.

- U akuzuan së bashku për lidhje dhe kontakte të herëpashershme me agjentët e UNRRA-s dhe me anëtarin e Misionit Civil Amerikan në Shqipëri, Harry Fultz.
- Megjithëse ishte shtatzanë, Zyrika u pushkatua si armike e popullit.

*Dënimi:* me pushkatim.

Pandeli Zografi,

- Me detyrë gjeometër në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* me burgim të përjetshëm

Mario Guarnieri, shtetas italian.

- Me detyrë gjeometër në kënetën e Maliqit.



*Foto nga gjyqi*



*Foto: Vasil Mano përpara trupit gjykues.*

*Dënimi:* me burgim të përjetshëm.

Eugjenio Skaturo, shtetas italian.

- Me detyrë llogaritar në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* me pushkatim

Mihal Stratobërdha,

- Gjeometër në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* 10 vjet burg dhe punë të detyrueshme.

Anastas Risto,

- Punëtor në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* 2 vjet burgim dhe punë të detyrueshme

Jani Vasili, 16 vjeç.

- Punëtor në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit.

*Dënimi:* 1 vjet burgim me kusht që të mbajë sjellje morale e politike të mira.

***Për të dënuarit me burgim u urdhërua:***

-Konfiskimi i pasurisë së tyre personale;
-Humbja e të drejtave qytetare e politike.

***Ekzekutimi i dënimit me vdekje u vendos të bëhej në Maliq.***

# Grupi i dytë i “sabotatorëve” të tharjes së kënetës së Maliqit

Më 29 tetor 1946, organet e Sigurimit të Shtetit arrestuan inxhinierin Aleks Vasili, gjeometrin Mirush Përmeti, austriakun Hans Vala, shoferin Lambi Napuçe dhe mjekun italian Golfredo Paskual Rizo. Akuza ishte e ngjashme si për grupin e parë. Ata po gjykoheshin si armiq të popullit, sabotatorë të pushtetit dhe anëtarë të grupit të inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit1.

1. Aleks Vasili, inxhinier
2. Mirush Përmeti, gjeometër
3. Hans Vala, gjeometër austriak
4. Lambi Napuçe, shofer
5. Golfredo Paskual Rizo, mjek italian

Në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore u vendos një qeveri komuniste. Si e tillë ajo, që në momentet e para të marrjes së pushtetit, ndërmori mjaft veprime politike antikombëtare dhe në shërbim të politikave gllabëruese të Jugosllavisë titiste. Ndër këto veprime ishte edhe organizimi i një varg procesesh gjyqësore kundër shumë individëve të shkolluar në Perëndim të akuzuar për veprimtari armiqsore.

Çuditërisht, proceset gjyqësore filluan më 8 nëntor 1946, pikërisht në ditën e përvjetorit të pestë të themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila tashmë njihet dhe është faktuar me dokumenta se u krijua me iniciativën dhe në shërbim të Partisë Komuniste Jugosllave. Lidhja mes ngjarjeve ishte e plotë: PKSH me grusht të hekurt dërrmonte “armikun e klasës”. Pas dorës së PKSh ishte edhe grushti i zgjatur i PKJ që lëshohej mbi intelektualët, profesionistët e aftë, të shkolluar në perëndim dhe mbi njerëz me virtyte e atdhedashuri.

Gjyqet u kryen për një kohë tepër të shpejtë. Ato përfunduan për 10 ditë (?!). Mjafton edhe ky fakt për të venë në dyshim gjithçka ka ndodhur në ato procese gjyqësore. Gjatë atyre 10 ditëve, u trumbetua me të madhe “zbulimi” i grupit të “sabotatorëve” të kënetës së Maliqit. Orë pas ore përcilleshin njoftime nga gjyqi kundër grupit “armiqësor”duke e mbajtur opinionin publik anembanë vendit nën trysninë e mediave dhe në ankth. Mpirja e çdo rezistence dhe e çdo kundërshtimi për atë që po ndodhte, shoqëruar me ndezjen e urrejtjes popullore, i shërbente pushtetit për ta paraqitur veprimin e vet sikur gëzonte mbështetjen e mbarë popullit.

Që ngjarja të kishte ndikim sa më të madh te populli, qoftë përmes mashtrimit të organizuar, qoftë përmes frikësimit, procesi gjyqësor kundër inxhinierëve dhe punonjësve të tjerë të etiketuar “sabotatorë” u zhvillua i hapur, në kinemanë “Nacional”, e cila kohë më pas do të merrte emrin “Kinema 17 Nëntori”, me skenar të parapërgatitur gjer në detajet më të vogla. Procesi transmetohej publikisht me altoparlant dhe turma njerëzish dëgjonin si dënoheshin “armiqtë” e popullit. E gjithë

---

1.AIDSSH, F. Hetimore dhe Gjyqësore, V. 1946, D. 944-a, Procesverbali i gjyqit për të pandehurit Mirush Përmeti, Aleks Fili Vasili, Hans Vala, Rizo Paskual Golfredo, Lambi Pando Napuçe, 21-25 nëntor 1946.



*Foto nga gjyqi i inxhinierëve dhe teknikëve të Kënetës së Maliqit*

kjo situatë ndodhte përballë masave të mëdha të njerëzve të cilët, në shumicën dërrmuese, ishin edhe fare analfabetë, të mos flasim pastaj për mungesën totale të njohurive mbi parimet, normat, rregullat e një procesi gjyqësor.

Të gjitha këto aspekte dëshmuan se procesi ishte një farsë e parapërgatitur dhe njëkohësisht, një mjet i dhunshëm propagande komuniste që në çdo çast mund të kërcënonte cilindo. Gjykata me bujë shpalli dënimin me vdekje për inxhinierët e akuzuar. Jo vetëm i ashtuquajturi gjykim u krye në kohë rekord, dhe në shkelje të të gjitha rregullave të një procesi gjyqësor, por edhe vendimi u shpall menjëherë. Fatkeqësisht, po ashtu, menjëherë, u krye edhe ekzekutimi i vendimit. Që të nesërmen e shpalljes së vendimit, pra, më 19 nëntor 1946, pa dhënë mundësi për asnjë lloj apelimi të çështjes, të gjithë të akuzuarit e dënuar me vdekje u ekzekutuan në Maliq.

Ky proces gjyqësor, qartësisht i montuar, dhe ekzekutimi i grupit me inxhinierë dhe punonjës të ndërmarrjes për tharjen e kënetës së Maliqit, ishte vetëm pikënisja e një vale të re arrestimesh për spastrimin në masë të të gjithë atyre që kishin studiuar në shkolla të huaja perëndimore.

U arrestuan, menjëherë, 80 ish-nxënës të shkollës teknike të Harri Fulcit (Harry Fultz). Kjo ngjarje ndikoi edhe në përkeqësimin e mëtejshëm apo shkëputjen e marrëdhënieve me SHBA. Me këto goditje të ashpra kundër shtresave të lidhura me botën perëndimore dhe me idealin e demokracisë perëndimore, regjimi sllavo-komunist i instaluar nga PK Jugosllave në Shqipëri, po zbatonte gjithë orientimet për proletarizimin e kombit shqiptar, përmes luftës së klasave, duke goditur klasën dhe shtresat e pasura ekonomikisht apo të pasura edhe nga pikëpamja e arsimit, kulturës dhe e aftësive administruese të shtetit apo ekonomisë.

*U goditën sidomos njerëz të arsimuar në shkollën amerikane, duke minuar çdo mundësi bashkëpunimi intelektual e më gjerë me SHBA, që ishin shteti më i fuqishëm pas Luftës II Botërore, me ndikim të jashtëzakonshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare.*

Duke goditur gjithë njerëzit profesionistë të arsimuar në universitetet perëndimore, zhdukeshin njerëzit e aftë e të kualifikuar për ta mëkëmbur ekonominë e shkatërruar nga lufta, njerëzit me orientim nga kultura demokratike perëndimore që përbënin atë shtresë nga e cila mund të formoheshin elitat kombëtare. Jo vetëm kaq: U goditën sidomos njerëz të arsimuar në shkollën amerikane, duke minuar çdo mundësi bashkëpunimi intelektual e më gjerë me SHBA, që ishin shteti më i fuqishëm pas Luftës II Botërore, me ndikim të jashtëzakonshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare. Me këto veprime qeveria në pushtet shprehte orientimin e saj politik kah forcimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë, duke vijuar nënshtrimin tërësor përpara PKJ. Edhe 71 vjet pas ndodhjes, kjo ngjarje rëndon ende në ndërgjegjen tonë kombëtare.

Dënimi i të ashtuquajturit "grup i sabotatorëve të kënetës së Maliqit" ishte shembulli sesi pushteti i maskuar pas termit "popullor", nuk ngurronte që fajet dhe përgjegjësitë e veta për padijen në administrimin e shtetit dhe të ekonomisë, t'i hidhte mbi ata njerëz të cilët, me shpirt patriotik, kishin marrë përsipër kryerjen e veprave të rëndësishme edhe në kushte tejet të vështira materialo-teknike.

Qëllimi i këtij gjyqi ishte, *në radhë të parë*, vijimi i politikës së asgjësimit të intelektualëve të edukuar në shkolla perëndimore, niveli arsimor dhe intelektual i të cilëve ishte përmbi nivelin arsimor e kulturor të krerëve të qeverisë e të vetë PKSH. Për këtë arsye ata konsideroheshin rrezik potencial për regjimin e asaj kohe: Vetëm njerëzit e arsimuar mund të kuptonin çfarë fshihej pas fjalimeve me fjalë patriotike. Një pjesë e madhe e popullit ishin të rinj pa shkollë, për shkak edhe të Luftës së Dytë Botërore. Shumë prej tyre, me idealin e çlirimit të atdheut nga pushtuesit e huaj, kishin rënë në grackën e Partisë Komuniste dhe të ideologjisë komuniste, në thelb thellësisht antikombëtare, aq më tepër që kjo ideologji vinte në Shqipëri përmes armikut të kahershëm të kombit shqiptar, fqinjëve jugosllavë. Por ishin pikërisht këta të rinj të paarsimuar, që pasi dolën me armë malit për çlirimin e atdheut, u bënë vegla të bindura dhe mbështetës fanatikë të veprimeve antikombëtare të qeverisë projugosllave të Tiranës. Ndërkaq ishte çelur kalvari i përndjekjes dhe shkatërrimit të personalitetit dhe jetës së intelektualëve- truri dhe energjia burimore e përparimit të një kombi.

*Së dyti*, në vijim të nënshtrimit para PKJ-së, qeveria e Tiranës, propagandonte miqësinë me popujt jugosllavë dhe bashkimin me ta, prandaj ajo kishte urdhër të shkëpuste e prishte përfundimisht

marrëdhëniet me botën perëndimore, sidomos me SHBA- aleati më i madh i shqiptarëve, mbrojtësi i pavarësisë së shtetit shqiptar dhe i demokracisë në Shqipëri dhe ta orientonte me të shpejtë gjithë ekonominë shqiptare, por edhe vëmendjen e popullit, kah Jugosllavia titiste dhe miqësia me popujt e saj.

*Së treti*, qeveria kishte vendosur si afat për përfundimin e punimeve të tharjes së kënetës datën 1 Tetor 1946, pa marrë parasysh aspak problematikat që paraqiste një ndërmarrje bonifikuese e përmasave të tilla, pa marrë parasysh mungesën e mjeteve më elementare të punës, as mungesën e njerëzve me njohuri në këtë fushë. Qeverisë i interesonte vetëm propaganda për sukseset e arritura.

Projektimi i tharjes dhe organizimi i punës mbetën në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të atyre pak inxhinierëve dhe gjeometrave që kishin studiuar në shkollat perëndimore, të cilët, të karakterizuar nga një shpirt i rrallë patriotik për ta parë atdheun sa më shpejt të mëkëmbur e në rrugën e progresit, bënë gjithçka ishte e mundur për ta realizuar më së miri këtë punë. Realizimi konkret i projekteve u krye duke shfrytëzuar të burgosurit politikë, që duhej të punonin si skllevër në atdheun e tyre, në mes të kënetës plot shushunja, zhytur në ujë gjer në mes apo shpesh gjer në grykë, në mot të ngrohtë apo të acartë, pa asnjë kusht mbrojtës në punë, me ushqim fare të paktë e pa asnjë ndihmë mjekësore, për të tharë një kënetë mijëra vjeçare, madje, në kohë rekord e me mjetet më primitive!

Mospërfundimi i punimeve për tharjen e kënetës në afatin e caktuar nga qeveria, afat i vendosur pa asnjë analizë të kushteve të objektit dhe të punës, u përdor si pretekst për të sajuar një grup armiqësor dhe për të hapur valën e goditjeve kundër të gjithë shqiptarëve me kulturë perëndimore dhe me aspirata demokracinë e tipit perëndimor. Për këto arsye u montua akuza e sabotazhit të një vepre të madhe bonifikuese, përmes së cilës do të zhdukej një burim i madh i sëmundjes së malaries dhe do të përfitoheshin mijëra hektarë tokë për fshatarësinë.

Duke e ndërtuar në këtë mënyrë akuzën, i thuhej popullit se shkaktarët e malaries, të përmbytjeve apo të mungesës së tokës së bukës ishin njerëzit që kishin studiuar në perëndim, të shitur te të huajt. Pushteti filloi të përpunonte ndërgjegjen kolektive duke formësuar, pak nga pak, rrezikun nga Perëndimi demokratik dhe rrezikun nga njerëzit e arsimuar atje. Përballë këtij rreziku, populli me bindje të plotë, duhej të shtrëngonte radhët pas partisë komuniste dhe qeverisë që pretendonte se kishte dalë nga populli.

*Së katërti*, procesi gjyqësor i organizuar kundër të ashtuquajturit grup sabotator të tharjes së kënetës së Maliqit, u përdor edhe si mjet tepër efikas shantazhi politik: nga njëra anë përhapej frikë e terror në popull, nga ana tjetër, shantazhohej kushdo që i përkiste një shtrese të pasur apo të arsimuar në Perëndim me idealet e demokracisë perëndimore.

# Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit dhe procesi i montuar gjyqësor

Vendosja e sistemit totalitar në Shqipëri i ka fillimet e tij që para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kur gjatë luftës që u zhvillua edhe midis krahëve të ndryshëm politikë u hodhën themelet e para drejt një diktature komuniste.

Procesi i instalimit të diktaturës do të ishte një proces i përgjakshëm ku do të persekutoheshin, dënoheshin dhe ekzekutoheshin individët dhe grupet që paraqisnin rrezikshmëri për regjimin: Ata që konsideroheshin armiq potencialë. Për këtë, u ndërtua një strukturë shtetërore e kryesuar nga Partia Komuniste dhe me institucione plotësisht të kontrolluara nga vetë kjo organizatë drejtuese. Sigurimi i Shtetit dhe gjykatat ushtarake konsideroheshin si grushti i hekurt i sistemit totalitar kundër "armiqve të regjimit" me anë të cilëve u dënuan dhe ekzekutuan shumë të pafajshëm. Kryesisht këtu bënin pjesë individët e shkolluar jashtë vendit, intelektualë dhe teknicienë. Regjimi ushtroi reprezalje kundrejt klerikëve, deputetëve që kërkonin një vend demokratik dhe të lirë, qytetarëve që kritikonin politikat e regjimit, si edhe intelektualëve të etiketuar si agjentë të huaj ose sabotues.

Megjithëse shumë herë të pafuqishme kundrejt veprimeve dhe metodave të përdorura nga regjimi totalitar për të ndaluar dhe shtypur çdo mundësi rebelimi kundrejt tij, që në vitet e para pas luftës së dytë botërore, nuk ishin të pakta rezistencat e organizuara kundër regjimit komunist. Malësia e Madhe dhe Postriba janë dy nga simbolet e kësaj rezistence, që tragjikisht përfunduan me pushkatimin e shumicës së pjesëmarrësve në to dhe me valë arrestimesh e internimesh jo vetëm të familjarëve të pjesëmarrësve të rezistencës, por edhe të të afërmve të tyre.

Model kryesor për këto masa shtypëse që synonin vendosjen e kontrollit absolut mbi popullin shqiptar, zhdukjen e çdo hapësire të lirisë individuale dhe kolektive, shërbyen praktikat komuniste kundër armikut të klasës të zbatuara sidomos në Bashkimin



*Trupi gjykues në procesin e inxhinierëve dhe teknikëve të Kënetës së Maliqit*

Sovjetik, por edhe reprezaljet e kryera në Jugosllavi kundër elementëve armiqësorë, që gjoja nuk pranonin bashkim-vëllazërimin e popujve, i cili në fakt ishte nënshtrim i çdo etnie apo kombi ndaj kombit apo kombeve më të fuqishme.

Shpeshherë këto metoda goditjeje kundër njerëzve të dyshuar si armiq apo rrezik potencial u zbatuan me zell edhe më të lartë sesa në vetë Bashkimin Sovjetik. Ato ngjanin vetëm me urrejtjen me të cilën në Jugosllavinë titiste përndiqeshin dhe asgjësoheshin patriotët shqiptarë.

Ndërsa në Bashkimin Sovjetik dhe në shumë vende komuniste në lindje të Evropës disa nga kundërshtarët e regjimit u nxorën jashtë kufijve duke u dëbuar apo vetëm u përjashtuan nga aktiviteti publik, në Shqipëri, asgjësoheshin fizikisht, njësoj sikurse ndodhte në Jugosllavinë e mareshalit Tito. Organet e posaçme të shtetit krijuan incidente e kurthe me qëllim sajimin e preteksteve për arrestime, pushkatime e internime në masë. Parë në këtë këndvështrim, masat represive që u ndërmorën në Shqipëri ishin shumë herë më të rënda se në vendet e tjera të Lindjes komuniste. Raporti përkeqësohet akoma më shumë po të mbahet parasysh numri i vogël i popullsisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore apo sipërfaqja e vogël e territorit ku ndodhnin këto goditje.

Ngjarja me inxhinierët, teknikët dhe punonjës të tjerë të ndërmarrjes për tharjen e kënetës së Maliqit, arrestimi i atyre që, në atë kohë ishin ndër njerëzit më të talentuar, më të arsimuar që kishte shoqëria shqiptare e pas luftës, të diplomuar në universitetet

*Vendosja e sistemit totalitar në Shqipëri i ka fillimet e tij që para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kur gjatë luftës që u zhvillua edhe midis krahëve të ndryshëm politikë u hodhën themelet e para drejt një diktature komuniste.*

më të mira të kohës dhe procesi i montuar gjyqësor kundër tyre, është rast tipik i veprimit komunist të nënshtruar ndaj klikës titiste që ishte thellësisht antishqiptare.

Gjyqi, që filloi më datë 8.11.1946, u përdor nga regjimi për të akuzuar intelektualët si bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja si edhe shtetet përkatëse se po përziheshin në punët e brendshme të Shqipërisë.

Regjimi komunist kërkonte të zhdukte çdo detyrim që kishte përpara botës demokratike për transparencë në çështjet e politikës. Me këto akte, regjimi komunist po shkëpuste lidhjet e vendit me demokracitë perëndimore dhe po e izolonte vendin.

Vendet e demokracive perëndimore ishin të interesuara për një shtet demokratik e paqësor në Shqipëri. Ato kishin mundësi të monitoronin dhe të hidhnin dritë mbi ecurinë e proceseve demokratike dhe të lirive politike. Gjithashtu kishin edhe instrumente për ta detyruar regjimin komunist të zbatonte angazhimet që kishte për ndërtimin e një shteti demokratik. Prandaj, regjimi komunist përshpejtoi shkëputjen e lidhjeve me vendet e demokracive perëndimore, duke e futur vendin në errësirën e mosinformimit dhe të veprimeve të hapura antidemokratike.

Më shumë se një gjyq kundrejt kundërshtarëve, ky veprim ishin një demonstrim i urrejtjes sllavo-komuniste kundrejt shtresave patriotike, atyre të arsimuara e të afta t'i dilnin zot vendit dhe ta ndërtonin atë të pavarur, si edhe dëshmonte planet e regjimit për ta futur vendin nën varësinë e Jugosllavisë, si republikë e shtatë e saj, në kuadër të gjoja bashkim-vëllazërimit me popujt e tjerë jugosllavë.

Por, gjyqi ndaj inxhinierëve ishte edhe një mjet propagande për të justifikuar dështimet dhe vështirësitë që regjimi komunist ishte duke hasur në fushën e ekonomisë. Këta njerëz pa shkollë që kishin marrë në duar drejtimin e vendit, nuk kishin asnjë fije moral të mashtronin popullin duke premtuar mirëqenie ekonomike, e nga ana tjetër, nuk ngurronin të sajonin armiq e sabotatorë ku shkarkonin fajin

për gjendjen e rëndë ekonomike të vendit. Populli ishte në një gjendje të mjerueshme. Mbyllja e kufijve dhe konfiskimi i dyqaneve, pronave apo mallrave të tregtarëve vendas kishte bllokuar qarkullimin e lirë të mallrave, furnizimin e popullit me produktet bazë ushqimore. Tatimi i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës ishte gjithashtu një politikë varfëruese, që e zhvishte tregtarin shqiptar, por jo vetëm atë, nga çdo mjet dhe rezervë ekonomike. Ndërsa për fshatarin e varfër thika kishte arritur në palcë. Reforma agrare që i dha tokën fshatarëve, shkarkoi barrën e përgjegjësisë për mungesën e ushqimit te vetë fshatarësia. Me mjete primitive dhe me krahë pune ishte e pamundur të sigurohej punimi i tokës dhe sasia e nevojshme e prodhimit për të siguruar bukën e gojës. Mungonin punimet bonifikuese, kanalet ujitëse, plehrat, dezinfektantët për mbrojtjen nga insektet, brejtësit, preparatet kimike për mbrojtjen nga infeksionet e ndryshme, farërat e mira të përshtatshme për klimën vendase si dhe asistenca e duhur me profesionistë në bujqësi e blegtori. Në kushtet e mungesës së mekanikës bujqësore, toka e ëndërruar në shekuj, nga shpëtim u bë shumë shpejt një barrë e rëndë për fshatarësinë.

Në këtë situatë varfërie të gjithanshme, gjyqi kundër inxhinierëve shërbeu si mjet për orientuar dhe shkarkuar tensionin social te “armiku i popullit” dhe njëkohësisht, shërbeu si mjet psikologjik terrorizues për të frikësuar kudo intelektualët që të nënshtroheshin pa kushte. Ai synonte të përhapte ndjenjën e frikës duke treguar se kushdo që ngrihej kundër regjimit do të kishte fatin e inxhinierëve të kënetës së Maliqit. Ky gjyq është model i proceseve të montuara gjyqësore nga një regjim komunist. Torturat çnjerëzore dhe metodat antiligjore që hetuesit përdorën ndaj inxhinierëve dalin qartë nga dosjet hetimore, procesverbalet dhe dëshmitë e marra në kushte aspak normale. Aty vërehet se si të akuzuarit si armiq detyrohen të pranojnë akuzat e fabrikuara nga mekanizmat shtetërorë të regjimit komunist, ndonëse ata ishin njerëz të ndershëm, të përkushtuar ndaj profesionit dhe atdheut të tyre dhe nuk kishin lidhje fare me fajet e artikuluara në gjyq.

# Përmbajtja e dosjes

Ajo që bie në sy nga shfletimi i dosjes është përpjekja e Sigurimit të Shtetit për t'i dhënë ngjarjes përmasa sa më të mëdha. Për këtë arsye për grupin e inxhinierëve dhe punonjësve të tjerë të akuzuar është përdorur përcaktimi "organizatë tekniko-sabotatore".

Gjithashtu, në procesverbalet e mbajtura nga ana e Sigurimit, përdoren dendur përcaktimet: "tekniko-kriminale", "organizatë agjenturore", "organizatë tekniko-sabotatore" etj, që janë qartë forma propagande.

Për t'i dhënë këtij grupi inxhinierësh e punonjësish të zakonshëm pamjen e plotë dhe karakteristikat e një organizate kriminale, dhe për ta bërë këtë gjë edhe më të besueshme në popull, Sigurimi i Shtetit shpiku edhe një element tjetër që gjoja kishte kjo organizatë: simboli dallues i saj që përdorej për t'u lidhur me njeri-tjetrin. Në dosje përmendet se anëtarët e organizatës vendosnin në krah një trekëndësh me një pikë të bardhë në mes, simbol ky që përdorej sidomos për takimet me agjentët e UNRRA-s dhe përfaqësues të misioneve të Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve.

Të gjitha dëshmitë e të pandehurve, të marra në kushte presioni dhe torturash, përshkruajnë se sabotimi i tharjes së kënetës ishte kryer me qëllim shkaktimin e dëmeve të mëdha ekonomike vendit, për qëllime politike e për llogari të Harry Fultz-it, i cili përpiqej të rrëzonte regjimin komunist të sapovendosur. Në këto dëshmi, të pandehurit përmendin se me urdhër të Harry Fultz-it dhe sipas përgjegjësive përkatëse që mbanin në kryerjen e veprës, detyrat sabotuese ishin



të ndara përkatësisht: “Abdyl Sharra duhet të sabotonte krejt punët në kanal”, duke e paraqitur këtë të fundit si organizator të sabotimeve. Ndërsa, “Aleks Vasili, duhej të sabotonte në gurore dhe të ngjallte pakënaqësira te punëtorët; Eugenio Scaturro do të sabotonte në sektorin e punës së tij, duke sjellë pakënaqësira në mencë, ose duke lënë qëllimisht pa ndrequr një vegël për 2-3 ditë” (marrë nga procesverbali i dëshmisë së Vasil Manos). Edhe dëshmitë e marra nga Kujtim Beqiri, Zyrika Mano, e cila në dosje akuzohet si përgjegjëse për kryerjen e ndërlidhjes e komunikimit ndërmjet grupit të inxhinierëve në Maliq dhe Harry Fultz-it, ripohojnë të njëjtat fakte.

Sipas procesverbaleve të mbajtura, janë zhvilluar gjithsej tri takime midis inxhinierëve dhe të dërguarit të misionit amerikan UNRRA, ku në këmbim të kryerjes së sabotimit, këta të dërguar kanë ofruar shpërblime në stërlina dhe monedha floriri. Një tjetër element interesant në dosje lidhet pikërisht me dëshmitë e shkruara dhe të firmosura nga ana e dëshmitarëve që ishin punonjës në Maliq, të cilët akuzojnë grupin e inxhinierëve për sabotim të veprës.

*Kohëzgjatja:* Proceset gjyqësore të të pandehurve filluan në datën 8 nëntor 1946 dhe përfunduan pas 10 ditësh.

*Të pandehurit përmendin se me urdhër të Harry Fultz-it dhe sipas përgjegjësive përkatëse që mbanin në kryerjen e veprës, detyrat sabotuese ishin të ndara përkatësisht: "Abdyl Sharra duhet të sabotonte krejt punët në kanal", duke e paraqitur si organizator të sabotimeve.*



VELI SHABANI

AKUZON ING.ALEKS VASININ:

1) Prej 15,000 copa gureve prej pentagonal(pese qoshesh) 1,500 jane me pak 20 cm. mepake nga te tjeret,keshtu keta nuk vihen ne pune mbasi jane te shkurter dhe nuk mund te rezistojne. Kostojne per te nxjerre dhe per te skalisur 3 fr.te reja.copa.

2) Ka bere klasifikime te kunderta me proshimin e punes. Ata qe qe kane te gote dhe qe kane proshuar me shume,mermin me pake dhe ata qe beni me pake mermin me shume,gjithemone ata t'afertit e tij. Per kete kishte krahun e djathte Anastas Ristan,kohashenues.

3) Nje motokompresor qe mund te plotesonte nevojat e gureres nuk u vu ne funksionim.Ky hapte 500 ml. diten.

4) Linjat e dekvilit te transportit te gureve prej gureres ne kanal,mbasi qe si kishte vene neregull,por shume larg,qe jane harxhuar ne dite 50 puntore per nje muaj rreshte.

*Fletë e dëshmisë së një punonjësi kundër inxhinier Abdyl Sharrës*



Dëshmitar

242

PETRAQ ISAKU

AKUZON INGINER ANDYL SHARREN, RETH KESAJ VEPRIMTARINE

1) Qe ne fillim na vune te bejme skarpatat, t'i shukurojme dhe te perdorim masterin. U pyet ing; Sharra, dhe tha: Ne bejme pune dhe politike, po kes shtu u pergjegj dhe Mihal Stratoberdha: ne i bejme per reklame.
15 dite kane punuar 750 punetore resht.

2) Kemi cere nja shtret te ri ne kume ne bage te planit, mirpo nuk filloj transporti dhe germimi nga mesi i shtertit qe ishte prej 25 metro, por fill nga ne, keshtu u bje kanal perpara dhe rezik trasporti dhe renia e njerezev duke perdorur kavaleta. Punonin 500 puntore per nje muaj resht, ndersa ke po t'ishte sistemuar dhe fillohej qe nga mesi mund te behej me nje te tr e punetoreve.

3 Nuk na kane lene te perdorim ne kanal karro, tenga, vagona, por te trasporton dhe me lopaten, duke vene si regull te punojme me shkalle. Kur nuk kishim karro dhe vagona vinin arsyen e mungeses, kur keto i kishim rrin kot.

PER ING. KUJTIMIN:

1) Nuk na lejonin t'i benim te drejta vijet e dekovillit, por te me pendece nga qellim qe te mos trasportoheshin plot vagonat dhe te beheshin punet ke pak?

2) Ne kanalin nen ure, 200 metro me poshte vuri puntori dhe nuk beshkte te benim chaselet ne nje shtret qe kishte dhe 1.20 dhe pa t'arrinte ne kuote keshtu qe pjeset e skarpatve u rezuan.

Per Mihalin

3) Ka vene puntori te beje pune jashte profilit, sikerisht kurben 2 te fun te kanalit. Kane punuar 300 puntore per 4 dit.

4) Ka punonte, puntorjen

AIDSSH

*Fletë dëshmie nga punonjës që dëshmojnë kundër inxh. A. Sharrës, K. Beqirit, M. Stratobërdhës.*

## Akt – akuza

Akt-akuza e ngritur nga prokurori vijon si më poshtë: "Grupi tekniko-sabotator ka kryer (që në verë të 1945):

- Vepra sabotazhi me stil të gjerë dhe në mënyrë sistematike
- Vepra spiunazhi në favor të agjentëve të huaj

Kanë formuar një grup tekniko-profesional për të sabotuar rindërtimin, fuqinë ekonomike të vendit dhe, si pasojë, për të përmbysur gjendjen e stabilizuar në vendin tonë, në lidhje me monarko-fashistët grekë dhe me reaksionin e jashtëm.

Më 8 nëntor 1946, Prokuroria e Gjykatës së Lartë Ushtarake dërgoi për gjykim:

- Vasil Mano (Inxhinier)
- Kujtim Beqiri (Inxhinier)
- Mario Guarnieri (Gjeometër)
- Scaturo Eugenio (Llogaritar)
- Abdul Sharra (Inxhinier)
- Pandeli Zografi (Gjeometër)
- Zyrika Mano
- Jani Vasili
- Anastas Risto
- Mihal Stratobërdha (Gjeometër)

Në akt-akuzë theksohej se: "Të gjithë të pandehurit e mësipërm që kanë qënë me përgjegjësi të ndryshme për tharjen e Maliqit dhe që kanë pasur lidhje me elementë të jashtëm, janë të akuzuar se kanë kryer sabotime të rënda duke i shkaktuar shtetit dëme të mëdha". Gjithashtu, specifikohet se "për të kryer këto sabotime, të pandehurit kanë kryer mbledhje të fshehta, që u kanë raportuar të huajve rreth punimeve dhe që kanë ndjekur udhëresat e tyre për kryerjen e sabotimeve. Për gjykimin e çështjes u caktua data e sotme."

Nga terminologjia e përdorur del qartë se vendin e argumentëve juridikë e zë gjuha ideologjike. Prokuroria e Gjykatës së Lartë Ushtarake kërkoi këto dënime:

- Vasil Mano – Dënim me vdekje
- Kujtim Beqiri (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u varur në litar
- Mario Guarnieri (Gjeometër) – Burgim të Përjetshëm
- Eugenio Scaturo – Dënim me vdekje
- Abdul Shara (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u varur në litar
- Pandeli Zografi (Gjeometër) – Dënim me vdekje
- Zyrika Mano – Dënim me vdekje
- Jani Vasili – 1 vit burgim kondicional (me kusht)
- Anastas Risto – 5 vjet Burgim
- Mihal Stratobërdha – 15 vjet Burgim

Për të gjithë të dënuarit me 5 vjet e lart konfiskimin e pasurisë të luajtshme e të paluajtshme.

Ndërsa Gjykata vendosi: Fajësinë e të gjithë të pandehurve duke i cilësuar si sabotatorë dhe armiq të popullit:

- Vasil Mano – Dënim me vdekje
- Kujtim Beqiri (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u ekzekutuar në litar
- Mario Guarnieri (Gjeometër) – Dënim me burgim të përjetshëm
- Scaturo Eugenio – Dënim me vdekje
- Abdul Shara (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u ekzekutuar në litar
- Pandeli Zografi (Gjeometër) – Dënim me burgim të përjetshëm
- Zyrika Mano – Dënim me vdekje
- Mihal Stratoberdha – 10 vjet burgim, punë të detyrueshme
- Anastas Risto – 2 vjet burgim, punë të detyrueshme
- Jani Vasili – 1 vit burgim me kondicional, me kusht që të mbajë sjellje morale e politike të mira.

***Për të 5 të dënuarit me vdekje u urdhërua ekzekutimi i tyre në Maliq.***

***Për 8 të dënuarit e parë u urdhërua gjithashtu konfiskimi i pasurisë së tyre personale dhe humbja e të drejtave qytetare e politike.***

Për të 5 të dënuarit me vdekje u urdhërua ekzekutimi i tyre në Maliq.Për tetë të dënuarit e parë u urdhërua gjithashtu konfiskimi i pasurisë së tyre personale dhe humbja e të drejtave qytetare e politike.

Regjimi komunist nuk u mjaftua me kryerjen e këtij krimi. Ai internoi familjet e tyre, duke i detyruar të rrojnë në skamje e poshtërim të etiketuara si familje të armiqve të popullit. Gjithashtu, përdori gjithë makinën propagandistike të kohës, shkrimtarët dhe kinematografinë për të ndërtuar romane e filma dokumentarë të falsifikuar me temë goditjen e veprimtarisë “armiqësore” në fushën ekonomike të “sabotatorëve” të kënetës së Maliqit.

Nisur nga këto fakte, përpara historianëve dhe studiuesve është sfida e vlerësimit të saktë të dosjeve dhe e rindërtimit të së vërtetës historike në kushtet kur dosjet hetimore kanë qenë objekt i mekanizmave falsifikues të shtetit diktatorial. Për këtë arsye luan rol të madh eksperienca individuale e historianit apo studiuesit në raste të ngjashme dhe njohja e mënyrës si kanë funksionuar mekanizmat falsifikues, por edhe aftësia për të zbuluar e vlerësuar çdo detaj sado i vogël apo i parëndësishëm në dukje, që mund të shërbejë për të hedhur dritë mbi shkallën e falsifikimit të këtij gjyqi.

*Përgatiti:* Dr. Mirela Sinani

# Fjala e kryetares së AIDSSH, znj. Gentiana Sula

*Të nderuar pjesëmarrës,*

*Jam e nderuar që jemi mbledhur së bashku me ju për të kujtuar dhe hedhur dritë mbi ngjarjen që shkurtimisht njihet si ngjarja e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit, në vazhdën e punës së AIDSSH për të zbardhur ngjarje të së kaluarës totalitare komuniste që kanë lënë shenja të thella në kujtesë, jo vetëm për familjarët e viktimave, por për të gjithë bashkëkohësit. Dhe ne jemi sot së bashku pikërisht për këtë: për të treguar të vërtetat dhe për të qenë të vetëdijshëm për demokracinë e brishtë që po përpiqemi të ndërtojmë, për të rritur breza krenarë për paraardhësit e tyre, të cilët u shkolluan në Perëndim dhe u kthyen për të zbatuar dijet dhe eksperiencat e tyre për të mirën e përbashkët, për ta bërë atdheun e tyre si vendet europiane ku studiuan. Në dosjen me numër 72 të Degës së Parë të ish-Sigurimit të Shtetit, lexojmë datën e fillimit të procesit gjyqësor ndaj inxhinierëve të bonifikimit të Kënetës së Maliqit: 8 Nëntor 1946, 5-vjetori i themelimit të PKSH. Nga materialet e grumbulluara, ku vihet re se faktet mungojnë, lexojmë "plane të predeterminuara", "marrëveshje të ngushta me misionet e huaja", "salla gjyqi të mbushura plot me popull". Kemi të bëjmë me gjyqin e parë politik të regjistruar dhe të filmuar në të tëra fazat e tij: nga arresti e deri në ekzekutim. Shohim përpunimin e parë të imazheve në kuadër të propagandës komuniste që po hidhte hapat e parë për të vijuar sofistikimin në gjyqet e mëvonshme, të cilat për fat të keq, vijuan të ishin shumë të shpeshta dhe çnjerëzore. Inxhinierët e akuzuar për sabotim, kishin studiuar në Perëndim, madje me rezultate të shkëlqyera si inxhinier Kujtim Beqiri nga Vlora, i dekoruar me Medaljen e Artë në inxhinieri civile në Universitetin e Vjenës. Këta inxhinierë vërtet të talentuar kujtohen nga bashkëkohësit e tyre për punën që kryen për të plotësuar në të tërë aspektet projektimin dhe zbatimin e bonifikimit të Kënetës së Maliqit, por, gjithashtu, edhe të veprave të tjera të rëndësishme për atë kohë si, Moli i Shëngjinit, Ura e Penkovës, Ura e Rrogozhinës, Ura e Mifolit dhe ajo e Mbrostarit, disa prej të cilave i kanë rezistuar viteve. Në bashkëpunim me Arkivin e Ndërtimit kemi gjetur dhe vëmë në dispozicionin tuaj, projektet e këtyre inxhinierëve të ekspozuara në hyrje të Fakultetit që na mirëpriti dhe bashkëpunoi me ne për organizimin e këtij aktiviteti.Gjej rastin të falënderoj edhe përfaqësuesit e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, të cilët me kumtesat e tyre hedhin dritë mbi aktivitetin e këtyre inxhinierëve dhe të vërtetat e tyre parë nën këndvështrimin e duhur. Të përkujtojmë me nderim dhe respekt këta njerëz për kontributet e të cilëve duhet të jemi krenarë: Ing. Abdyl Sharra, ing. Aleks Vasili, gjeometrat Pandeli Zografi dhe Mario Guarnieri, ing. Vasil Mano dhe bashkëshorten e tij, kroaten Zyrika Mano, punëtorët Jani Vasili dhe Anastas Risto, gjeometri Mihal Stratobërdha, llogaritari italian Eugenio Scaturo, ing. Kujtim Beqiri, (mbesa e të cilit me përkushtim punoi për realizimin e këtij aktiviteti), gjeometrat Mirush Përmeti dhe Hans Vala, austriak, shoferin Lambi Napuçe dhe mjekun italian Golfredo Paskual Rizo.*

*Le të mbajmë një minutë heshtje në nderim të tyre!*
*I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!*

# Fjala e Avokates së Popullit, znj.  Erinda Ballanca



*Dua të përgëzoj organizatorët e këtij takimi që ka për synim të përkujtojë një nga ngjarjet më të tmerrshme dhe absurde të një kohe tashmë të lënë pas. Vetëm duke folur sa më shumë dhe duke ekspozuar histori si ajo e dënimit të inxhinierëve të Kënetës së Maliqit, mund të nisim të krijojmë dalëngadalë kurajën për t'u përballur me të kaluarën.*

*Vetëm duke u përballur pa frikë dhe me ndershmëri me të kaluarën, ne do të mundemi më në fund të ndërtojmë një shoqëri të drejtë, një shoqëri të hapur dhe një shoqëri që mund të prodhojë mendim dhe zhvillim.*

*Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet i angazhuar për të nxitur dhe për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet dhe nismat që kanë në misionin e tyre këtë qëllim.*

*Së pari, ne duam të shprehim mbështetjen tonë në iniciativat dhe përpjekjet për gjetjen e të zhdukurve, të ekzekutuarve pa gjyq apo atyre që nuk kanë ende sot një varr ku familjarët t'i përkujtojnë.*

*Së dyti, Avokati i Popullit i qëndron konseguent dhe mbështet të gjitha nismat që synojnë hapjen e dosjeve të kohës së komunizmit dhe vendosjen në zbatim të ligjit të lustracionit, si një vetting moral që klasa jonë vendimmarrëse dhe politike duhet të kryejë medoemos përballë shoqërisë.*

*Së treti, institucioni i Avokatit të Popullit do të mbetet një avokat i përhershëm dhe i përkushtuar në lidhje me procesin e kompensimit të ish-të përndjekurve, ish-të burgosurve politikë etj.*

*Vërtet nuk ka çmim, nuk ka dëmshpërblim që mund të shlyejë vitet e humbura të rinisë për shumë njerëz apo humbjen fizike të njerëzve të afërt për shumë të tjerë. Megjithatë, qeveritë tona duhen nxitur që të kujdesen vazhdimisht për të kthyer një pjesë sado të vogël që shteti dhe shoqëria jonë u detyrohet këtyre njerëzve.*

*Ju uroj edhe një herë për iniciativën e organizimit të këtij takimi duke ju shprehur mirënjohjen dhe respektin tim dhe të institucionit që unë drejtoj, për punën tuaj.*

# Fajtorë pa faj:

## Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist

Sonila Boçi, historiane

### Situata politike në Shqipëri gjatë vitit 1946

Viti 1946 shënoi një moment kthese në historinë e Shqipërisë, por edhe më gjerë. Kontradiktat ndërmjet Aleatëve të Mëdhenj, SHBA-së, Britanisë së Madhe, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Lufta ideologjike, shtrirja e zonave të influencës dhe imponimi i sistemeve të qeverisjes, kishte bërë që në Europë të binte ajo, që Willson Churchill-i do ta konsideronte "Perdja e Hekurt". Kjo situatë do të ndikonte drejtpërdrejt edhe në një vend të vogël si Shqipëria.

Sa i takon politikës së brendshme në Shqipëri, fitorja në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese i dha një lloj qetësie udhëheqjes komuniste shqiptare. Ajo kishte përmbushur me këto zgjedhje objektivin e saj të parë, legjitimimin e pushtetit. Zgjedhjet kishin qenë kushti kryesor i Aleatëve Perëndimorë për ta njohur qeverinë e re shqiptare dhe për të vendosur me të marrëdhënie diplomatike. Shpallja e Republikës Popullore më 11 janar 1946 dhe miratimi i Statutit të saj më 14 mars të po atij viti, sanksionuan juridikisht programin e Frontit, por mandati popullor i "pushtetit popullor" mbetej i diskutueshëm për shkak të paketës ligjore me të cilën u organizuan zgjedhjet; rasteve të manipulimeve të rezultatit të tyre dhe, mbi të gjitha, për shkak të 20 deputetëve të çmandatuar, të burgosur apo të ekzekutuar gjatë asaj legjislature. Pavarësisht kësaj, zgjedhjet kishin hapur rrugën për të përmbushur objektivin e dytë edhe më të rëndësishëm, "vendosjen e një rendi të ri dhe mbajtjen e tij"[2].

2. Nicholas Pano, The People's Republic of Albania, Baltimore: The Johns Hopkins Press, 1968, f. 58.

Në fillim e vitit 1946, drejtuesit e lartë të PKSH-së dhe të qeverisë shqiptare u treguan më të vendosur në marrjen e disa masave në fushën politike dhe ekonomike[3] për forcimin e regjimit komunist në vend. Në aspektin politik, komunistët shqiptarë u treguan të ashpër dhe të prerë në krijimin e organeve politike-administrative, gjyqësore dhe ushtarake të shtetit shqiptar të kontrolluara nga PKSH-ja, që vazhdonte të qëndronte në gjysmë ilegalitet brenda Frontit Demokratik. Në fushën ekonomike, u ndërmorën hapa për krijimin dhe forcimin e sektorit shtetëror në ekonomi, nëpërmjet shpronësimeve të të huajve dhe atyre që u cilësuan bashkëpunëtorë të pushtuesit. Ekonomia po organizohej sipas parimit të "centralizimit ekonomik", megjithëse ende ekzistonte prona private, sigurisht nën kontrollin e rreptë shtetëror. Regjimi miratoi dhe filloi të zbatonte një sërë projektesh ambicioze, si: ndërtime rrugësh, hekurudhash, tharje kënetash, të cilat kërkonin burime të mëdha financiare, por edhe mobilizim të gjerë njerëzor. Regjimi komunist krijoi në këtë mënyrë shtresën e vet mbështetëse politike dhe ekonomike.

Më 21 shkurt 1946 u mblodh Plenumi V i KQ të PKSH-së, i cili diskutoi dhe vendosi për rrugët dhe zhvillimet e ardhshme të Shqipërisë. Në Plenum u deklarua se në Shqipëri po vendosej "një diktaturë demokratike revolucionare e punëtorëve dhe e fshatarëve me Partinë Komuniste në krye"[4]. Sipas komunistëve, sistemi ishte demokratik, sepse ishte i të gjithë popullit dhe i takonte popullit që të luftonte kundër klasave që ishin dje në fuqi, feudalëve dhe borgjezëve, të cilët kishin ende pozita me rëndësi në duart e tyre. Në këtë proces, detyra e partisë ishte të ndërgjegjësonte masat për misionin e ri që kishin. Plenumi shpalli kështu zyrtarisht luftën e klasave, si themelin ku do të mbështetej shteti i ri, luftë kjo, që u shndërrua në një nga plagët më të rënda për të gjithë shoqërinë shqiptare gjatë gjithë diktaturës komuniste.

3. Për më tepër shih: Dokumenta kryesore të PPSH ..., vëll. 1, f. 342-350, nga konkluzionet dhe vendimet e Plenumit V të KQ të PKSH, 21 shkurt 1946.
4. Dokumenta kryesore të PPSH ..., vëll. 1, f. 342, nga konkluzionet dhe vendimet e Plenumit V të KQ të PKSH-së, 21 shkurt 1946.

Lufta e klasave në Shqipëri mori përmasa të mëdha. Objekt i saj nuk ishin vetëm bashkëpunëtorët e pushtuesit apo kriminelët e luftës, por edhe shtresat e pasura të shoqërisë, borgjezët, fisnikëria e tokës, krerët e malësive të Veriut, dhe të gjithë ata që nuk i miratonin apo u mungonte entuziazmi për reformat që po ndërmerrte qeveria e re shqiptare.

## Këneta e Maliqit dhe projekti për tharjen e saj

Këneta e Maliqit zinte një sipërfaqe shumë të madhe toke dhe ishte bërë burim sëmundjesh malarike për të gjithë atë zonë. Plani për tharjen e saj ishte hartuar në vitin 1936, nga inxhinieri italian Angelo Omodeo. Plani ishte me të vërtetë ambicioz. Ai parashikonte hapje dhe sistemimin e dy kanaleve, të poshtëm dhe të sipërm, sistemimin e lumit të Devollit dhe përroit të Dunavecit, si dhe ndërtimin e disa kolektorëve kryesorë. Në përfundim të këtij projekti parashikoheshin të thaheshin 4500 ha tokë dhe të bonifikoheshin 4500 të tjera[5]. Sipas ekspertëve të kohës, plani i Omodeos ishte mjaft i detajuar sa u takonte punimeve për hapjen e dy kanaleve, ndërsa për pjesën tjetër projekti kishte të dhëna të përgjithshme dhe pa specifikimet e nevojshme[6].

Në fillim të vitit 1946, Ministria e Punëve Botore, e bazuar në projektin e Omodeos, hartoi një plan pune për tharjen e kënetës së Maliqit. Sipas Subi Bakirit, drejtuesit politik të ngarkuar për ndjekjen e punimeve për tharjen e kënetës së Maliqit, ministria nuk kishte bërë një studim paraprak mbi planin e Omodeos, por e kishte marrë atë të mirëqenë dhe kishte filluar punën duke u bazuar te ky[7]. Koha tregoi

5. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 3, Fl. 1, Relacion nga Maliqi për KQ të PPSH mbi zhvillimin e punimeve për tharjen e Kënetës së Maliqin që nga fillimi 6 maj deri më 15 shtator 1946, Dt. 24.9.1946.
6. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 3, Fl. 1, Relacion nga Maliqi për KQ të PPSH mbi zhvillimin e punimeve për tharjen e Kënetës së Maliqin që nga fillimi 6 maj deri më 15 shtator 1946, Dt. 24.9.1946.
7. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 3, Fl. 1, Relacion nga Maliqi për KQ të

**Sipas planifikimit paraprak, tharja e kënetës së Maliqit do të bëhej brenda 180 ditëve, duke nisur nga 1 maji 1946.**

**Si forca pune do të përdoreshin një numër i vogël punëtorësh me rrogë, kurse pjesa më e madhe e fuqisë punëtore do të ishin vullnetarë.**

**Komisioni i Planit të Shtetit vendosi që i gjithë projekti të mbaronte në 150 ditë, pra 1 muaj përpara kohës së planifikuar.**

**Komisioni kishte rritur numrin e vullnetarëve për tharjen e kënetës; kishte ulur me gati 50% koston e përgjithshme e projektit.**

se një studim mbi projektin kishte qenë shumë i nevojshëm. Duket se Omodeo nuk kishte qenë shumë i kujdesshëm në kalkulimet për zbatimin e projektit. Kështu, në projekt nuk ishte parashikuar që gjatë hapjes së kanalit hasej në tokë shkëmbore, si dhe në disa raste nuk ishte llogaritur mirë thellësia e kanalit. Një studim paraprak i projektit, mund t'i kishte eliminuar këto pasaktësi të projektit fillestar, por qeveria shqiptare kishte nxitim për t'i filluar sa më shpejt punimet për tharjen e kënetës. Më së shumti mund të ishin arsyet ekonomike që e nxisnin qeverinë shqiptare në ndërmarrjen e një nisme të tillë, por nuk mund të përjashtohen edhe arsyet propagandistike dhe politike. Çlirimi nga uji i një sipërfaqeje të tillë bujqësore do t`i jepte frymëmarrje ekonomisë së rajonit, por njëkohësisht do t'i bindte njerëzit në politikën e drejtë të qeverisë së re shqiptare.

Me një shpejtësi të pajustifikuar, Ministria e Punëve Botore bëri një planifikim të përafërt për koston e veprës, forcat e punës dhe makineritë e pajisjet që do të duheshin për ta përfunduar veprën. Sipas këtij planifikimi paraprak, tharja e kënetës së Maliqit do të bëhej brenda 180 ditëve, duke nisur nga 1 maji 1946. Si forca pune do të përdoreshin një numër i vogël punëtorësh me rrogë, kurse pjesa më e madhe e fuqisë punëtore do të ishin vullnetarë. Po kështu, do të përdorej edhe një sasi e kufizuar mjetesh të motorizuara, si ekskavatorë, motopompa etj. Pas shqyrtimit të këtij plani nga Komisioni i Planit të Shtetit, ai vendosi që i gjithë projekti të mbaronte në 150 ditë, pra një muaj përpara kohës që ishte kërkuar nga Ministria. Komisioni kishte rritur numrin e vullnetarëve që do të përfshiheshin në punimet për tharjen e kënetës. Gjithashtu ishte ulur me gati 50% kostoja e përgjithshme e projektit. Në përfundim të punimeve parashikoheshin të çlirohej nga uji rreth 2000 ha tokë[8].

Më 15 prill 1946 filluan punimet përgatitore për ngritjen e kantierit të Maliqit. Më 5 maj, me një ceremoni madhështore u inaugurua zyrtarisht fillimi i punimeve dhe, një ditë më vonë, filloi puna për zbatimin e një projekti ambicioz, i cili parashikohej të përfundonte më 1 tetor 1946. Për drejtimin e punimeve u caktua Abdyl Sharra, inxhinier 35-vjeçar. Ai ishte shkolluar në Stamboll, në Robert College dhe më pas kishte ndjekur studimet e larta në Torino të Italisë. Kishte punuar si specialist në Ministrinë e Punëve Botore gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më pas i ishte përgjigjur thirrjes së qeverisë shqiptare për të mobilizuar specialistët e shkolluar të vendit dhe ishte angazhuar për ndërtimin e disa urave në të gjithë Shqipërinë. Atij ju bashkuan një grup inxhinierësh dhe teknikësh, si ing. Vasil Mano, gjeometrat Pandeli Zografi, Aleks Vasili, italiani Mario Guarnieri etj.

PPSH mbi zhvillimin e punimeve për tharjen e Kënetës së Maliqin që nga fillimi 6 maj deri më 15 shtator 1946, Dt. 24.9.1946.

8. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 3, Fl. 1, Relacion nga Maliqi për KQ të PPSH mbi zhvillimin e punimeve për tharjen e Kënetës së Maliqin që nga fillimi 6 maj deri më 15 shtator 1946, Dt. 24.9.1946.

Shpejt u kuptua se projekti që Sharra kishte marrë përsipër të drejtonte, nuk varej vetëm nga mundësitë dhe aftësitë personale të tij. Ai nuk kishte forca të mjaftueshme punëtorësh të kualifikuar ku të mbështetej, nuk kishte makineri të mjaftueshme që të ndihmonin për shpejtimin e punimeve, dhe kishte mjaft llogaritje të gabuara, të cilat duheshin korrigjuar gjatë rrugës. Po t'u shtosh këtyre arsyeve edhe paaftësinë dhe mungesën e përvojës si të administratës shtetërore edhe të asaj partiake lokale, këto bënë që ritmet e punimeve të ishin mjaft të ngadalta.

Për këtë shkak, në korrik 1946 Ministria largoi nga detyra inxhinierin Abdyl Sharra për ta zëvendësuar atë me Kujtim Beqirin. 30-vjeçari kishte qenë një prej nxënësve të Shkollës Teknike të Tiranës. Ai kishte studiuar në Vjenë për inxhinieri civile dhe ishte dalluar për talentin e tij të veçantë në fushën e inxhinierisë. Kujtim Beqiri e filloi punën duke rishikuar planin e Omodeos dhe, duke u përpjekur të ndreqte të gjitha pasaktësitë dhe llogaritjet e gabuara, që gjendeshin në projektin fillestar, paraqiti një projekt të përmirësuar për tharjen e kënetës, i cili kërkonte dhe mjete e shpenzime shtesë, të cilat nga drejtuesit partiakë lokalë u konsideruan të ekzagjeruara[9].

Nga shtatori i vitit 1946 po bëhej gjithnjë e më e qartë se tharja e kënetës së Maliqit nuk do të përfundonte në kohën e duhur. Drejtuesit më të lartë të PKSH-së filluan të shqetësoheshin dhe të bënin presion për ritme më të larta.

Përgjigja që merrnin nga specialistët ishte e njëjtë: afati mund të plotësohej me fuqi të jashtëzakonshme punëtore (sipas projektit të inxhinier Konomit do të duheshin deri në 10 000 punëtorë në ditë), me makineri më të shumta dhe me fonde financiare më të mëdha, të cilat ishin të pamundura të akordoheshin.

9. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 3, Fl. 7, Relacion nga Maliqi për KQ të PPSH mbi zhvillimin e punimeve për tharjen e Kënetës së Maliqin që nga fillimi 6 maj deri më 15 shtator 1946, Dt. 24.9.1946.

**Afati mund të plotësohej me fuqi të jashtëzakonshme punëtore.**

**Sipas projektit të inxhinier Konomit do të duheshin deri në 10000 punëtorë në ditë, me makineri më të shumta dhe me fonde financiare më të mëdha.**

Më 6 shtator një Komision Kontrolli, i ngritur posaçërisht për të kontrolluar punimet për tharjen e kënetës, dërgohet në kantierin e Maliqit. Në një mbledhje maratonë u diskutua gjatë mbi problematikat e dala gjatë kësaj pune. Procesverbali i mbledhjes është një dëshmi e qartë e mungesave dhe e vështirësive të panumërta me të cilat ishte ndeshur ekipi i inxhinierëve dhe i teknikëve të Maliqit[10].

Më 30 shtator 1946, konkluzionet përfundimtare të grupit të kontrollit u analizuan në një mbledhje në Ministrinë e Punëve Botore. Grupi i kontrollit nuk mungonte të vinte në dukje parashikimet shumë optimiste të ministrisë mbi rendimentin e punëtorëve të krahut, makinerive, kostos financiare e, së fundi, dhe të parashikimit të gabuar për kohën e përfundimit të punimeve. Kontrolli akuzonte inxhinier Sharrën për sabotim të punimeve dhe kërkonte arrestimin e tij dhe të teknikut italian Mario Guarnieri[11]. Ai gjithashtu kërkonte t'i tërhiqej vërejtje me shkrim inxhinierit Aleks Vasili, gjeometrit Pandeli Zografi dhe disa të tjerëve.

10. AIDSSH, F. MPB/Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1946, D. 4, fl. 8, Procesverbal i mbajtur në mensën e kantierit të Maliqit, më 6 shtator 1946.
11. AIDSSH, F. MPB/Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1946, D. 4, fl. 35-41, Procesverbal i mbledhjes së përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve Botore mbi konkluzionet e Komisionit Special për ecurinë e punës në kantierin e Maliqit, 30 shtator 1946.

# Gjyqi i inxhinierëve të Kënetës së Maliqit - proces i ngritur mbi dyshime, por jo mbi fakte

Konkluzionet e Komisionit Special, vinin më vonë në kohë, pasi organet e Sigurimit të Shtetit u kishin paraprirë atyre. Po më 30 shtator 1946 ata arrestuan inxhinierin Abdyl Sharra, inxhinierin Aleks Vasili, gjeometrat Pandeli Zografi dhe Mario Guarnieri, bashkëshorten e inxhinierit Vasil Mano, kroaten Zyrika Mano si edhe punëtorët Jani Vasili e Anastas Risto, të cilët i akuzonin si korrierë të të parëve[12]. Arrestimi i tyre ishte hapi i parë në një skemë të madhe arrestimesh që do të vijonin përgjatë muajit tetor.

Organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk kishin nevojë për shumë prova, mjaftonte që një nga të arrestuarit të përmendte një emër gjatë procesit të dhunshëm hetimor dhe zinxhiri i arrestimeve zgjatej. Kështu, u arrestuan më pas, inxhinier Vasil Mano, gjeometri Mihal Stratobërdha dhe llogaritari italian Eugenio Scaturo, për ta mbyllur këtë fazë me arrestimin e inxhinier Kujtim Beqirit më 24 tetor 1946.

Të shtrënguar nga dhuna gjatë procesit hetimor, të akuzuarit pothuajse të gjithë pranuan akuzat e bëra. Ata akuzoheshin se kishin bashkëpunuar me anëtarin e Misionit Civil Amerikan në Tiranë, Harry Fultz, për të sabotuar tharjen e kënetës së Maliqit, me qëllim diskreditimin e qeverisë shqiptare.

12. AIDSSH, F. MPB/Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1946, D. 2, fl. 7, Relacion i Drejtorisë III rreth procesit të Maliqit, 31 tetor 1946.

Sipas të dhënave të hetimeve "puna (sabotuese) u nda si vijon: Inxhinier Sharra mori përsipër të sabotonte punën në kanal duke mos filluar punën sipas planit të parashikuar, me përdorimin e ekskavatorëve jo në pikat e nevojshme të punës, me vendosjen e forcave vullnetare jo në vendet e duhura, me humbjen e kohës dhe rendimentin me zbukurimin e skarpateve. Aleks Vasili mori përsipër të sabotonte punën në gurore duke harxhuar mjaft materiale si barut të zi, etj. Gjeometri Pandeli Zografi mori përsipër të sabotonte punën në dekovile në mënyrë që të vonohej lidhja e kanalit me guroren, e cila do të vlente dhe për pengesën e punëtorëve në gurore. Eugenio Scaturo do të sabotonte në ushqimet e mensës së punëtorëve dhe të specialistëve me qëllim që këta të mbeteshin të pakënaqur dhe të krijonin urrejtje ndaj pushtetit. Inxhinier Vasil Mano mori përsipër të sabotonte punën në kantier duke mos ngritur shpejt barakat e punëtorëve me qëllim që këta të mërziteshin e të iknin, të mos shtrëngonte teknikët për riparimin e makinerive të ndryshme që mund të kishin defekte, do të mundohej të nxirrte material jashtë përdorimit qofshin dhe me pak defekte"[13].

Më 8 nëntor 1946, në kinemanë Nacional u hap gjyqi në ngarkim të inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit. Jashtë ndërtesës së kinemasë ishin vendosur

13. AIDSSH, F. MPB/Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1946, D. 2, fl. 1, Relacion rreth procesit të Maliqit, 31 tetor 1946.

altoparlantë të mëdhenj, me anë të të cilëve qytetarët e Tiranës ndiqnin zhvillimin e gjyqit. Me porosi të veçantë të KQ të PKSH-së, punëtorët e kantierit të Maliqit duhet të ndiqnin me kujdes të veçantë gjyqin[14].

Aktakuza vinte në dukje se: "Të gjithë të pandehurit e mësipërm, që kanë qënë me përgjegjësi të ndryshme për tharjen e Maliqit dhe që kanë pasur lidhje me elementë të jashtëm, janë të akuzuar se kanë kryer sabotime të rënda duke i shkaktuar shtetit dëme të mëdha. Gjithashtu specifikohet se për të kryer këto sabotime, të pandehurit kanë kryer mbledhje të fshehta, se u kanë raportuar të huajve rreth punimeve dhe që kanë ndjekur urdhëresat e tyre për kryerjen e sabotimeve"[15].

Gjyqi nuk pati ndonjë zhvillim të papritur. Gjatë 10 ditëve të tij u dëgjuan të akuzuarit, prokurori, dëshmitarë të akuzës, avokatët mbrojtës. Të akuzuarit në përgjithësi i qëndruan deklarimeve që kishin bërë gjatë hetuesisë dhe pranuan të kishin punuar kundër "pushtetit të popullit".

Kujtim Beqiri, i cili për shkak të lidhjeve të tij me Ballit Kombëtar gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, konsiderohej nga regjimi një armik natyral. u detyrua të pranonte se kishte punuar kundër pushtetit dhe se kishte sabotuar. Në deponimet e tij ka elemente kontradiktorë. Ai pranon se kur Fultzi ka ardhur në Shqipëri, ai së bashku me Abdyl Sharrën, Namik Xhelilin dhe Beqir Çelën kanë shkuar ta takojnë. Ai pranoi se kishte simpati për SHBA-të dhe se kishte shpresuar që Fultzi do t'u jepte sqarime për gjendjen e Shqipërisë dhe për gjendjen politike "duke qenë se ishim të pakënaqur kundër pushtetit, të cilin e konsideronim provizor. Mendimet t'ona që kishim për pushtetin na i vërtetoi dhe Fultzi, i cili na tha se gjendja këtu në Shqipëri do të ndryshojë shpejt, prandaj duhet të punoni si teknikë që jeni. Neve te Fultzi vajtëm për t'i thënë mirëseardhjen, por më tepër për t'i qarë hallin kundra pushtetit"[16].

Vasil Mano në gjyq pranoi se "Kundra pushtetit kam vepruar qëkurse erdhën ata dy njerëzit e Unrrës (UNRRA). Luigj Poci, Hans Vali dhe shokët e tjerë në mbledhjet që kemi bërë më kanë thënë se nuk duhet të dëshpërohem mbasi situata do të ndërrojë, sepse aleatët nuk do të lejojë që një regjim si ky të qëndrojë në buzë të Adriatikut, prandaj kjo do të ndërrojë shpejt"[17].

Scaturo deklaroi se nuk mendonin se pushteti i vendosur në Shqipëri të kishte baza të forta "dhe shpejt mund të ndryshonte situata me ndërhyrjen e anglo-amerikanëve dhe të grekëve. Bisedonim mbi traktatet e paqes dhe thoshim se përfundimet e këtij traktati do të ishin që në Shqipëri të kishte një influencë anglo-amerikane"[18]. Bie në sy se faktet e vetme që paraqiteshin në gjyq ishin vetpranimi i akuzës, por edhe akuzat që të pandehurit bënin për njëri-tjetrin. Gjatë gjithë procesit të pandehurit bënin ç'është e mundur të lehtësonin fajësinë vetjake, duke e hedhur fajin te të tjerët.

Pandeli Zografi pranoi se "Unë kam sabotuar në vijën e dekovilave sipas udhëzimeve që merrja nga inxhinier Shara dhe nga inxhinier Manua; gjithashtu kam sabotuar në vagona tue mos i dhënë vagona Guarnierit i cili më kërkonte, kështu që punëtorët ndjenjën pa punë disa ditë"[19].

Për të mbështetur këtë pohim të Zografit, Eugenio Scaturo deklaroi se Zografi se "ka zgjatur vijën e dekovilit 200-300 metra dhe mandej e ka shkulur,

14. AQSH, F. 14/AP, V. 1946, D. 159, fl.51. Radiogram i Pandi Kristos, drejtor i drejtorisë së organizimit të KQ të PKSH për të gjitha komitetet e PKSH në qarqe, 9 nëntor 1946.
15. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore e gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 5. Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946,
16. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 14. Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
17. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 3. Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
18. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 8, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
19. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 9, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.

këtë e ka bërë me qëllim sabotimi dhe për zgjatjen e punës; këtë veprim e ka bërë tek kthesa e rrugës Korçë-Pogradec. Nga kjo u shkaktua një dëm prej 4000-5000 franga. Ky ka sabotuar gjithashtu dhe në lokomotivat tue vonuar riparimin e tyre me pretekse se mungonin pjesët e shkëmbimit; edhe kjo punë bëhesh për vonimin e punimeve dhe të transportit të gurëve me të cilët do të mbuloheshin anët e kanalit; kështu që me afrimin e vjeshtës nga mos mbulesa e skarpateve do shkaktohesh rënia e dheut dhe kështu e gjithë puna do të shkonte kot. Ky ishte sabotim në stil të gjerë"[20].

Ndërsa Vasil Mano shtoi se "Pandeli Zografi sabotonte dhe duke futur grindje ndërmjet lokomotivistëve të cilët dhe janë ankuar"[21].

Interesant është një pohim tjetër i Eugenio Scaturos, ekonomisti italian që nuk fliste shqip, por në gjyq deklaroi se "inxhinier Shara, inxhinier Manua dhe Pandeli Zografi shpesh herë në bisedime përdornin termat Berat dhe Egjip të cilat duhet t'ishin parullat që kishin midis tyre"[22].

Duke qenë se deklarimet që po bënin në gjyq mund të kundërshtoheshin nga deklarimet që kishin bërë të akuzuarit në mbledhjen e zhvilluar me Komisionin e Kontrollit, Kujtim Beqiri në gjyq deklaroi se "Kur erdhi Komisioni i Kontrollit neve duke parë që ishim në rrezik vendosëm të pakësonim veprimtarinë tonë të sabotimit. Komisioni na pyeti një nga një për mungesat që qenë bërë në kohën e Sharrës. Me rastin e ardhjes së Komisionit kemi bërë një mbledhje, ku vendosëm se si do përgjigjeshim përpara Komisionit. Unë si i ri që jesha do të flitja në mënyrë teknike. Inxhinier Manua do ta shante Sharrën. Pandeli Zografi do të bënte rolin e budallait, sikur nuk dinte gjë. Inxhinier Aleks Vasili do ta mbronte Sharrën" Meqenëse Manua nuk e mbrojti Sharrën u zu me Aleksin, i cili i tha që burrat nuk fjalosen kështu[23].

Në dosjen hetimore gjenden fakte që nuk përputhen apo që kundërshtojnë njeri-tjetrin. Kjo dëshmon moskokëçarjen e hetuesve për saktësinë e fakteve, por interesin e tyre për dënimin e "armiqve". Kujtim Beqiri pohoi në gjyq që ishin paguar nga Misioni Amerikan për sabotimet në Maliq. "Nga Fultzi kemi marrë të holla. – pohoi ai. Inxhinier Shara ka marrë 150 napolona flori (stërlina) dhe unë kam marrë 200 (napolona flori) stërlina, këto të holla i përdorim për t'ua dhënë personave që bashkëpunonin me ne në veprimet e sabotimit. Këto të holla na i ka dhënë vetë Fultzi personalisht. Pseudonimi i Fultzit nuk më kujtohet"[24].

Mirëpo një pjesë e mirë e të pandehurve, duke përfshirë dhe Zyrika Manon, e cila akuzohej si ndërlidhësja ndërmjet grupit të "sabotatorëve" dhe Fultzit, nuk pranuan të kishin marrë para nga ky i fundit. Fjalës së Kujtim Beqirit se Zyrika i kishte sjellë nga Fultzi 50 napolona flori, Zyrika i përgjigjet se "nuk është e vërtetë që unë t'i kem prurë Kujtimit të holla nga Fultzi. Të tetë napolonat flori që m'u gjendën në çantë i kam patur nga burri"[25]. Po kështu, Abdyl Sharra deponoi se i kishte dërguar tre letra Fultzit me anë të Zyrika Manos, ndërkohë që Zyrika i kujtoi se ajo vetëm një herë kishte qenë në Tiranë dhe se "Sharra një letër ia dha vetë personave të Misionit Amerikan që erdhën në Maliq"[26]. Qartazi Zyrika Mano ngatërronte përfaqësuesit e UNRRA-s me ata të Misionit Civil Amerikan, gjë që të bën më shumë të dyshosh për lidhjet e saj me këtë të dytin.

Shumë detaje për takimet apo punën sabotuese nuk përputheshin. Në shumicën e rasteve ndërhyrjet

20. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 8, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
21. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 8, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
22. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 9, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
23. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 15, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
24. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 16, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
25. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 17, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
26. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 16, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.

e prokurorit për të theksuar faktet nuk janë të karakterit juridik, por më shumë të karakterit politik, me qëllim formësimin e opinionit publik mbi tradhtinë e të pandehurve. Gjatë deponimit të Abdyl Sharrës, prokurori ndërhyri disa herë. Një nga këto ndërhyrje ishte për të lexuar një deklaratë të 26 inxhinierëve të tjerë, të cilët "kërkojnë nga gjykata e popullit dënimin e rreptë të tradhtarëve"[27]. Në një tjetër ndërhyrje prokurori theksonte: "Të pandehurit pretendojnë këtu se u mashtruan nga të huajt, po a nuk i panë këta veprimet e të huajve që kanë bërë kundra interesave të popullit tonë [?]"[28] dhe në vijim lexon një telegram të punëtorëve të Maliqit kundër të akuzuarve.

Pavarësisht këtyre gjyqi përfundoi ashtu siç ishte paravendosur. Të gjithë të akuzuarit, me përjashtim të gjeometrit italian Mario Guarnieri, e pranuan akuzën për sabotim dhe kërkuan mëshirën e trupit gjykues[29]. Shumë prekëse ishte fjala e fundit para gjyqit e inxhinierit Vasil Mano, i cili nuk kërkoi mëshirë për vete, por për bashkëshorten e tij, Zyrikën. Mario Guarnieri ishte i vetmi që nuk pranoi edhe sabotimin në Kënetën e Maliqit. "Mua m'u caktua nga inxhinier Manua eskavatorët, vumja e piketave dhe shpërblimi i punës. Neglizhencat që bëheshin nuk i kam konsideruar sabotime, pasi nuk dija se bëheshin sabotime dhe nuk më ka folur njeri. Punët që bëheshin pa kriter i konsideroja neglizhenca, si p.sh. përdorimi i ekskavatorëve dhe keq caktimi i punës; gjithashtu në një punë që nuk kishte mbaruar ende, hiqej ekskavatori dhe dërgohej në një vend tjetër e mandej kthehej përsëri po në atë punë"[30].

Gjykata vendosi fajësinë e të gjithë të pandehurve duke i cilësuar si sabotatorë dhe armiq të popullit. Dy drejtuesit e punimeve për tharjen e kënetës së Maliqit,

**Shumë detaje për takimet apo punën sabotuese nuk përputheshin. Në shumicën e rasteve ndërhyrjet e prokurorit për të theksuar faktet nuk janë të karakterit juridik, por më shumë të karakterit politik, me qëllim formësimin e opinionit publik mbi tradhtinë e të pandehurve**

Abdyl Sharra dhe Kujtim Beqiri, u dënuan me varje në litar; inxhinier Vasil Mano, bashkëshortja e tij Zyrika dhe llogaritari italian Eugenio Scaturo u dënuan me pushkatim; gjeometrat Pandeli Zografi dhe italiani Mario Guarnieri me burgim të përjetshëm; gjeometri tjetër, Mihal Stratobërdha, u dënua me 10 vjet burg dhe punë të detyrueshme; punëtori Anastas Risto me 2 vjet burgim e punë të detyrueshme; ndërsa 16-vjeçari Jani Vasili u dënua "1 vit burgim me kusht që të mbajë sjellje morale e politike të mira". Për të dënuarit me burgim u urdhërua gjithashtu konfiskimi i pasurisë së tyre personale dhe humbja e të drejtave qytetare e politike. Ekzekutimi i dënimit me vdekje u vendos të bëhej në Maliq.

Ky proces mbylli siparin e një akti të tragjedisë që po fillonte të luhej në kurriz të njerëzve të shkolluar dhe të kualifikuar të Shqipërisë, por ky nuk do të ishte i fundit. Organet e Sigurimit të Shtetit kishin vendosur ta shfrytëzonin mirë këtë ngjarje për të eliminuar të gjithë kundërshtarët potencialë të regjimit komunist. Në një relacion që Drejtoria III e MPB ia dërgonte eprorëve të tyre ata shprehimisht pranonin se: "Synojmë të zbulojmë sabotimet që janë bërë në qarqe të tjera, lidhjet që këta kanë pasur në Tiranë, elementët dhe agjentët e tyre nëpër qarqe, kur janë organizuar, nga kush dhe kohën kur janë organizuar,

27. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 23, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
28. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 24, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.
29. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore e gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 31, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946,
30. AIDSSH, F. MPB/Dosjet hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1080-A, fl. 118, Procesverbali i gjyqit të sabotatorëve të Maliqit, 8-18 nëntor 1946.

*Synojmë të zbulojmë sabotimet që janë bërë në qarqe të tjera, lidhjet që këta kanë pasur në Tiranë, elementët dhe agjentët e tyre nëpër qarqe, kur janë organizuar, nga kush dhe kohën kur janë organizuar, deri ku do të veprohej në këtë drejtim, ku i kanë pasur bazat, si shtrohej falimentimi i qeverisë në lidhje me sabotimet dhe cilët kanë qenë elementët në qeveri"*

deri ku do të veprohej në këtë drejtim, ku i kanë pasur bazat, si shtrohej falimentimi i qeverisë në lidhje me sabotimet dhe cilët kanë qenë elementët në qeveri"[31]. Ata këshillonin të vazhdonin arrestime të tjera në Maliq dhe të gjendeshin lidhjet që inxhinierët dhe teknikët e Maliqit mund të kenë edhe me inxhinierë dhe teknikë në Ministrinë e Punëve Botore në Tiranë, apo gjetkë në Shqipëri. Kështu, ende pa mbaruar procesi i parë i Maliqit një tjetër proces po ndërtohej. Më 29 tetor 1946, organet e Sigurimit të Shtetit arrestuan inxhinierin Aleks Vasili, gjeometrin Mirush Përmeti, austriakun Hans Vala, shoferin Lambi Napuçe dhe mjekun italian Golfredo Paskual Rizo. Akuza ishte e ngjashme si për grupin e parë. Ata po gjykoheshin si armiq të popullit, sabotatorë të pushtetit dhe anëtarë të grupit të inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit[32].

Më 21 nëntor 1946, po në sallën e kinemasë Nacional filloi gjyqi i hapur edhe për këtë grup. Gjatë zhvillimit të gjyqit, ata pranuan hapur që nuk kishin simpati për regjimin e vendosur në Shqipëri, ata gjithashtu pranuan se në Maliq punët nuk kishin ecur siç duhet, kishte pasur vonesa, mungesë organizimi etj., ata, madje, e konsideruan veten fajtorë që nuk kishin folur më herët për këto problematika që kishin vënë re në Maliq, por në përfundim të procesit ata nuk pranuan që të kishin sabotuar dhe të kishin qenë pjesë e ndonjë grupi sabotatorësh[33]. Mungesa e pranimit të fajësisë nuk e pengoi prokurorin e çështjes të kërkonte dënim me vdekje për inxhinier Aleks Vasilin dhe gjeometrin Hans Vala dhe burgime të rënda për tre të tjerët. Ajo nuk e pengoi as gjykatën, që në përfundim të gjyqit, të jepte dënim me vdekje për inxhinier Aleks Vasilin dhe gjeometrin Mirush Përmeti. Hans Vala, gjeometri austriak, i cili kishte punuar në shumë zona të Shqipërisë që prej vitit 1940, u dënua me 30 vjet burgim, mjeku italian Golfredo Rizo me 10 vjet burgim dhe Lambi Napuçe me 5 vjet.

31. AIDSSH, F. AMPB/Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1946, D. 2, fl. 8, Relacion rreth procesit të Maliqit, 31 tetor 1946.

32. AIDSSH, F. AMPB/Hetimore dhe Gjyqësore, V. 1946, D. 944-a, Procesverbali i gjyqit për të pandehurit Mirush Përmeti, Aleks Fili Vasili, Hans Vala, Rizo Paskual Golfredo, Lambi Pando Napuçe, 21-25 nëntor 1946.

33. AIDSSH, F. AMPB/Hetimore dhe Gjyqësore, V. 1946, D. 944-a, Procesverbali i gjyqit për të pandehurit Mirush Përmeti, Aleks Fili Vasili, Hans Vala, Rizo Paskual Golfredo, Lambi Pando Napuçe, 21-25 nëntor 1946.

# Reflektime mbi një proces që nuk duhej të ndodhte

Gjyqi kundër inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit është një proces që nxit një reflektim të thellë mbi sistemin e drejtësisë gjatë regjimit komunist, por edhe mbi marrëdhëniet e këtij regjimi me individët. Pa hyrë në një analizë juridike të procesit, nuk mund të mos vë në dukje disa fakte lehtësisht të dallueshme:

Së pari, gjatë procesit të hetuesisë dhe atij gjyqësor në asnjë rast nuk u paraqit asnjë provë konkrete. U fol për mbledhje dhe takime të grupit të "sabotatorëve", por nuk u dhanë prova mbi bisedat e zhvilluara në këto takime. Të gjithë të akuzuarit flisnin me fjalë të përgjithshme dhe përsërisnin ekzaktësisht njëri-tjetrin. Po kështu, nuk u dha asnjë provë mbi takimet e anëtarëve të këtij grupi me anëtarin e Misionit Amerikan në Tiranë, Harry Fultz. Duke qenë se Sigurimi i Shtetit ndiqte nga afër të gjithë lëvizjen e z. Fultz, madje dhe të vajzës së tij, Joanës, nuk do të ishte e vështirë të gjendeshin prova për këto takime dhe shkëmbime korrespondence.

Së dyti, gjatë procesit nuk u morën parasysh një numër shumë i madh dokumentesh e letërkëmbimesh, të cilat dëshmojnë se gjatë muajve maj-shtator vazhdimisht të akuzuarit kishin ngritur problematikat që lidheshin me vështirësitë, ndonjëherë dhe të pakapërcyeshme, që ata hasnin në punën e tyre të përditshme. Ata nuk morën parasysh konkluzionet e Komisionit Special të Kontrollit, i cili pranonte që preventivat mbi normat e punës ditore të një punëtori ishin të ekzagjeruara, që projektet paraprake kishin pasur llogaritje të gabuara, madje dhe që data për përfundimin e punimeve për tharjen e kënetës së Maliqit ishte shumë optimiste.

Së treti, gjyqi nuk shqyrtoi në thellësi kontradiktat që lindnin nga deklarimet e të akuzuarve, të cilat do të ishin shqetësuese për çdo njeri të logjikshëm. Në fakt ato ishin shqetësuese edhe për drejtuesit e lartë komunistë. Nako Spiru do t'i ankohej ambasadorit sovjetik në Shqipëri, D. Çuvahin për paaftësinë e hetuesve të çështjes së inxhinierëve të Maliqit, të cilët, sipas tij, e kishin kthyer procesin në qesharak.

Së katërti, procesi gjyqësor vuri theksin te takimet e inxhinierëve Sharra dhe Beqiri me Fultzin që në prill të vitit 1945, kohë kur të dy inxhinierët ishin të angazhuar me rindërtimet e disa urave dhe të veprave të tjera në Shqipëri. Lind pyetja: Nëse kërkesa e Fultzit ishte për të sabotuar, atëherë, përse këta inxhinierë nuk sabotuan edhe në këto vepra, që u kryen më parë sesa tharja e kënetës së Maliqit?

Të gjithë ata që kanë rast të lexojnë dokumentët mbi procesin e Maliqit, nuk e kanë vështirë të kuptojnë manipulimet që gjenden në të. Ajo që duhet analizuar janë arsyet se përse i shërbeu regjimit në Shqipëri një proces i tillë i montuar. Siç u përmend dhe në fillim, viti 1946 ishte viti, në të cilin maska e regjimit u rrëzua. Ndërsa, deri atëkohë, për të bindur Aleatët Perëndimorë për njohjen e regjimit të ri dhe për të siguruar mbështetjen maksimale në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, regjimi kishte qenë disi më i kujdesshëm, tanimë, ai nuk kishte më nevojë të fshihte qëllimet e tij. Ai iu vu punës për të zbatuar programin e tij ekonomik dhe politik, një pjesë e rëndësishme e të cilit ishte zbatimi i luftës së klasave, e cila përkthehej në eliminimin e të gjithë kundërshtarëve të shpallur apo dhe të atyre potencialë.

**Punimet për tharjen e kënetës së Maliqit vijuan përtej vitit 1946.**

**Edhe në fund të viteve ’50, nuk ishte bërë e mundur që këneta të thahej plotësisht.**

**Në vitin 1959, nisi aplikimi i projektit të një inxhinieri rus, që do të realizonte përfundimisht tharjen e kënetës.**

Gjatë vitit 1946 u zhvilluan një sërë procesesh gjyqësore, përfshirë gjyqin ndaj klerikëve të lartë katolikë, apo gjyqin e grupimit socialdemokrat, monarkist dhe të rezistencës, në përbërje të të cilit ishin disa nga intelektualët më të spikatur në vend, si Musine Kokalari, Gjergj Kokoshi, avokat Fuad Asllani e shumë të tjerë. Dëshmitë e misioneve të huaja, që gjendeshin në Shqipëri në atë kohë, flasin për lëvizje të shumta të trupave ushtarake shqiptare drejt Veriut të vendit, për të vendosur nën kontroll grupet e kundërshtarëve të regjimit[34]. Regjimi shihte te njerëzit e shkolluar në universitetet më të mira të Europës, kundërshtarët e tij realë dhe u tregua shumë agresiv për neutralizimin e tyre. Në këtë kategori bënin pjesë, padyshim, edhe inxhinierët e dënuar në procesin e Maliqit.

Tharja e kënetës së Maliqit ishte një ndërmarrje e jashtëzakonshme që do të kishte ndikim sa në ekonominë e vendit, aq edhe në rritjen e prestigjit të qeverisë shqiptare në popull. Jo më kot, propaganda zyrtare e kishte trumbetuar pa rreshtur aksionin për tharjen e kësaj kënete dhe zyrtarët më të lartë partiakë i ndiqnin zhvillimet e punimeve me shqetësim të posaçëm. Koha tregoi se projekti i tejkalonte mundësitë reale të shtetit shqiptar të asaj kohe. Mungesa e makinerive, e punëtorëve të kualifikuar, paaftësia e drejtuesve lokalë, nisja e punimeve jo në kohën e duhur ishin arsyet kryesore që tharja e kënetës së Maliqit të mos kryhej dot në afatin e caktuar. Kaq e vërtetë është kjo sa edhe në muajt në vijim të gjyqit famëkeq të inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit, vështirësitë të cilat kishin kushtëzuar rendiment të ulët të punimeve vazhdonin të ekzistonin dhe ritmet e punës ishin shumë larg asaj që kërkohej.

Punimet për tharjen e kënetës së Maliqit vijuan përtej vitit 1946. Faza e parë e punimeve nuk u mbyll dot përpara vitit 1948. Ndërkohë që tharja e plotë e kënetës nuk ishte bërë e mundur edhe gjatë viteve ‘50. Në vitin 1959, një vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH-së njoftonte aplikimin e një projekti të një inxhinieri rus, i cili do të realizonte fazën përfundimtare të tharjes e kësaj kënete.

Akuza dhe dënimi i inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit ishte thjesht një mekanizëm për të kamufluar dështimin e qeverisë shqiptare në përfundimin e një projekti kaq madhor. Nga ana tjetër, ajo do të shërbente për të frikësuar popullsinë dhe për t’i bërë ata më të përulur ndaj urdhrave të drejtuesve politikë. Jo më kot u zgjodh Maliqi si vend i ekzekutimit të të dënuarve me vdekje.

Së fundi, qeveria shqiptare mund ta përdorte këtë proces për të përligjur politikën e saj ndaj SHBA-së. Gjatë vitit 1946, prirjet e qeverisë shqiptare ndaj Jugosllavisë së Titos dhe Bashkimit Sovjetik ishin fare të dukshme.

Ndërkohë, marrëdhëniet me Perëndimin po acaroheshin gjithnjë e më shumë. Incidentet në Kanalin e Korfuzit përcaktuan përfundimisht marrëdhëniet e qeverisë shqiptare me Britaninë e Madhe. Ndërsa marrëdhëniet me SHBA-në vazhdonin të ishin më të paqarta. Enver Hoxha, në disa dalje publike gjatë vitit 1946, kishte kritikuar qëndrimin e SHBA-së për mospranimin e Shqipërisë në OKB,

34. United States Department of State, Foreign relations of the United States, 1946. Eastern Europe, the Soviet Union, (1946), p. 5, Kreu i Misionit Amerikan në Tiranë, Jacobs për Departamentin e Shtetit, 4 shkurt 1946.

si dhe votën amerikane për të lejuar që në rend të ditës të Konferencës së Paqes të futej paraqitja e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së Jugut.

Propaganda zyrtare kishte ndërmarrë një fushatë të gjerë për të diskredituar Misionin Civil Amerikan në Tiranë dhe anëtarët e tij. Që prej fillimit të vitit 1946, anëtarët e këtij Misioni ishin izoluar pothuajse plotësisht nga kontaktet me njerëz të zakonshëm, ndërkohë që edhe marrëdhëniet me zyrtarët shqiptarë ishin kufizuar. Në këto kushte, duke parë prirjet pro-sovjetike të qeverisë shqiptare dhe sjelljen e saj në vijimësi ndaj SHBA-së, Departamenti i Shtetit vendosi se nuk do të ishte oportune që ta njihte qeverinë shqiptare. Më 2 nëntor 1946, Misioni Civil Amerikan në Tiranë i kërkoi qeverisë shqiptare leje për largimin e tij nga Shqipëria. Kjo shënoi shkëputjen përfundimtare të marrëdhënieve mes dy shteteve. Sa i takon akuzave ndaj inxhinierëve të Maliqit dhe lidhjes së tyre agjenturore me SHBA nuk përligjen nga dokumentacioni i konsultuar deri më tash. Departamenti i Shtetit kërkoi sqarime mbi akuzat që bënte qeveria shqiptare ndaj z. Fultz dhe Misionit Civil Amerikan. Si Fultzi, ashtu dhe anëtarë të tjerë të Misionit kanë mohuar të kenë ndonjë lidhje me akuzat e ngritura ndaj tyre në gjyqin e inxhinierëve dhe teknikëve të Maliqit. Deri më tash, nuk kemi asnjë të dhënë që të implikojë Harry Fultzin në këtë proces.

Procesi i Maliqit u kushtoi jetën shtatë njerëzve të kualifikuar, të cilët e kishin treguar aftësinë dhe përkushtimin e tyre ndaj zhvillimit dhe përparimit të Shqipërisë. Ai ishte fillimi i një kalvari të gjatë vuajtjesh për të gjithë të dënuarit dhe familjet e tyre. Për fat të keq, ky ishte vetëm një episod nga shumë e shumë të tjerë që i kushtuan Shqipërisë elitën intelektuale të vendit. Askush nga ne nuk mund të kthehet prapa në kohë për të vënë në vend padrejtësitë e së djeshmes, por ne kemi një mision shumë të rëndësishëm: T'i analizojmë me objektivitet dhe paanshmëri dëshmitë dhe faktet e së shkuarës, në mënyrë që të mos e lejojmë veten dhe shoqërinë që të bëjë sërish të njëjtat gabime.

# Spiunë dhe sabotatorë:

## Sakrifikimi i inxhinierëve të Maliqit dhe akuza për mision agjenturor amerikan gjatë regjimit komunist shqiptar

MSc. Kejsi ZIU

Që në fillimet e ekzistencës së tij, regjimi komunist në Shqipëri u karakterizua nga shkelje të së drejtave më themelore të njeriut si mjet i vazhdueshëm pune duke nisur që nga eliminimi i pronës private, te përdorimi i punës së detyruar, trajtimi çnjerëzor e poshtërues dhe burgimi, vrasja e kundërshtarëve apo individëve të tjerë të kapur në shakullinë shkatërruese të agresionit komunist. Një shembull konkret i kësaj politike thellësisht çnjerëzore e antishqiptare është arrestimi i grupit të inxhinierëve të ngarkuar me detyrën e tharjes së Kënetës së Maliqit, të akuzuar nga regjimi si sabotatorë dhe bashkëpunëtorë të spiunazhit amerikan në Shqipëri.

Disa nga çështjet për diskutim janë: A ishte grupi teknik realisht sabotues, pra, "agjent i misionit amerikan në Shqipëri" apo kjo ishte një akuzë e përdorur nga regjimi për të eliminuar ndikimin e SHBA-së në Shqipëri? A e përdori Sigurimi i Shtetit arrestimin e grupit të inxhinierëve të Maliqit për të larguar ndikimin e frymës perëndimore demokratike nga Shqipëria, dhe për ta kthyer Shqipërinë në një vend pa asnjë lloj transparence demokratike dhe llogaridhënieje për veprimet qeverisëse? Cilat ishin akuza dhe e vërteta e inxhinierit më të ri në moshë, Kujtim Beqiri? Cili ishte pozicioni dhe roli i Fultzit në Shqipëri?

### 1. Eliminimi i konceptit të pronës private nga regjimi socialist si mjet për luftën e klasave

Modeli i ekonomisë shqiptare në periudhën komuniste u përqendrua në eliminimin gradual të të gjitha formave të pronës private, nëpërmjet shtetëzimit të plotë të të gjitha degëve të ekonomisë e tregtisë dhe të kalimit




në planifikimin tërësisht të centralizuar. Instrumenti kryesor ligjor që në fillimet e shtetit komunist, ishte Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946. Funksioni kryesor i kësaj Kushtetute ishte rrëzimi i gjithë sistemit të mëparshëm të drejtësisë dhe krijimi i një sistemi të ri. Frymëzimi kryesor i hartimit të saj dhe i të gjithë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në vitet 1945-1946, ishte eksperienca e Bashkimit Sovjetik.

Me Kushtetutën e vitit 1946 u shpall : "Republika Popullore e Shqipërisë është shtet i punëtorëve dhe i fshatarëve punonjës" (neni 2), sikurse "Puna, për çdo shtetas të aftë për punë, është detyrë dhe nder sipas parimit: "kush nuk punon, nuk ha" (neni 13).

Duke e shpallur veten përfaqësuese të popullit, pra, të punëtorëve dhe të fshatarëve që kishin si mjet të vetëm jetese vetëm punën, krijohej hendeku ndarës me të gjithë shtresat që zotëronin një lloj prone dhe i hapej fushë veprimi luftës së klasave: pronarë- jo pronarë. Pasi justifikoi me kushtetutë këtë situatë të luftës së klasave, në vitet 1945-1946 shtetëzimi i pronave private nga shteti u krye me ritme shumë të shpejta dhe propaganda e kohës e konsideronte si një prej sukseseve më të mëdha të regjimit komunist.

Në Kushtetutën e 1946, neni 35, theksohej se çdo shtetas shqiptar detyrohej të ruante dhe të forconte pasurinë shoqërore (shtetërore dhe kooperativiste), e cila konsiderohej si "bazë e shenjtë dhe e paprekshme e demokracisë popullore, burim i fuqisë së Atdheut, i mirëqenies dhe i kulturës së të gjithë punonjësve". Sipas kësaj dispozite, ata që preknin pasurinë shoqërore konsideroheshin si armiq të popullit. Thellimi i mëtejshëm i luftës së klasave u sanksionua edhe në Kushtetutën e 1976, neni 4, që theksonte se: "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë zhvillon pa ndërprerë revolucionin duke iu përmbajtur luftës së klasave dhe

ka për qëllim të sigurojë fitoren përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste, të arrijë ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizmit."

Ishte kjo ideologji e luftës së klasave që u përdor masivisht për të përndjekur dhe eliminuar fizikisht shtresën e intelektualëve shqiptarë dhe të gjithë ata që nuk ishin dakord me regjimin sllavo-komunist. Në këtë shtresë intelektualësh bënin pjesë edhe disa inxhinierë dhe personel tjetër teknik që punonin në tharjen e Kënetës së Maliqit - edukimi akademik e profesional i të cilëve binte në kundërshtim me ideologjinë e regjimit komunist.

## 2. Propaganda dhe e vërteta mbi grupin e inxhinierëve të Kënetës së Maliqit

### 2.1. Skenari për "sabotim" dhe akuza publike

Siç rezulton edhe nga dosjet hetimore-gjyqësore[35], pjesëtarët kryesorë të grupit që u akuzuan për sabotim, ku bënin pjesë edhe inxhinierët drejtues të punimeve për tharjen e kënetës, ishin: Abdyl Sharra, Kujtim Beqiri, Vasil Mano, Zyrika Mano, Mirush Përmeti, Paolo Saggioti, Eugenio Scaturro, Pandeli Zografi, Aleks Vasili, Mihal Stratobërdha, etj. Dokumenti që përmban akt-akuzën e ngritur nga Prokuror Haznedari[36] i akuzoi si "organizatë tekniko-sabotatore, e cila ka kryer vepra sabotazhi me stil të gjerë dhe në mënyrë sistematike me qëllim ngadalësimin e rindërtimit ekonomik të Shqipërisë, si dhe për kryerje të veprave të spiunazhit në favor të agjentëve të huaj". A. Sharra dhe më pas, K. Beqiri ishin drejtuesit e punimeve në Kantierin e Maliqit, siç rezulton edhe nga relacionet e Sigurimit për zhvillimin e punimeve atje[37], ndërsa pjesa tjetër shërbenin si punonjës në kantier në pozicione si inxhinierë, gjeometër, llogaritar, etj. Përjashtim bënte Zyrika Mano, e cila ishte një shtetase me origjinë kroate, e martuar me njërin prej inxhinierëve, Vasil Mano. Ajo u akuzua si personi që realizonte komunikimin midis Fultzit dhe grupit të inxhinierëve. Prokuroria në këtë akt-akuzë, përveç Fultzit, implikonte dhe dy misionarë të UNRRA-s si bashkëpunëtorë në sabotim.

Implikimi i punonjësve të UNRRA-s në gjyqin dhe dënimin e grupit të inxhinierëve "sabotatorë" të Kënetës së Maliqit rezulton nga procesverbali i dëshmive të Vasil Manos dhe Kujtim Beqirit, që tregonin se punonjësit e UNRRA-s kishin ardhur 3 herë në Maliq, një herë në 15 maj, një herë në 13 qershor dhe një herë në muajin korrik, për të pyetur mbi detajet dhe statistikat e punimeve të kanalit të Maliqit[38].

E analizuar nga një pikëpamje juridike, pretenca e prokurorit fillon duke theksuar rëndësinë e veçantë që kishte ky gjyq për Shqipërinë, për nga niveli i tradhtisë që grupi i inxhinierëve kishin treguar. Sipas pretencës, nëpërmjet sabotimit me stil të gjerë, në strukturën eknomike dhe më pas politike të shtetit, synimi final i grupit të inxhinierëve, të cilët cilësoheshin "reaksionarë ndërkombëtarë", ishte të vendoste në rrezik integritetin e vendit dhe të mashtronte pushtetin dhe popullin. Pretenca nuk ka pothuajse asnjë argument juridik. Nga fillimi në fund ajo përmban një diskurs të ndikuar

35. Shih Dosja Nr.5 "Pretenca e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake mbi gjykimin dhe dënimin e grupit sabotator tekniko-intelektualë të Maliqit", Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 15.11.1946 – 25.11.1946. Shih edhe dosjen e marrë nga AQSH,"Procesi i sabotatorëve të punimeve për tharjen e liqenit të Maliqit", Tiranë, Nëntor 1946, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH.

36. Ibid.

37. Shih Dosja Nr.3 "Relacion dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi zhvillimin e punimeve për tharrjen e Liqenit të Maliqit, vështirësitë, pengesat dhe sabotimi i ing. A.Sharrës", Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 24.09.1946. Shih gjithashtu Relacionin e Sigurimit mbi zhvillimin e punimeve në Kantierin e Maliqit, 01.07.1946, f.17.

38. Shih Dosja Formulare Nr.1080/2, "Kujtim Ali Beqiri", Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr.Regj.557, Kategoria II.B TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH, fq.2). Për më shumë informacion, edhe O.Pearson, "Albania in the Twentieth Century, A History: Volume III: Albania as Dictatorship and Democracy, 1945-99", fq.113.



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
- GJYKATA E LARTË USHTARAKE -
TIRANË

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

Nr. 17 i Librit themeltar

PROÇES - VERBAL

Prokuroria e kësaj Gjykate me akt-akuzën e saj date 8/Nëndor/1946 na deferon për gjykim, bashkë me aktet, të pandehurit: 1) Ingjinier Vasil Mano, 2) Ingjinier Kujtim Beqiri, 3) Gjeometër Mario Guarnieri, 4) Scaturo Eugenio, 5) Ingjinier Abdul Sharra, 6) Gjeometër Pandeli Zografi, 7) Zyrika Mano, 8) Jani Vasili, 9) Anastas Risto dhe 10) Mihal Stratoberdha, që të gjithë t'akuzuar se duke qënë me detyra dhe punë të ndryshme në tharjen e Maliqit, të lidhur me elementa të reaksionit të jashtëm kanë kryer sabotime të rënda në punime dhe i kanë shkaktuar pushtetit dëme kolosale. Për keto sabotime kanë bërë mbledhje të ndryshme, u kanë dhënë të huajvet raporte mbi gjëndjen e punimeve dhe sabotimet e bëra dhe kanë zbatuar direktivat e tyre për vazhdimin dhe shtimin e sabotimeve.

Aktet mbasi u regjistruan nën Nr. 17 të Librit themeltar të kësaj gjykate, për gjykimin e çështjes u caktua data e sotme 9/Nëndor/1946 ora 9 para dite, duke u njoftuar të pandehurit e sipërmendur qe ndodhen t'arrestuar.

Tiranë, më 9/Nëndor/1946.

SEKRETARI:
(Aspirant Thoma Zino)

KRYETARI I KËSHILLIT
( N/Kolonel Saçe Floqi )

Sot, ditën dhe orën e caktuar, në sallën e Kinemas "Nacional" të Tiranes, Këshilli Gjyqësor i Gjykatës së Lartë për gjykimin e sabotatorëve të Maliqit u formua kështu:

N/KOLONEL SAÇO FLOQI - KRYETAR,
KAPITEN.I. [illegible] - ANTAR,
-"- [illegible] - ANTAR,

me pjesëmarrjen e PROKURORIT KAPITEN I. [illegible] dhe asistuar prej SEKRETARIT ASPIRANT THOMA ZINOS, fillo gjykimin e çështjes botërisht e faqësisht.

politikisht. Vetë prokurori nuk kishte formim arsimor në fushën e së drejtës.

Qëllimi i tij i shprehur në pretencë ishte të "demaskonte" grupin e inxhinierëve. Bie në sy fjalori i përdorur për të formuluar akuzat, paraqitja e provave të mundshme, deri përdorimi i fyerjeve kundrejt të pandehurve me cilësimet "mbeturina balliste dhe fashiste", "banditë", "katilë", "spinë të poshtër", apo cilësimet "egoist, kriminel i shitur" për Kujtim Beqirin[39], etj. , element inekzistent ky në procese gjyqësore të rregullta. Për shkak të mosekzistencës ende të një Kodi Penal, e vetmja bazë ligjore për ngritjen e akuzave ndaj të pandehurve ishte Ligji nr.21, datë 15.12.1944„ Mbi sabotatorët e Luftës Nacionalçlirimtare".

---

39. Shih Dosja Nr.5 "Pretenca e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake mbi gjykimin dhe dënimin e grupit sabotator tekniko-intelektualë të Maliqit", Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e III-të, 15.11.1946 – 25.11.1946, fq.2-3.


Technische Hochschule in Wien

Prüfungsbericht

Vorprüfungsfächer

*Fotokopje e diplomës së Kujtim Beqirit, lëshuar nga Universiteti i Vjenës.*

## 2.2. Gjyqi

Sistemi gjyqësor në 1945 ishte i ndërtuar në bazë të Ligjit nr. 41, datë 14.1.1945 “Mbi organizimin e funksionimin e gjykatave ushtarake”, neni 79 i të cilit parashikonte se drejtësia në Republikën Popullore të Shqipërisë do të jepej nga Gjykata e Lartë e Republikës Popullore të Shqipërisë, nga gjykatat popullore dhe nga gjykatat ushtarake. Gjykata e Lartë Ushtarake, që gjykonte çështjen e kënetës së Maliqit përbëhej nga tre anëtarë, përkatësisht një nënkolonel dhe dy kapitenë ushtarakë. Fillimisht kjo gjykatë krijohej si gjykatë ad hoc për të shqyrtuar dhe zgjidhur çështjet që kishin të bënin me krime të tradhtisë së lartë apo krime të tjera politike. Ajo që vihet re nga shqyrtimi i dosjes që përmban proces-

verbalet e seancave gjyqësore, është se gjyqi për "sabotatorët e Kënetës së Maliqit" zgjati vetëm 16 ditë; Seancat gjyqësore u mbajtën në mjediset e Kinemasë "17 Nëntori". Përgjatë gjithë kohës iu bë një publicitet shumë i madh. Mediet e kohës pasqyronin në mënyrë të vazhdueshme pamje nga gjyqi, duke përdorur një gjuhë agresive fyerjesh për të përshkruar grupin e inxhinierëve, me qëllim ushqyerjen e propagandës. Gazeta "Bashkimi", 1946, publikonte vazhdimisht artikuj kundër grupit të inxhinierëve dhe detaje nga seancat gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës është shumë i shkurtër -vetëm 4 faqe- dhe përsëri aty nuk përmbahen argumente juridikë për të mbështetur apo kundërshtuar pretencën e prokurorit dhe dënimin e dhënë. Nga ana tjetër, mbrojtja e paraqitur nga avokatët mbrojtës është shumë e dobët dhe e shkurtër. Bie në sy se të pandehurit i kanë pranuar "fajet" dhe tregojnë pendesë të thellë për veprimet e tyre. Në procesverbalin e mbrojtjes të hartuar nga avokati Vasil Xhaja, i pandehuri Kujtim Beqiri kërkon falje të dënimit prej gjykatës, sepse ishte kryefamiljar dhe kishte 8 persona në ngarkim, megjithëse ende shumë i ri në moshë.

Në përfundim, vendimi, që mori gjykata për shumicën e të pandehurve, ishte ai i dënimit me vdekje. Inxhinierët Kujtim Beqiri dhe Abdyl Sharra u dënuan më varje në litar, ndërsa Zyrika Mano me të shoqin me pushkatim[40]. Për sa i përket dënimit të Zyrikës, shumë studiues kanë diskutuar se Zyrika ishte shtatzënë në kohën e pushkatimit , element shtesë ky që dëshmon përsëri mbi shkeljet e pastra që i bëheshin të drejtave të njeriut në kohën e regjimit komunist.

40. Shih për shembull Pjetër Pepa, "DOSJA E DIKTATURËS", Kumi, Tiranë 2009 (ribotim); 5.Agron Tufa, "Apologjia e gënjeshtrës dhe shumëfishimi i krimit : [këneta e Maliqit, këndvështrime të ndryshme të pasqyrimit në romanin shqiptar]", Almanak. - Nr. 1, , 2011.

## 2.3 Kujtim Beqiri: Procesi gjyqësor dhe e vërteta mbi të

Kujtim Beqiri u arrestua nga sigurimi i shtetit në 24 tetor 1946 dhe bazuar në proces-verbalin e mbajtur nga ky i fundit, u mor në pyetje tre herë, në datat 4, 6 dhe 9 nëntor 1946[41]. Sipas dëshmisë së dhënë prej tij[42], në mënyrë të përmbledhur, ai dhe "elementë të tjerë të pakënaqur" ishin kontaktuar dhe rekrutuar nga Fultzi pas çlirimit të Shqipërisë (1943), në kohën që ai punonte pranë Ministrisë Botore. Fultzi i propozoi krijimin e një organizate me elementë teknikë – intelektualë, në krye të së cilës duhet të ishin ish-nxënës të tij, me qëllimin për të pritur në gatishmëri momentin kur qeveria e atëhershme, e përkohshme, të zëvendësohej me një qeveri pro anglo-amerikane. Puna e kësaj organizate do të përmblidhej në sabotimin indirekt të ndërtimit të vendit dhe si rrjedhojë, duhet të kishte të dëmshme për qeverinë për sa i përket ekonomisë dhe vijës së saj politike[43]. Përveç ndihmës nga misioni amerikan, duhej që teknikët dhe përgjithësisht intelektualët të sabotonin ritmin e punës së rindërtimit e për rrjedhojë, të ndikonin në humbje të "kredibilitetit të qeverisë ndaj popullit". Në këmbim të sabotimit, Fultzi do t'i jepte Beqirit një shpërblim financiar prej 200 e ca stërlinash floriri, të cilat ai do t'ia shpërndante pjesës tjetër të grupit.

Këto sabotime do të shpreheshin nëpërmjet mospërfundimit të punimeve në kohë dhe kryerje të propagandës në favor të demokracisë amerikane tek punëtorët që punonin në Maliq. Në kohën kur kantierin e Maliqit e drejtonte Kujtim Beqiri, akuzohet se janë provokuar greva të ndryshme nga punëtorët dhe kanë dezertuar rreth 100 punëtorë dhe kjo ka ardhur për shkak të punës politike që ka bërë ky së bashku me bashkëpunëtorët e tjerë[44].

41. Shih Dosja Formulare Nr.1080/2, "Kujtim Ali Beqiri", Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr.Regj.557, Kategoria II.B TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr.2, dt.16.06.2017 nga AIDSSH, fq.13 -17.
42. Po aty, fq.20-26.
43. Po aty, fq.21.
44. ibid., fq.112-113.

Pseudonimi i tij i vendosur nga Fultzi, sipas dëshmisë, ishte "Kab"[45]. Ky është tjetër element që tregon se Sigurimi donte t'i nxirrte inxhinierët si organizatë kriminale e organizuar në mënyrë të sofistikuar, deri në atë pikë sa të kishin edhe pseudonime me njëri-tjetrin. Përsëri në bazë të dëshmisë së dhënë prej Beqirit, tregohet se Fultzi e kishte instruktuar që të sabotonte edhe vepra të tjera me ndërtimin e të cilave ishte ngarkuar, përpara se të caktohej me punë në Maliq në vend të Abdyl Sharrës. Shembuj të përmendur aty janë ndërtimi i rrugës së Bicaj apo ura e Rrogozhinës mbi Shkumbin, e cila ishte ndërtuar fillimisht nga italianët në kohën e Ahmet Zogut, u hodh në erë gjatë luftës nga gjermanët dhe ishte rindërtuar menjëherë pas çlirimit, në vitin 1945.

Këto vepra për të cilat komunistët ngritën pretendime si të sabotuara, në realitet, jo vetëm mbijetuan gjatë gjithë periudhës së diktaturës duke kryer plotësisht funksionin e tyre, por disa prej tyre ekzistojnë ende sot, gjë që dëshmon se ishin ndërtuar sipas parametrave të duhur teknikë. Ato janë dëshmi edhe e seriozitetit dhe përkushtimit profesional të inxhinierit Kujtim Beqiri, që drejtoi punën për ndërtimin e tyre.

Pas transferimit të tij në Maliq, supozohet se Kujtim Beqiri së bashku me inxhinierët e tjerë të akuzuar më lart, me të cilët mblidhej rregullisht fshehurazi për të diskutuar mbi vazhdimësinë e sabotimit, hartonte raporte periodike për Fultzin mbi vijimin e sabotimit, të cilat i dërgonte nëpërmjet Zyrakës apo nëpërmjet komunikimeve verbale që bënte me vetë atë. Sipas procesverbalit të dëshmisë së Kujtim Beqirit, gjithsej ishin organizuar katër mbledhje, ku në dy prej tyre ishte diskutuar mbi raportet që do t'i dërgoheshin Fultzit nëpërmjet Zyrika Manos. Sipas akuzës, këto letërkëmbime, ai pasi ua lexonte anëtarëve të tjerë të grupit, i griste.

Por si qëndron e vërteta? Kujtim Beqiri ishte një student i shkëlqyer i Universitetit të Vjenës, Austri.

45. Po aty.

Ai kishte refuzuar një pozicion si pedagog në këtë universitet për t'u kthyer e për të kontribuar në rindërtimin e vendit të tij. Rezultatet e tij të shkëlqyera akademike dëshmohen më së miri nga kopja e diplomës që vetë ky universitet ka lëshuar, të paraqitur më lart.

Niveli i tij i profesionalizmit del në pah edhe nga vetë raportet e Sigurimit, pavarësisht gjuhës së përdorur mbi figurën e tij: Nga studimi i dosjeve që përmbajnë dëshmitë e Kujtim Beqirit dhe të inxhinierëve të tjerë, duket qartë se ato janë marrë në kushte presioni dhe torturash të llojeve të ndryshme (fizike dhe psikologjike), pa vullnetin e tyre të lirë. Një detaj konkret që e vërteton më së miri këtë ndodhet në një pjesë të dëshmisë së Beqirit, e cila pasi është shtypur me makinë shtypi, është korrigjuar nga i pandehuri me shkrim dore[46]. Në dosje gjendet edhe inventari i sendeve dhe pronave që i janë gjetur të pandehurit në momentin e arrestimit, të cilat në përputhje me ligjet e kohës, u konfiskuan nga shteti, i cili përveç heqjes së lirisë fizike, i privonte individët edhe nga prona e tyre e luajtshme dhe e paluajtshme.

Një arsye më tepër për dënimin e inxhinierëve ishte dhe justifikimi i qeverisë komuniste për dështimin në tharjen e Kënetës së Maliqit, punimet për të cilën duhet të përfundonin brenda tetorit të vitit 1946, por për shkak të fondeve të pamjaftueshme dhe mjeteve primitive të punës, ky plan nuk u realizua.

Gjatë dhënies së dëshmisë në zyrat e sigurimit, Kujtim Beqiri vë theksin te mungesat financiare dhe materiale, gjer te mjetet primitive të punës, si pengesë për kryerjen me ritme të shpejta të punës. Për këtë arsye ai kishte hartuar një plan të ri për zhvillimin e punimeve, që nuk kishte aspak qëllime sabotimi, siç dhe u akuzua. Propaganda e regjimit komunist për të nëpërkëmbur figurën e inxhinierit të talentuar Kujtim Beqiri dhe të intelektualëve të tjerë u manifestua jo vetëm te qëndrimet e institucioneve

46. Ibid., fq.14

të administratës shtetërore, por u bë subjekt edhe në vepra letrare të kohës si romane apo filma të kohës[47], me qëllimin për të përjetësuar në sytë e popullit shqiptar inskenimin e kryer nga regjimi si një të vërtetë.

47. Shih për shembull Fatmir Gjata, “Këneta”, Tiranë, Naim Frashëri, 1973 dhe filmin e prodhuar nga Kinostudio ”Shqipëri e Re’ i bazuar mbi këtë roman, me titull “Vitet e para” (1965).

Në përfundim të jetës së tij, pak përpara përfundimit të gjyqit të inskenuar ku Kujtim Beqiri u dënua me vdekje, ai i dërgon një letër lamtumire familjes së tij. Në nënshkrimin e vendosur në përfundim të letrës, duket qartë që e vetmja dëshirë e tij është që pas vdekjes të mos e mbanin mend për sabotues dhe kriminel i vendit të tij siç u akuzua, por si profesionist të përkushtuar, ashtu siç ishte edhe e vërteta.



Letër e Kujtim Beqirit dërguar vëllait.

Në fund shkruan : *Vetëm një lutje kam për të gjithë ju që më kini njohur së afërmi : të më kini ndërmend gjithnjë si Kujtimin që kini pas njohur më parë. Vëllai yt, Kujtim.*

## 3. Marrëdhëniet diplomatike SHBA-Shqipëri: Gjendja e pasluftës dhe ardhja e misioneve anglo-amerikane

### 3.1. UNRRA dhe OSS

Në periudhën 1945-1946, në vend zbarkuan misione të ndryshme me qëllime humanitare, siç ishte UNRRA, i financuar nga Forcat Aleate, kryesisht nga qeveria amerikane, për të ndihmuar Frontin Nacionalçlirimtar, ndihmë ekonomike e më vonë, në rimëkëmbjen e popullit shqiptar. Kjo organizatë drejtohej nga Frank Woodard, i cili mbante postin e Drejtorit të Divizionit Bujqësor për Shqipërinë. Pas përfundimit të Luftës së II Botërore, misioni i UNRRA-s ishte të siguronte ndihmë ekonomike për kombet evropiane pas Luftës së Dytë Botërore dhe të riatdhesonte dhe ndihmonte refugjatët që do të vinin nën kontrollin e Aleatëve.

Qeveria amerikane financoi afërsisht gjysmën e buxhetit të UNRRA-s. UNRRA nuk vepronte vetëm në Shqipëri, por në të gjitha shtetet të cilat kishin pësuar humbje ekonomike gjatë Luftës[48]. Misione të tjera të ardhura në Shqipëri në atë periudhë ishin me natyrë ushtarake, si ai amerikan, me në krye Harry T. Fultz, si dhe ai i dërguar nga qeveria angleze. Mbërritja e misionit të UNRRA-s në Shqipëri e ashpërsoi akoma edhe më shumë luftën e klasave. Sipas komunistëve, UNRRA do të përdorte "logjikën e saj imperialiste", për t'u angazhuar në rrjet spiunazhi dhe sabotimi. Duke përdorur Sigurimin e Shtetit, synohej të mbahej nën kontroll të vazhdueshëm veprimtaria e punonjësve të kësaj organizate, sepse i druhej ndonjë indoktrinimi të mundshëm të popullit shqiptar me frymën demokratike perëndimore.

Dy dosje të deklasifikuara të Sigurimit të Shtetit, specifikisht Dosja Nr. 20 "Korrespondenca e shkëmbyer në mes të personelit të UNRRA-s dhe misionit ushtarak në Shqipëri mbi veprimet e tyre në vendin tonë[49]" dhe Dosja Nr. 80 "Të dhëna informative nga burime agjenturiale mbi veprimtarinë e misionarëve të UNRRA-s dhe elementët armiq e të dyshimtë shqiptarë[50]" dëshmojnë më së miri mbi survejimin e aktivitetit të UNRRA-s, të manifestuara qoftë nëpërmjet raporteve të hartuara nga vetë punonjësit e Sigurimit, ku detajohej çdo lëvizje apo diskutim i tyre, qoftë nëpërmjet dëshmive periodike të rrjetit të bashkëpunëtorëve të Sigurimit mbi ta, të cilët në shumicën e rasteve përmenden nëpërmjet pseudonimeve.

Misionet ushtarake anglo-amerikane që zbarkuan në territorin e Shqipërisë së sapoçliruar në 1944 i përkisnin organizatave SOE (Special Operations Executive/ Ekzekutivi i Operacioneve Speciale) dhe OSS (Office of Strategic Services/Zyra e Shërbimeve Strategjike).

Qëllimi i përbashkët zyrtar i të dyja misioneve ishte të ndihmonin me trupa të armatosura në Luftën Nacional-Çlirimtare si dhe të hapnin negociatat me qeverinë e sapoformuar komuniste, për t'u siguruar që kjo e fundit do të respektonte përkatësisht: kryerjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe vazhdimësinë e detyrimeve të traktateve bilateralë ndërmjet saj dhe SHBA-së (të ndërmarra nga qeveria paraardhëse). Megjithatë, duhet theksuar se funksionet kryesore të OSS / SOE ishin ato të një agjencie inteligjence. Nga dalja në dritë e dokumenteve të reja të deklasifikuara që i përkasin asaj periudhe, vërtetohet se misionet e dërguara prej tyre kishin si objektiv të njihnin gjendjen politike në të cilën ndodhej Shqipëria. Rrjedhimisht, rezulton se agjencitë e inteligjencës që operonin në Ballkan, duke përfshirë Shqipërinë në kohën e Luftës së II Botërore, ishin kryesisht amerikane dhe angleze dhe ardhja e misioneve të dërguara prej tyre

48. Për më shumë informacion, shih marrëveshjen e lidhur ndërmjet qeverisë komuniste shqiptare dhe kësaj organizate, me qëllim ardhjen e saj në territorin shqiptar, 11 prill 1945. Aksesohet në: https://www.loc.gov/law/help/us-treaties/bevans/b-al-ust000005-0028.pdf

49.Dosja është hapur më 08.12.1944 - 30.12.1944 nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e I-rë;

50.Dosja është hapur për periudhën 13.05.1946 – 31.07. 1946 nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega e I-rë;



*(Foto, nga e majta në të djathtë)*
*Anëtarë të Misionit Ushtarak Amerikan, Misioneve Ushtarake Britanike dhe Ruse. Misionarë të UNRRA-s në sfond. (Alb. Ph. 299458 – foto nga Ristani, Tirana)", S-0800-0001-0014-00003. Marrë nga arkivat e Kombeve të Bashkuara, e aksesueshme në: https://search.archives.un.org/albania-visitors-at-camerian-congress*

u mundësuan vetëm përmes marrëveshjeve të fshehta të bashkëpunimit midis OSS nga njëra anë dhe SOE-së nga ana tjetër, në qershor 1942 dhe gusht 1943 (Arkivi i Shtetit Amerikan - NARA, 1943: 1-23).

Në Shqipëri, rolet e tyre ishin të ndryshme: detyra kryesore e misionit të OSS ishte të hartonte raporte te vazhdueshme inteligjence lidhur me marrëdhëniet që kishte lideri i sapovendosur në krye të shtetit shqiptar, E. Hoxha, me Bashkimin Sovjetik, ndikimin qe mund të kishte ky i fundit në vend dhe në marrëdhëniet SHBA-Shqipëri në të ardhmen[51], ndërsa misioni anglez kishte synim të ndërtonte

51.Shumë historianë amerikanë pohojnë se shërbimet inteligjente amerikane në fillimet e tyre ishin të një cilësie kaq të dobët, sa nuk ishin ne gjendje të parashikonin asnjë nga lëvizjet e rëndësishme politike në Europe, të ndërmarra nga gjermanët apo italianët. Duke parë këtë dobësi të madhe të politikës ndërkombëtare amerikane, dhe duke pasur parasysh se amerikanët do të hynin shumë shpejt në fushën e Luftës Botërore, presidenti Roosevelt nënshkroi urdhrin presidencial për krijimin e OSS (1942 -1945), e cila u krijua pak a shumë në modelin britanik të SOE. OSS, e drejtuar nga William Donovan (kur ky i fundit e ktheu vëmendjen e tij drejt Ballkanit) u kthye në një organizatë inteligjence shumë e rëndësishme gjatë Luftës së Dytë Botërore.



SEKSIONI V-TE N:2 TIRANE 28/VI/946

RELACION MBI RETHET ME TE CILET KA LIDHJE DEPARTMENTI AMERIKAN.-

Departmenti Amerikan ka lidhje te rregullta me elementa te pakenaqur dhe qe jane armiq te pa-pajtushem me interesat e Popullit Shqiptar dhe te Qeverise Demokratike. Lidhje te rregullta me keta mban Fulltz-i dhe Anton Stivensi te cilet dyshohet te jene edhe njerezit me te rrezikshem te Departmentit Amerikan ne Shqiperi.Me ikjen e Misionit Engle si Fulltz ashtu dhe Anton Stivens i kane shtuar levizjet e tyre dhe kane patur kontakte dhe me disa qe me perpara kane hyre dhe ne Misionin Engles.

Me anen e ketyre njeresve qe ata kane kontakte Departmenti di me saktesi gjendjen t'one ekonomike dhe poli tike,funksionimin e Ministrive,te Ushtris dhe te gjith Push tetit ne pergjithesi.Puna qe shvillojne anetaret e Depart- mentin me keta njeres ne kete drejtim esht mjaft e organi- zuar dhe me shume zor do te munt te zbulohet vargu i tyre. Rrethet e Departmentit Amerikan qe i sherbejne per punen e tija parashikohen te jene te gjera dhe jo vetem ne Tirane por edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.-

Elementet qe po shenojme me poshte kane frekue- ntuar Departmentin Amerikan dhe kane patur kontakte te shpe shta me anetaret e Departmentit ne vende te ndryshme dhe qe dyshohen te jene njeres ne sherbim te tyre jane:

një rrjet më aktiv agjenturial[52]. Në nëntor të 1943, misionin e OSS në Shqipëri e mori nën drejtim Harry T. Fultz[53], një veteran i Luftës së Parë Botërore dhe ish – drejtori i Shkollës Teknike në Shqipëri (1922-1931), tashmë në rolin e një civili, që deri në atë moment kishte drejtuar Seksionin Shqiptar të OSS-së në Bari[54], si rrjedhojë e njohurive të forta mbi Shqipërinë.

Diçka e tillë vërtetohet edhe nga një korrespondencë telegrafike midis J. Jacobs[55] dhe Departamentit Amerikan të Shtetit, ku Fultzi, ishte planifikuar të hynte në territorin shqiptar fillimisht si një anëtar i misionit të OSS dhe më vonë do të shërbente si Këshilltar Ekonomik i Departamentit Amerikan të Shtetit. Për më tepër, telegrami instruktonte se pas ardhjes së misionit të OSS nga Italia në Shqipëri, duhet të koordinohej puna e kryer deri atëherë nga stafi paraardhës amerikan me atë të Fultz-it. Pothuajse që në momentin që Fultzi u rikthye

52.Disa studiues madje aludojnë për një rivalitet të këtyre dy agjencive përgjatë veprimtarisë së kryer në Shqipëri. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy misioneve përmendet edhe në veprën Th.Bare, “Historia e Armës së Sigurimit të Shtetit“, Pjesa II (Nëntor 1944-1948), Tiranë, Janar 1974.

53.Emri i koduar: “Gates” ose “Plak”.

54.Shih P.Lucas, “The OSS in World War II Albania: Covert Operations and Collaboration with Communist Partisans”, fq.23.

55. Joseph Jacobs, pjesëtar i misionit të OSS në Shqipëri, i dërguar së bashku me Fultzin në territorin shqiptar.



MBI FULTZIN.- Ky ka qene si Drejtor i Shkolles Teknike gjer ne vitin 1932. Pare ca kohesh ndodhej ne Bari, i ngarkuer te organizoje Agjensin e Spiunazhit ne Ballkan (S.B.S.) dhe ne Shqiperi me qender ne Tirane. Fultzi kur erdh ne Itali, disa shokeve Shqiptare te internuar, u ka premtuar rroga tue u thene se shume Shqiptare jane ne S.B.S. Ka pasur simpati ne studentat e Teknikes.-

Tash ne kohen e fundit me ardhjen e Misjonit te Departementit te Punve te Jashteme per Shtetet e Bashkuera, shenohet si antare i Misjonit, i cili si pas infomatave, duket te jete i ngarkuer per te formuar S.B.S. ne Shqiperi.-

*Foto: Raport për Fultzin.( Fondi Arkivor i AIDSSH)*

në jetën politike të Shqipërisë, filloi të survejohej nga Sigurimi i Shtetit, ashtu siç dëshmohet edhe nga një dosje e deklasifikuar e Sigurimit mbi të, Dosja Nr. 100[56], ku përveç survejimit të përditshëm të veprimtarisë së tij, përshkruhet me detaje jeta e hershme, aktiviteti si drejtor i Shkollës Teknike në Tiranë, si dhe roli drejtues në OSS[57]. Misionit të OSS-së i ishte dhënë leja nga qeveria komuniste për të përdorur ndërtesat e Legatës (Ambasadës)Amerikane në Tiranë si seli te përkohshme[58], element i cili shfaqet shpesh edhe nga dosjet e hartuara nga Sigurimi, ku shumica e survejimeve që i janë bërë Fultzit dhe anëtarëve të tjerë të misionit amerikan e kanë pikënisjen aty. Një element që vlen për t'u theksuar për sa i përket mënyrës sesi Sigurimi i Shtetit operonte është fakti se ky i fundit shkelte të drejtën e privatësisë jo vetëm ndaj Fultzit dhe anëtarëve të tjerë të misionit, por edhe atë të familjarëve të tij, siç dëshmon dosja survejuese e vajzës së tij, Joana, e cila në atë kohë ishte vetëm 21 vjeçe[59].

## 3.2 Rreth figurës së Harry Fultzit dhe përfshirjes së tij në "sabotimin" e Kënetës së Maliqit

Në periudhën kur ka drejtuar Shkollën Teknike[60] (1922 -1931), ai ka qenë gjithnjë në rolin e edukatorit për popullin shqiptar, sepse ndihmoi në edukimin e shumë brezave në shkencat natyrore dhe gjuhën angleze. Fëmijët e tij[61] , dëshmojnë se ai u kishte trashëguar dashurinë për popullin shqiptar. Djali i tij, Dave, një figurë e shquar

56.Dosja Nr.100 "Të dhëna biografike dhe informative mbi veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë nga Harry Fultz", filluar më 1945 e mbaruar në 1946, f.148.
57. Po aty, fq.2,12.
58. Telegram i adresuar nga Jacobs drejt Sekretarit te Shtetit te Ministrit në Egjipt (Tuck), "Efforts by the United States to arrive at satisfactory arrangements for the establishment of diplomatic relations with the Albanian Government", 2 Janar 1945. Gjendet në https://history.state.gov/historicaldocuments/frus1945v04/ch1
59. Dosje Nr. 90, "Materiale Agjenturale në ngarkim të së bijës së Fultzit, Joana Fultzi", 1945 - 1946, f.76.
60. Sot kësaj shkolle, i është dhënë emri i tij.
61. Shih Joan Fultz-Kontos, "Kryqi i Kuq, Shqiponja e Zezë", Monografi për Evropën Lindore, Bibliografi e Shkollës Teknike Shqiptaro-Amerikane të Tiranës, 1994.

*Gjykimet (e inxhinierëve) që po ndodhin në Tiranë janë padyshim një përpjekje e regjimit shqiptar për të përjetësuar veten me anë të shtypjes dhe terrorizimit të elementeve liberale, patriotike dhe opozitare shqiptare. Akuza se të akuzuarit ishin të lidhur me anë të pagesës ose shërbimit ndaj Shteteve të Bashkuara, apo të ndonjë përfaqësuesi të saj në Shqipëri nuk ka ndodhur në asnjë mënyrë dhe është krejtësisht e pavërtetë"*

akademike në SHBA, gjatë një intervistë të dhënë në vitin 1993, ka diskutuar gjerësisht mbi kontributin e të atit në vendin tonë. Ai e përshkruante këtë lloj përkushtimi si ngjitës, deri në pikën ku ai vetë ishte frymëzuar për të ndjekur një karrierë në fushat shkencore si rrjedhojë e viteve që kishte kaluar në Shqipëri, duke studiuar në shkollën e të atit[62]. Gjatë periudhës kur Fultzi kryente rolin e drejtorit të Shkollës Teknike (deri në vitin 1933) nuk ka asnjë dokument që të provojë se ai kishte lidhje me shërbimet e inteligjencës amerikane.

Përfshirja e tij me OSS rrjedhimisht ka ardhur gjatë kohës së Luftës II Botërore. Ky detaj konfirmohet, së pari, nëpërmjet dosjes së tij si personel i OSS, e cila është tashmë e deklasifikuar, ashtu si edhe nga mikrofilmat e gjetur që përmbanin dosjet agjenturiale të Donovan-it, shefit të OSS, të deklasifikuara[63] dhe të zbardhura nga Arkivi Shtetëror Amerikan, ku H. T. Fultz rezulton si subjekt i rekrutuar në këtë agjenci[64].

Gjithashtu, sipas një rrëfimi të bërë nga ish- kapiteni të OSS, që operoi në Shqipëri në ato vite, James "Jim" Hudson për një gazetë shqiptare në 2012, ishte kjo periudhë (pas 1943) kur Harry Fultz mund t'u jetë drejtuar të gjithë ish-nxënësve të tij si dhe profesorëve të dikurshëm të Shkollës Teknike me qëllim rekrutimin e një rrjeti informatorësh shqiptarë, të cilët potencialisht mund të përdoreshin prej OSS edhe pas vendosjes se regjimit komunist[65].

Historia mbështet faktin që ka pasur përpjekje nga OSS për të rekrutuar eksponentë shqiptare të diasporës, që ishin kundër regjimit të Hoxhës

62. Intervista me Dave Fultz, fq.4,5,13. E aksesueshme në https://opensky.ucar.edu/islandora/object/archives%3A7598/datastream/OBJ/vieë
63. Gjendet në https://catalog.archives.gov/id/2173377
64. Arkivi Kombëtar Amerikan, Washington, DC 20408, "GENERAL WILLIAM J. DONOVAN, SELECTED OSS DOCUMENTS, 1941-1945 MICROFILM ROLL LIST AND INDEX RECORD GROUP 226 ENTRY 180, File 57-58", korrespondencë e Donovan-it me Brennan, me subjekt H. T. Fultz, 8/5/44, fq.3. E aksesueshme në https://www.archives.gov/files/iëg/declassified-records/rg-226-oss/directors-microfilm-roll-list.pdf
65. Marrë nga intervista e A.Tare, titulluar "Misioni im në Shqipëri" – Intervistë me Kapiten James HUDSON për misionin e tij në Shqipëri gjatë viteve të luftës së dytë botërore", botuar në Gazetën "SHQIP", 2012. Pyetjes së intervistuesit nqs Fultz e kishte instruktuar për të krijuar një rrjet spiunazhi, që do të përdorej edhe pas Luftës Nacional – Çlirimtare, Hudson i përgjigjet se pavarësisht se ai asnjëherë nuk ia kishte shprehur në mënyrë eksplicite këtë gjë, ishte e nënkuptuar. Për më shumë, shih intervistën e plotë, e aksesueshme në https://www.scribd.com/doc/145100586/MISIONI-IM-NE-SHQIPERI-Interviste-me-Kapiten-JAMES-HUDSON-per-misionin-e-tij-ne-Shqiperi-gjate-viteve-te-luftes-se-dyte-botrore

për të kryer veprimtari agjenturiale (ky grup quhej the Albanian Subversion ose Komiteti për Çlirimin e Shqipërisë – Committee Free Albania), por kjo ka ndodhur në 1949, vite më vonë nga arrestimi dhe dënimi i grupit të inxhinierëve, ashtu si dhe nga largimi i misionit amerikan nga vendi. Ky operacion rekrutimi ishte rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet misionit amerikan me atë anglez dhe mbante emrin OBOPUS / BGFIEND[66]. Sipas një memorandumi të Zv/Drejtorit Për Koordinimin e Politikave në Washington DC, të deklasifikuar vitet e fundit nga CIA, që mban datën e nëntorit 1949, përmendet se: "Informacioni (i CIA-s) është marrë nga një burim i mirëfilltë që këshilltari kryesor i Komitetit për Shqipërinë e Lirë, gjatë vizitës së tij të fundit në Ëashington, ishte Harry Fultz, i njohur mirë nga intelektualët shqiptarë, sepse ka qenë për shumë vite Drejtor i Shkollës së Kryqit të Kuq Amerikan në Tiranë. ".... Në bisedimet me shqiptarët, thuhet se ai do të donte ta shihte vendin ku ai kaloi kaq shumë vite të çliruar nga komunizmi dhe ai premtoi gjithë mbështetjen e tij personale… (Jemi njoftuar) se ai i dha secilit anëtar të Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë një shpërblim prej $ 5,000.00. (Një raport tjetër nga i njëjti burim kishte treguar se anëtarët e këtij Komiteti kishin marrë secili nga dhjetë mijë dollarë nga Departamenti i Shtetit)[67]".

Në materialet e gjetura në dosjet e deklasifikuara të Sigurimit për grupin e inxhinierëve dhe për Harry Fultzin, deri tani nuk ka rezultuar asnjë provë e drejtpërdrejtë, e shkruar, që të mbështesë teorinë se këto rekrutime përfshinë edhe grupin e inxhinierëve të Maliqit. Ky fakt vërtetohet nga raportet survejuese të gjendura mbi lëvizjet dhe veprimtarinë e Fultzit, në të cilat nuk ka asnjë gjurmë të takimeve të tij me ndonjë prej inxhinierëve apo me Zyrika Manon, e cila u akuzua si ndërlidhësja mes tyre.

66. Shih Raportin e deklasifikuar të CIA-s në https:/www.cia.gov/library/readingroom/docs/CIA-RDP91T01172R000300290022-1.pdf

67. Raport i deklasifikuar nga CIA, i aksesueshem në https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/OBOPUS%20BGFIEND%20%20%20VOL.%2014%20%20(BGFIEND%20OPERATIONS)_0078.pdf

**Në bisedimet me shqiptarët, thuhet se Fultz do të donte ta shihte vendin ku ai kaloi kaq shumë vite të çliruar nga komunizmi dhe premtoi gjithë mbështetjen e tij personale… (Jemi njoftuar) se ai i dha secilit anëtar të Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë një shpërblim prej $ 5,000.00.**

Duke iu referuar përsëri rrëfimit të James Hudson të përmendur më lart, pyetjes nëse kishte ndonjë të vërtetë në faktin se Enver Hoxha e akuzonte Fultzin se ai ishte një spiun i amerikanëve dhe se përdorte ish-studentët e tij për të mbledhur informacione, ai i përgjigjet se të paktën deri në vitin 1944, Fultzi ishte dakord me marrëveshjen apo me vendimin e anglezëve për të pajisur partizanët me armatime kundrejt Ballit Kombëtar. Ai pohon se Fultzi ishte një njeri shumë serioz, i përkushtuar ndaj punës së tij dhe më e rëndësishmja, "ai ishte "një djalë Tirane", ai kishte jetuar në Tiranë dhe e njihte mirë qeverinë. Ai nuk ishte tipi i Hoxhës. Atë nuk do ta shihje nëpër male, ishte një djalë qyteti i shkolluar, i mprehtë dhe shumë i zgjuar. Nuk më la në asnjë moment përshtypjen se pas luftës do të bënte diçka kundër dikujt. Mendoj se ai po luante drejt dhe ishte pjesë e ushtrisë amerikane, duke u munduar të fitonte luftën."

Ekziston një fotografi shumë domethënëse e Fultzit, e shkrepur jashtë ndërtesës së shkollës Teknike në vitin 1945, ku ai është i rrethuar nga dyzet prej studentëve të tij të mëparshëm, disa të veshur me uniformën partizane. Pa kaluar shumë kohë pasi ishte bërë fotografia, Fultzit iu desh të dëshmonte sesi studentët e tij po vrisnin njëri-tjetrin. Në një letër drejtuar një kolegu të tij në kohën e gjyqit të grupit të inxhinierëve, Fultzi vuri në dukje se kreu i Gjykatës së Lartë Ushtarake në Tiranë, që kishte qenë një prej të diplomuarve në shkollën e Fultzit, kryesonte dënimin e 37 burrave të akuzuar si armiq të popullit dhe njëkohësisht ish-nxënës të shkollës së tij[68]".

68.Ibid.,Peter Lucas, f.187.



*H.T.Fultzi (qendër) i rrethuar me nxënësit e diplomuar në vitin 1933.*
*I dyti në rradhën I - Kujtim Beqiri, njëri prej inxhinierëve të dënuar.*

H.T.Fultzi (qendër) i rrethuar me nxënësit e diplomuar në vitin 1933.

Dënimi i grupit "sabotator" të Kënetës së Maliqit u konsiderua një sukses politik nga ana e Sigurimit të Shtetit, siç rezulton nga një shkresë adresuar Seksionit të Sigurimit në Korçë nga Ministria e Punëve të Brendshme.[69]

Menjëherë pas shpalljes së vendimit për të dënuar grupin e inxhinierëve, Departamenti Amerikan i Shtetit nxori një deklaratë ku kategorikisht mohonte pohimet e bëra në gjyq, e publikuar në buletinin mujor të këtij Departamenti:"Gjykimet (e inxhinierëve) që po ndodhin në Tiranë janë padyshim një përpjekje e regjimit shqiptar për të përjetësuar veten me anë të shtypjes dhe terrorizimit të elementeve liberale, patriotike dhe opozitare shqiptare. Akuza se të akuzuarit ishin të lidhur me anë të pagesës ose shërbimit ndaj Shteteve të Bashkuara, apo të ndonjë përfaqësuesi të saj në Shqipëri nuk ka ndodhur në asnjë mënyrë dhe është krejtësisht e pavërtetë"[70].

Në ndryshim nga pjesëtarët e tjerë të misionit, (si p.sh. Jacobs, që e konsideronte eksperiencën e tij

69. Dosja Formulare Nr. 1080/2, "Kujtim Ali Beqiri", Ministria e Brendshme, Seksioni i Sigurimit të Shtetit, Nr. Regj. 557, Kategoria IIB TEPËR SEKRET, deklasifikuar me vendimin Nr. 2, dt.16. 06. 2017 nga AIDSSH, fq. 44-45.

70. Shih: Jakov Aleksandrovich Malik., Department of State Bulletin, Nov. 17, 1946.



*Harry T. Fultz (në mes) me pjesëtarë të misionit amerikan të OSS në Shqipëri, 1945.*
*(Foto: Fondi Arkivor i AIDSSH)*

në Shqipëri si "purgator Ballkanik" dhe vazhdimisht riafirmonte besimin e tij se "ditëve të tij në Shqipëri po u vinte fundi." "Pas një viti që po merrem me ta, - vazhdonte ai, - nuk mundem dot më"), Harry Fultzi dëshironte ende të qëndronte, duke u quajtur kështu nga kolegët e tij si "ai i cili e kërkon me zor ndëshkimin".

Në zbatim të politikës së qeverisë, Sigurimi i Shtetit u soll ashpër ndaj pjesëtarëve të misionit amerikan, gjatë largimit të tyre nga porti i Durrësit në nëntor 1946. Kjo dëshmohet nga një letër e gruas së Henderson (pasardhësi i Fultzit në detyrë për shumë pak muaj përpara se SHBA ta tërhiqte misionin amerikan përfundimisht nga Shqipëria), drejtuar një mikut të saj në Departamentin Amerikan të Shtetit. Aty përshkruhen peripecitë e hequra, që nga flakja e plaçkave të tyre me forcë në anije, deri te keqtrajtimi fizik i vajzës së Fultz-it, Joana71, me qëllim denigrimin e tyre moral.

Në mes të nëntorit 1946, kur misioni amerikan u largua nga Tirana, pjesëtarët e tij do t'i referoheshin Qeverisë së atëhershme si "barbare", "e pamëshirshme" dhe "e paskrupullt". Menjëherë pas ngjarjes në Shqipëri, anëtarët e misionit amerikan u drejtuan drejt Liberisë, ku në foton më sipër është fotografuar edhe Fultzi bashkë me të bijën.

71. Letra është botuar në AMERICAN FOREIGN SERVICE JOURNAL, VOL. 24, NO. 1, Janar 1947, THE NATIONAL WAR COLLEGE, WASHINGTON, D.C, fq. 33, 52. E aksesueshme në: http://www.afsa.org/sites/default/files/fsj-1947-01-january_0.pdf

# Përfundime

Pavarësisht faktit se elementë të regjimit komunist shqiptar ndryshonin nga regjimet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore e si i tillë ai regjim mund të quhej unik, vetëm për Shqipërinë, përsëri mund të nxjerrim mësime të rëndësishme universale. Mësimi kryesor është potenciali i tmerrshëm që mund të ketë "demonizimi" i personit për shkak të ideologjisë së urrejtjes të sanksionuar nga shteti. Ky mësim i përbuzjes apo ky proces dehumanizimi, siç ishte lufta e klasave, ishte baza e persekutimit dhe e internimit të mijëra personave si dhe shkelja sistematike e të drejtave të tyre më thelbësore.

Shqipëria ende ndodhet sot relativisht në mes të procesit të demokratizimit të saj, ashtu si në hapat e parë drejt objektivit të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, duhet të respektojë dhe inkurajojë angazhimin për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist, për të respektuar të mbijetuarit e tij dhe për të riafirmuar aspiratën e përbashkët për solidaritet dhe drejtësi.



# ANEKS

Dosje e përgatitur nga Autoriteti Për Informim Mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

**Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit**

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI GJYQËSOR I GJYKATËS SË LARTË USHTARAKE - Tiranë

Nr. 17 i Regj. Themel.
Prokuroria e kësaj gjykate me akt-akuzën e saj për datë 8.11.1946 dërgon për gjykim të pandehurit:

1. Vasil Mano
2. Kujtim Beqiri (Inxhinier)
3. Mario Guarnieri (Gjeometër)
4. Skaturo Eugenio
5. Abdul Sharra (Inxhinier)
6. Pandeli Zografi (Gjeometër)
7. Zyrika Mano
8. Jani Vasili
9. Anastas Risto
10. Mihal Stratobërdha

## Akt- akuza

Të gjithë të pandehurit e mësipërm që kanë qenë me përgjegjësi të ndryshme për tharjen e Maliqit dhe që kanë pasur lidhje me elementë të jashtëm, janë të akuzuar se kanë kryer sabotime të rënda duke i shkaktuar shtetit dëme të mëdha. Gjithashtu specifikohet se për të kryer këto sabotime, të pandehurit kanë kryer mbledhje të fshehta, që u kanë raportuar të huajve rreth punimeve dhe që kanë ndjekur urdhëresat e tyre për kryerjen e sabotimeve. Për gjykimin e çështjes u caktua data e sotme 8.11.1946 ora 9:00.

**Sekretari Aspirant:** Thoma Rino.
**Kryetar i Këshillit:** N/ Kolonel Gaqo Floqi.
**Vendi i Gjykimit:** Salla e Kinemasë “Nacional” të Tiranës.

Këshilli Gjyqsor i Gjykatës së Lartë për Gjykim u formua nga:

N/ Kolonel Gaqo Floqi (Kryetar).
Kapiten. I. Veledin Zejneli (Anëtar).
Kapiten. I. Nexhat Hysejni (Anëtar).
Me pjesëmarrjen e Prokurorit: Kapiten I. Nevzat Haznedari dhe asistuar nga Sekretari Aspirant Thoma Rino.

## Të Pandehurit

**Emri – Mbiemri: VASIL MANO**
Babai: Theodhor
Amësia: Afërdita
Mosha: 34 vjeç (lindur e banues në Korçë)
Gjendja civile: I martuar (Me ZYRIKA MANO – SIKALECI me kombësi jugosllave) / Nuk ka fëmijë
Arsimi dhe Profesioni: I arsimuar në Torino (Itali) për Inxhinieri/ Inxhinier
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: KUJTIM BEQIRI**
Babai: Ali
Amësia: Shefika
Mosha: 30 vjeç
Gjëndja civile: I martuar (Me Fatime Hoxhën)/ me fëmijë
Arsimi dhe Profesioni: Shkolla e Mesme Teknike e Tiranës - Studimet e Larta i ka mbaruar në Vjenë / Inxhinier
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: MARIO GUARNIERI**
(meqë nuk di gjuhën zyrtare u mor si përkthyes z.Vasil Trimçev, 27 vjeç nga Shkodra)
Babai: Giuseppe
Amësia: Giuseppina
Mosha: 37 vjeç / lindur në Trenovë të Italisë, ka ardhur në Shqipëri me datë 27.5.1940
Gjëndja civile: I martuar (me Neli Mira)
Arsimi – Profesioni: Gjeometër
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: EUGENIO SCATURO**
(meqë nuk di gjuhën zyrtare u mor si përkthyes z.Vasil Trimçev, 27 vjeç nga Shkodra)
Babai: Françesko
Amësia: Sanuzze
Mosha: 29 vjeç / lindur në Leçe (Itali)
Gjëndja civile: -
Arsimi – Profesioni: Arsimi i Lartë / Llogaritar (Maliq)
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: ZYRIKA MANO**
(meqë nuk di gjuhën zyrtare u mor si përkthyes z. Vasil Trimçev, 27 vjeç nga Shkodra)
Babai: Milan
Amësia: Katerina
Mosha: 27 vjeç / lindur në Zagreb (Jugosllavi) dhe banuese në Korçë
Gjëndja civile: E martuar 2 herë, me burrin e parë, priftin Pandi Popoviç ka 2 fëmijë / E martuar (me VASIL MANO), pa fëmijë, nënshtetësi shqiptare
Arsimi – Profesioni: -
Gjendja Penale : E padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: ABDUL SHARRA**
Babai: Musa
Amësia: Mahmudije
Mosha: 35 vjeç (lindur në Vlorë e banues në Durrës)
Gjëndja civile: I martuar
Arsimi – Profesioni: Shkolla Teknike – Tiranë/ Me arsim të lartë - Inxhinier
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: PANDELI ZOGRAFI**
Babai: Dhimitri
Amësia: Eleni
Mosha: 35 vjeç (lindur e banues në Korçë)
Gjëndja civile: -
Arsimi – Profesioni: Me arsim të lartë - Gjeometër
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: JANI VASILI**
Babai: Vasil
Amësia: Eftali
Mosha: 16 vjeç (nga fshati Borovë e Kolonjës)
Gjëndja civile: Beqar
Arsimi – Profesioni: Arsim fillor
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: ANASTAS RISTO JORGJI**
Babai: Risto
Amësia: Marije
Mosha: 35 vjeç (nga fshati Lin i Pogradecit)
Gjëndja civile: i martuar (me Stefani Anastasin), me 6 fëmijë
Arsimi – Profesioni: Kafexhi / ish-shënjues në Kantierin e Maliqit
Gjendja Penale : I padënuar më parë

**Emri – Mbiemri: MIHAL STRATOBËRDHA**
Babai: Lluka
Amësia: Linosa
Mosha: 34 vjeç (nga fshati Stratobërdhë e banues në Korçë)
Gjëndja civile: I martuar
Arsimi – Profesioni: Me arsim – ish Asistent në Maliq
Gjendja Penale : I padënuar më parë

## Procesi Gjyqësor

**Dt. 8. 11. 1946**
Merret në pyetje Inxhinier VASIL MANO të cilit iu caktua si Avokat mbrojtës Av. Efthim Canco
Folën edhe PANDELI ZOGRAFI,
Vendim: Për pyetjen e të pandehurve të tjerë u vendos shtyrja e audiencës së gjykimit për në datën 9.11.1946, ora 9:00, paradite.

**Dt. 9.11.1946**
Merret në pyetje PANDELI ZOGRAFI të cilit iu caktua si Avokat mbrojtës Av. Efthim Canco
Punimet në Maliq si gjeometër i ka filluar më 15.4.1946
Folën edhe VASIL MANO, EUGENIO SCATURO (me anë të përkthyesit Feti Avni Gjilani), MARIO GUARNIERI (me anë të përkthyesit Feti Avni Gjilani)
*Vendim:* Për pyetjen e të pandehurve të tjerë u vendos shtyrja e audiencës së gjykimit për mbas dite të datës së sotme në orën 14:30.
Merret në pyetje SCATURO EUGENIO (me anë të përkthyesit Tomor Eshref Frashëri) të cilit iu caktua si Avokat mbrojtës Av. Efthim Canco.
Tetor 1942 – Qershor 1943 ka qenë oficer fanterije ne Mal të Zi me gradë N/Toger. Më vonë është transferuar në Shqipëri
*Vendim:* Për pyetjen e të pandehurve të tjerë u vendos shtyrja e seancës për në datën 10.11.1946, ora 10, paradite.

**Dt. 10.11.1946**
Merret në pyetje i pandehuri KUJTIM BEQIRI të cilit iu caktua si avokat mbrojtës Z. Vasil Xhaj.
*Vendim:* Për vazhdimin e gjykimit dhe pyetjen e të pandehurve të tjerë seanca shtyhet për në datën 11.11.1946, ora 9, paradite.

**Dt. 11.11.1946**
Merret në pyetje e pandehura ZYRIKA MANO (me anë të përkthyesit Z. Feti Avni Gjilanit) të cilës iu caktua si avokat mbrojtës z. Efthim Canco.
Folën edhe PANDELI ZOGRAFI, ABDUL SHARA, SCATURO EUGENIO, VASIL MANO, KUJTIM BEQIRI
Merret në pyetje i pandehuri MARIO GUARNIERI (me anë të përkthyesit Z. Feti Avni Gjilanit) të cilit iu caktua si avokat mbrojtës Z. Burhan Rusi.
Folën edhe MIHAL STRATOBËRDHA, VASIL MANO, KUJTIM BEQIRI, PANDELI ZOGRAFI, ABDULLAH SHARA
*Vendim:* Për pyetjen e të pandehurve të tjerë seanca gjyqësore shtyhet për në datën 12.11.1946, ora 9, paradite.

**Dt. 12.11.1946**
Merret në pyetje i pandehuri Inxhinier ABDUL MUSA SHARRA nga Vlora dhe banues në Durrës të cilit iu caktua si avokat mbrojtës z. Burhan Rusi.
Folën edhe KUJTIM BEQIRI, PANDELI ZOGRAFI, ABDUL SHARRA

Merret në pyetje i pandehuri JANI VASILI të cilit iu caktua si avokat mbrojtës z. Burhan Rusi. Në kantier ka qenë ndihmës karburant, kurse përgjegjës ka qenë Ndreçi Krati.
Merret në pyetje i pandehuri MIHAL STRATOBËRDHA të cilit iu caktua si avokat mbrojtës z. Vasil Xhaj. Më 15.4.1946 ka shkuar në Maliq si Asistent i Kantierit.
Folën edhe VASIL MANO, SCATURO EUGENIO (me anë të përkthyesit z. Adan Ardiani), ABDUL SHARRA, ZYRIKA MANO
Merret në pyetje i pandehuri ANASTAS RISTA të cilit iu caktua si avokat mbrojtës z. Burhan Rusi. Në kohën e pushtimit ka qenë kafexhi dhe ka shkuar me punë në Maliq në fund të muajit Korrik 1946. Dëshmon se nuk ka qenë me Ballin Kombëtar.
*Vendim:* Për dëgjimin e dëshmitarëve të akuzës seanca shtyhet për në datën 13.11.1946, ora 9, paradite (por në dokument është shkruar gabimisht 13.10.1946).

**Dt. 13.11.1946**
Prokurori kërkon thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve të akuzës.
Dëshmitarët e Akuzës: Islam Rapo Vila, Polikron Cane, Veli Shabani, Minella Kërënxhi, Llambi Sovjani, Petraq Isaku, Lefter Goga.
U mor në pyetje Dëshmitari Islam Vila, 23 vjeç, nëpunës në Maliq
Foli edhe ABDUL SHARRA që nuk pranoi thëniet e dëshmitarit.
U mor në pyetje Dëshmitari Polikron Cane, vjeç 29, nëpunës në Maliq
Foli edhe KUJTIM BEQIRI.
U mor në pyetje Dëshmitari Veli Shabani, vjeç 35,
U mor në pyetje Dëshmitari Minella Kërënxhi, vjeç 34,
U mor në pyetje Dëshmitari Llambi Sovjani, vjeç 30,
Foli edhe KUJTIM BEQIRI, PANDELI ZOGRAFI,
U mor në pyetje Dëshmitari Petraq Isaku, vjeç 40,
Foli edhe ABDUL SHARRA
U mor në pyetje edhe Dëshmitari Lefter Goga, vjeç 25,
Foli edhe MARIO GUARNIERI (me anë të përkthyesit z. Tomor Frashëri), ABDUL SHARRA, KUJTIM BEQIRI
Prokurori përmend edhe deklarata kundër të pandehurve që tregojnë sabotimet të dhëna nga Kleanthi Vasa, Pali Voksani, Maqo Dhosi, Aqile Zografi, Kliu Shipaka, Petro Cali, të gjithë punëtorë në kantierin e Maliqit.
*Vendim:* Duke marrë parasysh kërkesën e prokurorit, trupi gjykues vendosi bashkarisht t'i vendosë prokurorit një afat për të bërë pretencën; prandaj për t'u bërë pretendenca nga ana e Prokurorit dhe mbrojtja prej avokatëve, seanca u shty për në datën 15.11.1946, ora 3, pasdite.

**Dt. 15.11.1946**
Prokurori mori fjalën dhe bëri pretencën e tij. Avokatët kërkuan një afat për të bërë mbrojtjet e të pandehurve.
*Vendim:* Për t'u bërë mbrojtja nga ana e Avokatëve dhe për fjalën e fundit të të pandehurve seanca u shty për në datën 16.11.1946, ora 9, paradite.

**Dt. 16.11.1946**
Mori fjalën z. Vasil Xhaj: Avokat Mbrojtës i Kujtim Beqirit, Mihal Stratobërdha, Anastas Risto
Mori fjalën z. Burhan Rusi: Avokat Mbrojtës i Abdul Sharra, Mario Guarnieri, Jani Vasili
Mori fjalën z. Efthim Canco: Avokat Mbrojtës i Vasil Mano, Zyrika Mano, Scaturo Eugenio, Pandeli Zografi
Pas mbrojtjes nga ana e avokatëve u pyetën të pandehurit me radhë se ç'kishin për të thënë.
Vendim: Pasi nuk mbeti gjë tjetër për t'u hetuar seanca shtyhet për në datën 18.11.1946, ora 11, para dite për deklarimin e vendimit përfundimtar.

## *Për të gjithë të dënuarit me 5 vjet e lart konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.*

**Dt. 18.11.1946**
Këshilli Gjyqësor i Gjykatës së Lartë Ushtarake, për gjykimin sabotatorëve të Maliqit, i formuar prej:
N/Kolonel GAQO FLOQI (Kryetar)
Kapiten. I. VELEDIN ZEJNELI (Anëtar)
Kapiten. I. NEXHAT HYSEJNI (Anëtar)

### Asistuan

Sekretari Aspirant THOMA RINO
Prokurori Kapiten. I. NEVZAT HAZNEDARI
Sot, me datë 18.11.1946, ora 11, paradite, i mbledhur në sallën e Kinemasë "Nacional", në Tiranë, dha këtë vendim:
Të pandehurit për shkak se kanë kryer:

- Vepra sabotazhi me stil të gjerë dhe në mënyrë sistematike
- Vepra spiunazhi në favor të agjentëve të huaj
- Kanë formuar një grup tekniko-profesional për të sabotuar rindërtimin, fuqinë ekonomike të vendit dhe si pasojë për të përmbysur gjëndjen e stabilizuar në vendin tonë, në lidhje me monarko-fashistët grekë dhe me reaksionin e jashtëm.

Kërkesat për dënim nga ana e Prokurorisë:
- Vasil Mano – Dënim me vdekje
- Kujtim Beqiri (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u varur në litar
- Mario Guarnieri (Gjeometër) – Burgim të Përjetshëm
- Eugenio Scaturo – Dënim me vdekje
- Abdul Shara (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u varur në litar
- Pandeli Zografi (Gjeometër) – Dënim me vdekje
- Zyrika Mano – Dënim me vdekje
- Jani Vasili – 1 vit burgim kondicional (me kushtë)
- Anastas Risto – 5 vjet burgim
- Mihal Stratoberdha – 15 vjet burgim

*Për të gjithë të dënuarit me 5 vjet e lart konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.*

*Gjykata vendosi:* Fajësinë e të gjithë të pandehurve duke i cilësuar si sabotatorë dhe armiq të popullit:
- Vasil Mano – Dënim me vdekje
- Kujtim Beqiri (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u ekzekutuar në litar
- Mario Guarnieri (Gjeometër) – Dënim me burgim të përjetshëm
- Scaturo Eugenio – Dënim me vdekje
- Abdul Shara (Inxhinier) – Dënim me vdekje duke u ekzekutuar në litar
- Pandeli Zografi (Gjeometër) – Dënim me burgim të përjetshëm
- Zyrika Mano – Dënim me vdekje
- Mihal Stratobërdha – 10 vjet burgim, punë të detyrueshme
- Anastas Risto – 2 vjet burgim, punë të detyrueshme
- Jani Vasili – 1 vjet burgim me kondicional, me kusht që të mbajë sjellje morale e politike të mira.

Për të 5 të dënuarit me vdekje urdhërohet ekzekutimi i tyre në Maliq.

Për 8 të dënuarit e parë urdhërohet konfiskimi i pasurisë së tyre personale dhe humbja e të drejtave qytetare e politike.

## Akt-Akuzat

### ABDUL SHARRA

- Është vënë në shërbim të agjentëve të reaksionit të huaj dhe i shpërblyer prej tyre materialisht dhe moralisht, ka organizuar grupin sabotues në Maliq dhe në ndërmarrje të tjera Shtetnore.
- Sabotim i planit të përgjithshëm.

  a) Duke mos e zbatuar planin.
  b) Duke e zbatuar në mënyrë të gabuar.
  c) Duke kryer punime të kota, për të shkaktuar shpenzime pa vënd.
  ç) Për të vonuar plotësimin e planit.

- Ka organizuar marrëveshje me teknikë e punëtorë të tjerë duke dhënë direktiva mbi mënyrën e sabotimit dhe i ka mësuar të mos diktohen.
- Ka bërë mbledhje të shpeshta me teknikët e tjerë me qëllim sabotimi.
- U ka dhënë raporte dhe informata mbi sabotimet e kryera agjentëve të huaj dhe ka marrë prej tyre udhëzime për veprim, i shpërblyer me rrogë të përmuajshme.

Ka marrë pjesë në pyetje Kapiten PETRIT HAKANI (prokuror i Gjykatës Ushtarake të Tiranës), si edhe Sekretari HALIL GRAPSHI.

### KUJTIM BEQIRI

- Mbas transferimit të Inxhinier Sharrës caktohet kryetar i grupit Tekniko-Kriminal në Maliq në vend të tij.
- Provokon mbledhje në teknikët e grupit kriminal dhe vazhdon sabotimin me stil të Gjërë.
- Ka sabotuar në të gjithë sektorët e punës.
- Ka udhëzuar anëtarët e tjerë të grupit që të sabotojnë pa pushim dhe si të ruhen.
- Ka marrë udhëzime prej agjentëve të huaj në Tiranë dhe u ka dërguar raporte dhe informata vazhdimisht mbi të gjitha sabotimet që kryheshin.
- Ka pritur një ndërrim të shpejtë të situatës në Shqipëri.

### VASIL MANO

- Ka qenë anëtar kryesor i grupit Tekniko-Kriminal për sabotimin e punimeve të Maliqit e gjetkë.
- Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet që janë bërë në shtëpinë e tij gjetkë, ku është shtruar mënyra e sabotimit, sipas udhëzimeve të agjentave të huaj.
- Ka sabotuar në sektorin e tij dhe ka përpiluar raporte me informata për agjentët e reaksionit të huaj në Tiranë, me të cilën ka bërë edhe takime.
- Ka propaganduar për ta zgjeruar rrethin e tij reaksionar në Maliq e në Korçë.
- Ka pritur zbarkimin e të huajve në vendin tonë dhe ndërrimin e shpejtë të situatës.

### ZYRIKA MANO

- Është vënë prej kohësh në shërbim të reaksionit të jashtëm.
- Ka qenë anëtare e grupit tekniko-kriminal të sabotatorëve të Maliqit.
- Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet me qëllim sabotime, që janë bërë në shtëpinë e saj dhe gjetkë.
- Ka qenë ndërlidhëse e Grupit të sabotatorëve me agjentët e reaksionit të huaj në Tiranë.
- Ka marrë shpërblime nga agjentët e huaj.
- Ka propaganduar kudo për zgjerimin e rrethit të sabotatorëve dhe të elementëve kundër pushtetit.
- Ka pritur ndërrimin e situatës në Shqipëri.

### EUGENIO SKATURO

- Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet me qëllim sabotime me qëllim sabotimi, që janë bërë në shtëpinë e Inxhinier Vasil Manos dhe gjetkë.
- Ka sabotuar në sektorin e punës së tij dhe ka

raportuar në mbledhjet e ndryshme sabotimet e kryera duke marrë dhe udhëzime të reja.
- Ka marrë pjesë në përpilimin e raporteve të ndryshme që u dërgoheshin agjentëve të huaj, mbi sabotimet e Maliqit, duke u shpërblyer prej tyre materialisht.
- Ka pritur ndërrimin e situatës në vendin tonë.

### PANDELI ZOGRAFI

- Ka marrë pjesë aktive dhe ka qenë një nga anëtarët kryesorë të grupit sabotator të Maliqit.
- Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet ku janë vendosur mënyrat e sabotimit.
- Ka kryer sabotime në sektorin e punës që i qe ngarkuar si në kanal, gurore, eskavatorë e dekovila.
- Ka përhapur parulla disfatiste dhe anti-pushtet te punëtorët.
- Ka trajtuar keq punëtorët dhe për të krijuar atmosferë mosbesimi kundrejt pushtetit, ka mbjellë pakënaqësira ndër ta.

I është refuzuar kërkesa për lirim me kusht gjatë kohës që kryente dënimin.

### MARIO GUARNIERI

- Ka qenë bashkëpunëtor i grupit tekniko-kriminal të sabotatorëve të Maliqit.
- Ka sabotuar në sektorin e tij, sipas udhëzimeve që merrte nga Inxhinier Mano, Zyrika Mano etj.
- Ka raportuar sabotimet që kryente dhe ka patur dijeni mbi të gjitha sabotimet që kryenin të tjerët.
- Ka marrë pjesë ndër mbledhje me qëllim sabotimi.

### MIHAL STRATOBËRDHA

- Është vënë në shërbim të grupit tekniko-kriminal të sabotatorëve të Maliqit.
- Ka marrë pjesë në mbledhje me qëllim sabotimi.
- Ka sabotuar në sektorin e tij dhe ka raportuar sabotimet.
- Ka patur dijeni mbi të gjitha sabotimet e të tjerëve që kryenin në Maliq.
- Është takuar me agjentët e huaj dhe u ka dhënë atyre informata.
- Ka propaganduar ndër punëtorë kundra pushtetit dhe është munduar të zgjerojë rrethin sabotator.

### ANASTAS RISTO

- Ka qenë në lidhje me grupin tekniko-kriminal të sabotatorëve të Maliqit.
- Ka sabotuar punimet në sektorin ku ishte i ngarkuar.
- Ka hedhur parulla kundër pushtetit dhe është munduar të mbjellë pakënaqësira ndër punëtorë.

### JANI VASILI

- Ka qenë në shërbim të grupit tekniko-kriminal të sabotatorëve të Maliqit.
- Ka shërbyer si roje e si korrier të sabotatorëve të sipërm.
- Ka pasur dijeni mbi veprimet kriminale të sabotatorëve të Maliqit.

**Fletë nga dosja e Abdyl Sharrës: Procesverbal.**
**Vihet re në fund të çdo faqeje firma e A. Sharrës.**


MINISTRIJA E PUNEVE TE MBRENDESHME

Nr.

DOSJE FORMULARE

MBIEMRI

EMRI

Nr. Arkivi

# PROCES - VERBAL

Sot me daten dymbedhjete Tetor njemijenandeqind dyzet'egjashte,ne zyrat e Seksionit Sigurimit Shtetit Tirane, u-muar ne pyetje i pandehuri <u>ABDYL SHAHRA</u>,biri i Museit dhe i Mahmudies,lindur ne Vlore me njemijenande-qind e njembedhjete me banim ne Durres,me profesion ingjiner,me arsim te te larte,i martuar me dy femije,i cili deklaron si me poshte:-----------

Ne Shkurt te njemijenandeqind e dyzetes kam mbaruar studimet e larta n'Itali,kohe ne te cilen kam ardhur ne Shqiperi.Ne Prill te njemijenandeqind e dyzetes u-emeruash nenpunes ne Ministrine e P.Botore ku qendrova nj'a tre muaj pastaj u transferuash ne Berat si zev.Kryetar i zyres P.Botore.Nga fundi i Gushtit te 1940 u mobilizuaç ushtar nga ushtrija Italiane ,ne Shtator une bashke me shume shoke te tjere si Petro Peshkutari,Abedin Shehu e te tjere na derguan n'Itali ku beme nje kurs oficerash i cili va-zhdoi pese muaj e gjisem.Ne Shkurt te 1941 u graduaç N/toger ne regjimentin e tete te altilerise ne Rome si instruktor.N'Itali kam qendruar deri me Tetor te 1941 pastaj u transferova ne Shqiperi po me kete grade ne regjimentin e dyzete me qender ne Berat.Ne fund te 1941 u transferuash per ne mbrojtjen e kufive nga ana e Tetoves ku ndenja nje muaj e gjysem;prej kendej erdha ne Tirane dhe prej Tirane u transferuash perseri ne grupin e artilerise Zaf" ku qendrova dy muaj dhe ne Maj te 1942 u transferuash ne Porto-Palermo te Himares ne artileri po me graden N/Toger,ketu qendrova nje muaj e gjysem. Ne Korrik te 1942 kerkova leje per tu martuar,te cilen ma akorduan dhe u martova ne Durres me bijen e Halit Beshirit.Ne kete kohe pa lejen e komandes zvartese mora pasaporten civile dhe bashke me zonjen time shkova n'Itali per mjekime.Ne Gusht te 1942 u çmobilizuash per arsyje se me ishte merzitur kariera ushtarake dhe se lutjen qe kisha bere ne Ministrin e Luftes ne Rome me ishte mare parasysh.---------------------------

Ne kete kohe u kthyesh me gjithe gruan ne Shqiperi dhe mbas pak kohe u emeruash ne Ministrin e P. Botore ne zyren teknike, deri ne çlirimin e Shqiperise.Mbasçlirimit u paraqita ne zyren teknike te Tiranes dhe me urdher te Ministris se P. Botore u ngarkuaç me drejtimin e punimevet ne urat e qarkut te Krujes.Ne Shkurt te 1945 u transferuash se ketejmi per te kryer punimet ne dy urat e mbedha te Mifolit dhe te Penkoves .Mbas mbarimit te ketyre punimeve u transferuash ne Seksionin e Botores Dures ku meremetova uren e drunjte ne skele.Ne Prill te 1946 u caktova nga Ministrija e Botores si drejtues i punimeve te Maliqit.Ne 29 Korrik 1946 u transferuash per ne Drejtorine M.SH.S. Tirane e qe ketej u caktuash per drejtimin e punimeve ne kanalin e ures se Hasan Beut(Berat) ku qendrova deri ne 1.Tetor te ketij viti date ne te cilen u arestova.---------------------------

Me Fulsin jam njohur qe kur isha student ne shkollen teknike te Tiranes.---------------------------

Mbas luftes ky erdhi nga Amerika ne Shqiperi ne Mehar te 1945 une shkova per ti dhene mirse-ardhjen ne legaten amerikane ku qendrova 15 minuta;u pershendetem dhe bisedumm gjera familiare.---------------------------

Heren e dyte me Fulsin jam takuar po ne legate ne Prill te 1946 para se te shkoja ne Maliq,mbasi ky me kishte thene hajde nga hera,me kete rast une i thashe se jam ngarkuar me drejtimin dhe zbatimin e planit te Pushtetit per punimet e Maliqit; Ne kete rast e mori fjalen Fulsi i cili me tha tekstualisht: Ju ne Shqiperi nuk keni nje qeveri Demokratike ,Ju jeni te shtypur sidomos klasa intelektuale qe nuk ka mare pjese ne levizj

ju perbuzin,ne Shqiperi ka presion kundra çdo te drejte, ju duhet te duroni kete shtypje, te revoltoheni kudo qe te jeni ne çdo pune te moe e kryeni dhe ta sabotoni por me rezerven me te madhe ju duhet te kini besim se per se shpejti do tu çlirojne neve qe pa tjeter do te provokohet nje lufte nga

ana tone, keshtu do te fitoni lirine e te gezoni te drejtat, Shqiperine do ta bejme te lulezoje, do ta zdrukmojme, te hapij minierat, te ndertoje skela, te bejme instalime per baza navale, ruga hekuri do te bonifikojme etj.

Qeverija e sotme ndjek nje politike te njeanshme dhe mbeshtetet ne bllokun e lindjes. Fulsi si mbaroi keto fjale me dha 5 (pese) napolona flori dhe me premtoi se do te me jepte 50 napolona flori ne muaj per sherbimin informativ qe do te bejaj; mbas kesaj ky me tha qe per tu marur vesh ma mire dhe qe te njihija njerzit qe mund te dergonte Fulsi per te mare informata ne Maliq, me tregoi nje inicial, shenje trikendeshi ngjyre blu me nje pike te bardhe ne mes dhe se ay person qe do te me sillte mua Abdyl Sharres ket shenje do te kuptoja se ishin njerzit e derguar apostafat nga Fulsi; edhe une i lashe ketij pseudonimin tim me nje shenje kovencionale ( *S* ) te cilin do ta perdorja kur ti dergoja raporte. Shtojse ne perfundim te ketyre qe thashe me siper Fulsi me tha: ti te mundohesh te krijosh pa kenaqesira dhe cregullime ne Maliq, te mundohesh te besh me veper kunderahtare te Pushtetit e ti mbash ne lidhje duke ju thene te sabotojne ne pune. Bashke me te qendruam nje ore pastaj u pershendetem u ndame me njeri tjetrin duke me thene rruga e mbare.——————————————————

Me 27 Prill u nisa per ne Maliq.————————————
Ne 13 Qershor te ketij viti erdhi ne kantierin e Maliqit nje maqine xhipe me dy persona t'Unrres, e cila qendroj mbi uren e kanalit.————
Une bashke me Vasil Nanon, Pandeli Zografin shkuam ti takonim, se pastaj erdhen dhe Kyrika Nano me Vasilin, njeri prej ketyre ishte bjond dhe tjetri brun. Personi bjond i Unrres emrin e te cilit nuk e di dhe as te qkombesije ishin keta anglese apo amerikane; por kjo s'kishte rendesi per mua sepse ky i fundit me nxori nga canta shenjen qe permenda me siper d.m.th. trekendeshin boj blu me piken e bardhe ne mes; ne kete rast une kuptova se keta ishin njerezit e derguar nga Fulsi pastaj po ky person me dha ndene dore nje zarf brenda ne te cilen gjeta nje qind e pesedhjet napolona flori, d.m.th; tamam rrogat qe me kishte derguar Fulsi, te Prillit te Mait e te Qershorit. Ne kete zarf nuk gjeta ndonje shenim .——————

Ata me thane tekstualisht: Ti je Ingj. Abdyl Sharra? a e njeh kete shenje? une i thashe qe po dhe keta filluan te me kerkonin informata mbi zhvillimin e punimeve te Maliqit. Keta dy persona t'U.N.R.R.A.-se me kerkuan planin e punimeve por une nuk e kisha qe t'ja u jepja dhe per kete fillova t'ju jap shpjegime per gjithshka qe me kerkonin ata: Une i thashe se ky plan parashikon qe punimet e Maliqit te kryhen mbrenda nje Tetorit te 946-es dhe se per keto punime Shteti Shqiptar kishte caktuar nje fond prej 30,000, 000 (tridhjetmilijon) fr.shq. keta vazhduan te me thone, duhet te sabotoni punen te mos u paguani rrogat puntoreve me qellim qe keta te merziten dhe te ikin, Qeverija e sotme ne Shqiperi e mundon popullin, se shpejti do te ndroje situata dhe do te vije nje qeveri e perbere nga elementa shqiptare t'arratisur n'Itali si p.sh. Mehdi Frasheri e te tjere, ata me thane se Ballkani nuk mund te qendroje nen influencen e Rusis pse keshtu na e don interesi, por nen influencen e anglo-saksoneve dhe si pretekst per t'u bere nje turbullire ne Ballkan do te jete provokimi i Greqis nga ana e Shqiperis se Jugut e nderkaq do te zbarkojme ne per te regullnar punerat ne Ballkan.

Keta t'U.N.R.R.A-se na keshilluan qe t'ishin gati dhe te ngriheshim ne kemba vetem atehere kur te zbarkonin anglo-amerikanet. Keta na thane gjith'ashtu se per te mbajtur ndezur reaksionin ne Shqiperi keni krijuar grupe, te cilet nuk duhet te dihen nga njeri tjetri sepse qeverija e sotme eshte e forte i gjurmon kollaj prandaj na keshilluan te punonim fshehura ne menyre t'organizuar e qe te mos deshtojme.——————————————

./. 

[signature]

Une (Sharra)ju tregova ketyre edhe se sa forse puntore kishte kantier te cilat i mbajten ne shenim te gjitha sa raportuam.————————

Ne mbarim te ketij bisedimi personat e U.N.R.R.-es moren me fotografi pjesen e siperme te kanalit.————————

Keta qendruan gati dy ore dhe n'oren kator e gjysem mbas dite u larg nga kantieri me xhipe,po nuk di ne se keta kane shkuar ne ndonje vend po- saçerisht.Perveç se thashe me siper ne kete takim me te Unrres mbeme da kort edhe per dy gjera te tjerata) Kur te vinin keta me maqine ne maliq sado here do te ndaleshin mbi urene kanalit dhe se automobili do te ki te dy shenja te bardha perparu,b) Keta me thane mua qe do te na dergoni nje radio transmetuese qe te informonim mbi situaten e kantierit per te cilen i thashe edhe Vasil Manos,i cili me tha qe kur te na a degojne do te mendojme se ku do te gjenim vend te pershtatshem per instalim.————————

Mbas dy dites d.m.th. ne 15 Qershor une (Sharra ) Vasil Manua Pandel Zografi,Aleka Vasili,Zyrika Mano dhe Scaturo beme nje mbledhje ne zyren teknike te kantierit,ne te cilen shtruam per bisedim takimin e dates 13 me te Unrres.Ketu qendruam nje ore.Qe te gjithe ne te kesaj mbledhje ishim dakort me ç'ka na thane keta te Unrres.Vasil Manoja thosh te sabotojme pu- nen duke prishur eskavatore gjith-ashtu dhe Pandelhiu keshtu thosh.Une per vehte time u paraqita pak i frikshem perpara kesaj situate'Zyrika e mori fjalen dhe tha:siç na thane dhe te Unrres qe gjendja eshte shume e turbul dhe s'mund te regullohet pa nje lufte,ne duhet te japim konstributin t'one qe te sabotojme ne te gjithe sektoret e punes te kantierit si p.sh. te shka terojme maqinat,te prapagandohet qe te dezertojne puntoret etj.————————

Mbas Zyrikes e mori fjalen Scaturo i cili tha:qe kete ceshtje duhet ta mbajme sekrete qe te mos kompromentohemi ndaj organeve te Pushtetit.————————

Pandeli Zografi tha: te pengojme punen ne veshjen e kanalit me skarpa te keshtu qe me fillimin e Dimerit te mos mbarohen punimet .Ne kete mbledh caktuan Zyriken qe te kete lidhje me personat e Unrres ose me Tiranen direkt,e cila do tu jepte raportet t'ona mbi sabotimet.————————

Here pas here Vasil Mano ,Pandeli Zografi ,Aleka Vasili Mario Guarnieri e Scaturoja me njoftonin mua (Sharen) per ngadalesimet qe mu- ndoheshin te shkaktonin keta ne sektoret e tyre te punes si p.sh; prodhim ma m'i pakte i gurit te gdhendur,ngadalesim ne veshjen e skarpater te kana- lit,demtim ne makineri djegje e motorave etj. dhe krijimi i konfuzionit e i çregullimit ne kontabilitet nga ana e Skaturos.————————

Keto informata une i mblidhja vashdimisht;Zyriken e kemi derguar tre here ne Tirane mbas muajit Qershor por nuk mbaj mend ekzakterisht ditet. dij vetem se keto ardhje te saj ne Tirane beheshin ne 15 ose 20 dit nje her Zyrikes i kam dhene ne te pare dy raporte per t'a dorezuar Fulsit ne la- gaten amerikane,here me dite nje dhe heren e trete dy d.m.th. gjithesej pese raporte.Ne keto raporte kam shkruar ne vija te pergjitheshme mbi nga- dalesimin e punimevet ne te gjithe sektorete kantierit dhe mos haritjen e zbatimit te planit ne nje tetor 1946, se ne kishim prapagandhuar ne puntore se ju kishim futur pa kenaqesira,se rogat nuk ja u paguanim ne regull etj. Keto raporte kam firmuar me pseudonimin ( ) Zyrika i ka shpure te gjitha keto raporte ne legaten amerikane te Fulsit dhe kur kthehesh kjo ne Korçe nuk na sillte ndonje leter nga Fulsi vetem se ky ne per gjet kesaj na lajmeronte qe te vashdonim punen ashtu siç na ka shpjeguar te dy personat e Unrres qe erdhen ne 13 Qershor.————————

[signature]

Per pese napoleonat flori qe me dha Fulsi ne Tirane kur erdha ne Korçe ket je dhashe Pandeli Zografit te mi thyente nje here dy dhe nje here tre, te cilat m'i theu nga tridhjet'eshtate napoleona njeren.---

Ne Maliq ka ardhur Tika Temha, te cilin e kam pare vetem nje here dhe qe eshte takuar me Syryka Manon.---

Ke grate angleze CHROCE dhe NEIL te cilat kane ardhur ne shtepine t'ime ne skelen e Vlores ne Tetor te njemijenentqindedyzet'epeses ku ka qene dhe koloneli PRIGDED, i cili kishte hyre ne qira ne shtepine t'ime dhe kishte vendosur zyrat e UNRRA-s, ketu kemi biseduar disa çeshtje aktuale; koloneli i permendur ka thene se gjendja eshte e turbullte ne Shqiperi, do te kemi nje lufte tjeter, populli Shqiptar nuk e do Pushtetin e sotme, se shpejti do te zbarkojne anglo-amerikanet; koloneli tha gjith'ashtu se ne kohen kur nje vapor rus shkarkonte bereqet ne portin e Vlores, ay thosh se kishin prure me bereqet bashke edhe arme e municjon, Qeverija e sotme ne Shqiperi po mban nje ushteri te madhe ne kembe e cila nuk eshte e nevojshme. Se zgjedhjet qe do te behen ne 2 Dhjetor keto nuk do te jene te lira per te detyruara. Me kaq mbaroi bisedimi. Nje dite i kerkova pak sheqer kolonelit i cili me dha nje zarf. PRIDEN-n e kam takuar nj'a 4 a 5 here por s'kemi biseduar çeshtje politike, vetem se ne rastin e siperme.---

Me Ingjinieret: Kasimati, Gjadri, Straznimiri, Filipeu, Duarasi, Lufi, Klosi Koga, Alizotti dhe Pano te Ministris Ekon. kam patur njohje por s'kam biseduar çeshtje me karakter politik.---

1. Persa i perket mos-zbatimit te planit per punimet e Maliqit dhe pengesat e sabotimet qe kemi shkaktuar ne kete kantier, deklaroj si me poshte:---

a) Kemi penguar dhe sabotuar punen ne kanalin e math ne kete menyre: forcen puntore e kishim caktuar te pakte dhe te pa organizuar. Kur kane ardhur inspektoret e Ministris per te shekuar zhvillimin e punes ne kanal, une nuk i kam vene ne dijeni per kete zvargulli te punes, me qellim qe te mos na zbulohej qellimi t'one. Ne kete sabotim qe kam bere ne kanal kame patur bashkepuntore edhe Mario Guarnieri, Pando Saro, Tili Ndini, Gjeka Prelevig, Mihal Stratobardha dhe Henrik Klark, te cilet s'ka organizuar forcat e punes dhe s'kane qendruar vazhdimisht ne krye te saj; gjith'ashtu kam bere qe Ministris mos t'i dergoja asnje raport ose relacion te shkurter per gjendjen e punimeve.---

b) Ne te gjitha gurorët une (Sharra) me Aleks Vasilin, kemi bere qe puna te sabotohet dhe te mos jepet rendimenti i duhur, si p.sh. kur u nevojiten 500 puntore gur-gdhendes, ne vend te katyre une dergova muratore, te cilet i vonova me se njozet dit mbas kerkeses qe paraqitesh ne gurore, dhe kje menyre na favorizoj ndryshimin e krejt planit te punes ne gurore.--- Ingj. Aleks Vasili ka perdorur barut te zi i cili eshte m'i shtrenjte se i verdhi.---

c) Ne lokomotorat, eskavatorat dhe motorat e tjere edhe ketu punen e kemi sabotuar dhe kete nisjative e kane mare Vasil Mano dhe Pandeli Zografi; lokomotorat dhe skavatoret i reparonin me vonese te madhe kur prishesnin; ne shtrinjen e linjes se dekovilit ku ka qene pergjegjes Pandeli Zografi ay ka bere qe kjo te mos zgjatesh aqe sa duhesh dhe ne disa vende s'e kishte shteruguar mire. Nje menyre tjeter qe ingj. Vasil Mano ka perdorur per te penguar punen, eshte çeshtja e moto-kompresorit i cili qe prishur nga teknikat italiane dhe kur erdhen mekanikat jugosllave qe t'a ndreqnin kete moto-kompresor, Ingj. Vasil Mano me t'a mare vesh kete i hoqi nga Maliqi dhe e shpuri ne Korçe qe te mos vihej ne sherbim te punes.---

Vasil Manua nga ana tjeter ka bere gmos qe te favorizonte dhe te mbronte tekniket italiane.------------------------------------------------

d)Mekaniket Jugosllave te cilet i dergojti Ministrija per skavatoret ne Maliq,keta kane t'afte teknikisht,mirpo une ne bashkepunim me Vasil Mano i heqëm nga kantieri duke i derguar ne Korçe e ne Durrës.------------------

Pergjithesisht tekniket italiane si p.sh.Mario Guarnieri,skavatoristet Antonio Lorizzo, d'Agostini Antonio e Baga Pierino dhe mekaniku Piccolo,jane munduar te sabotojne ne pune duke u mbeshtetur ne udhezimet qe leshonim neve nga lart per kete qellim.------------------------------------------

P.S. M6 Maj te 1946-es s'mbaj mend mire daten kam shkuar ne shtepine e Vasi Manos ku gjeta Vasil Manon,Zyrykun doktorin Rizzo dhe Scaturo-n,atje qendro va sa piva nje kafe.Gjate kesaj kohe te shkurter biseduam çeshtje politike duke komentuar Scaturua,Vasili dhe Zyrykambi politiken e sotme te qeverise italiane te cilet ishin pro kesaj politike dhe thane se Italia vertet u shkaterua,por me ndihmen e anglo-amerikaneve do te mekembet perseri.Si piva kafen u-ne(Sharra) ika dhe ata i lasha ne shtepi te Vasilit.---------------

2) Persa i perket zhvillimit te punimeve ne urat e qarkut te Krujes vertetoj se jam munduar qe keto te mos kriheshin ne kohen e duhur.

3) Persa i perket punimeve qe me qene ngarkuar per te ndertuar urat e Mifolit edhe te Penkoves per te cilat Ministrija me kishte dhene plane ;keto nuk i kam kryer n'afatin e caktuar por i kam bere te zgjaten dy atri muaj me teper.

Persa kam shkruar dhe deklaruar me siper jane te verteta dhe i nenshkruaj me firmen t'ime.------------------------------------------

I Pandehuri
Ingj. Abdyl Sharra.

AIDSSH

SHTOJC PROCES - VERBALI

Sot me daten 12/X/46 ne zyren e seksionit sigurimit Tirane u mar ne pyetje i arestuari Ingj. Abdyl Sharra i cili deklaron si me poshte:---

Ne lidhje me pese raportet qe i kam derguar Pulait vertetoj sa me poshte:---

Me raportin e pare kam shkruar se punimet filluan ne 5 Maj dhe se do te mbarojnin ne Tetor te 1946. Punimet ishin ndare ne tre faza te ndryshme:ne kanal,ne gurore per pregatitjen e gurit e skalitur si dhe ne kantierin ku do te ndreqeshin te gjitha maqinerite qe do te prisheshin. Puna ne kanal me ishte ngarkuar mua kurse ajo ne gurore ishte ngarkuar Ingj. Aleks Vasilit,kurse ajo ne kantier i ishte besuar Ingj. Vasil Manos Puna ne kanal ishte ndare ne kater faza te ndryshme:faza e pare qe ajo e germimit te tokes deri ne siperfaqe te ujit si dhe pjese e skarpatevet te jashtme.Kjo pune do te behesh nga 3000 puntore vullnetare nedite.Faza e dyte ishte ajo e germimit dhe thellimit te mezit te lumit me qellim qe thellimi te humbiste kenetan e fundit te kanalit .Qellimi i ketij germimi dhe thellimi ishte ay i mbeshtjelljes se ujravet te lumit mune ne mes te ketij si dhe qe niveli i ujit te ulesh me qellim qo te mund te punohesh nga te dyja anet e lumit sh puntori dhe eskavatora.---

Faza e trete e punes ishte ajo e germimit per nxjerjen e skarpates se dyte dhe vendit per themelin qe do te mbante skarpaten prej guri.---

Ndermjet skarpates se fundit si dhe germimit e fazes se dyte do liheshin dy rypa dheu te cilat do te sherbenin per mbajtjen e ujit te lumit -e keshtu te punohesh nga te dy anet e kanalit per nxjerjen e skarpatevet; qe keshtu paralelisht te vazhdohesh me veshjen e skarpatevo

Faza e katert ishte ajo e fundit qe do te perfshinte germimin e te dy rypavet te dheut qe sherbgen per mbajtjen e ujravet te lumit.Germimi me zonen e dyte do te behesh nga 6 skavatora tue punue me dy turne . germimi i zones se trete do te behesh nga puntore dhe eskavatora.---

Germimi i zones se katert do te behesh nga puntorija.---

Per germimin e zones se pare do te perdoreshin 3000 puntore dhe per keta ishte parashikuar qe te germonin nga nje metre e pesedhete m3.) ne dite tue perfshi edhe transportin e tij jashte kanalit qe arinte mesatarisht nje distance prej 1.0 m.---

Kaq sa me ju vene ne dijeni mbi planin e punes qe eshte shtruar per sbatimin e punimeve te kanalit te Maliqit .---

Ketu kam biseduar me Pandeli Zografin,me ingj;Vasil Manon si dhe me Ingj. Vasil Aleksin edhe neve kena me sabotue secili ne sektorin e vet me sa te mundet.---

Po ju ve ne dukje tue ju thene se ketu jeni shumica e madhe puntoresh qe vashgojne punen.Keta njerez persona te qeverise vashgojne vashdimisht punen.Keta njerez te Pushtetit bejne vashdimisht axhitasionin ne puntori,aq sa ne çdo sektor ku nga nji asistent te vene apostafat per me ndejte gjith diten ne kontakt me puntorine si dhe ketyre ju bejne axhitasion.Une ketu mundohem t'u flas puntorevet kur nuk gjenden prane keta njerez te Pushtetit tue ju thene ketyre qe te mos punojne te mos vine ne pune tue thene shokevet te tyre ne fshatra qe te mos vine se juve lini punen tuaj dhe te vini ketu e te punoni angari.Ketu ne kanal puna nuk shkon mire.Numuri i puntorevet nuk ka ardhur aq sa eshte parashikuar,mbasi si duket keta nuk vine me vullnet por i marin me pahir.Katundaret gjejne preteks se ata kane punera te tyre por qeverija i mer me force,fshataret mundohen ne çdo menyre qe te mos vinene Maliq.Keta thone se kane punerat e tyre ne fshat,kane per te korur si dhe per te shire te lashtat,se kane per te ujalle miserat nen uje e shume aresyje te tjera thone kur i pyes une.Shumica e tyre nga e keqija se skane seç te bejen dergojne femijt e vegjel me qellim qe te mos punojne ~~per te sabotojne~~

Puntoret te influencuar nga prapaganta t'one po ngadalesojne punen dhe si rezultat eshte se rendimenti i tyre ne pune nuk arin asnje metro kup ne dite dhe.Ne mundohemi qe forcat puntore ti grumbullojme sa me ngusht te ne pune qe te kete konfusion dhe puna te ngadaleschet e te sabotohet. Une here pas here bashke me te tjeret e rrethit tim kam bere provokime nder puntoret dhe ju kam thene qe pse punoni per te kuptuar se deri ne ç'mase kishte influencuar prapaganta tone tek keta.Puntoret pergjigjeshin se nuk hame mire,nuk fleme mire,kemi lene shtepite tona presin familiet pa buke dhe gjithe punet tona qe ska se kush te na i beje.Une jam pergjegjur qe me te vertete ashtu eshte dhe se duhet te dini nje gje qe puna e Maliqit eshte nje pune e madhe dhe shume zor per tu kryer.——————————

Eskavatoret ketu i kemi te vjeter dhe aprodhojne fare ne pune ne te shumten e kohes nuk i veme ne pune por i mbajme ne gjendje te prishur. Ne keta (eskavatoret)na ndihmon edhe çeshtja pse nuk kemi vegla per kompletimin e tyre,gje e cila na intereson per ngadalesimin epunes.Shtoj se per punimet neMaliq eskavatoret kane rendesi te madhe dhe ne kete menyre ne i kemi kushtuar nje kujdes qe te sabotohet sa me teper puna e tyre, ne lidhje me kete ne vepronim qe oret vullnetare te eskavatorit etj nuk ja u regjistronim me qellim qe keta te deshperohen gje e cila eshte konstatuar. Eskavatori edhe kur punon e derdhin dheun jo larg maqinave me qellim qe te nevoiten puntore per ta hequr balten ose per ta perdorur edhe nje here eskavatorin.Keta na ana tjeter benin qe te fundoseshe eskavatori te punonte atje ku toka ishte e bute dhe ky te mbeteshe brenda pa pune per disa dit me radhe.Edhe une (Shara ) veçanerisht me anen e rrethit tim qe jam perpjekur per sabotimin e punes ne gjithe sektoret e saj ,por edhe personalisht kam bere qe puna ne kanal te sabotohet sa me mire dhe si shembell sjell punen e dizorientimit te forcave puntore ne kanal dhe taktiken teknike te shtrember dhe te gabuar kundra planit te punes .——————————

Ne lidhje me njohjen time me Fulsin shtoj si me poshte:——————

Kete e kam njohur qe ne shkollen teknike te Tiranes i cili ka qene si Drejtor i shkolles dhe qe kam qendruar shtate vjet me te,mbas çlirimit te Shqiperise kur erdhi Fulsi ne Shqiperi ne beharin e 1945 shkova dhe e takova ne legaten Amerikane bisedova me te çeshtje familiare dhe me tha qe kam takuar n'Itali vellane tend i cili ishte mire nga shendeti dhe me tha q kur te vesh ne Shqiperi takohu me Sharen dhe i thuaj mbi gjendjen time.——

Ne lidhje me takimin qe kam bere me Fulsin ne Legaten Amerikane para se te shkoja ne Maliq shtoj : une Shara jam ngarkuar me drejtimet e punimeve te Maliqit.Mbas kesaj fjale ay filloi te me flase kundra Qeverise duke me thene se kjo nuk eshte nje qeveri demokratike por nje qeveri Komuniste qe mbahet nga politike te nje anashme e lidhur me bllokun e lindjes me Rusine.Dhe se ky regjim e ka shtypur klasen intelektuale kurse kjo ne shtetet me te vertete demokratike te Perendimit eshte e privilegjuar.Prandaj qe juve si intelektuale qe jeni duhet te qendroni kundra ketij regjimi dhe te jeni te sigurte se kjo situate ska per te vazhduar keshtumbasi anglo-amerikanet nuk do te lejojne qe ballkani te jete nen influencen e Ruservet dhe se nje lufte etrete botnore do te pelase pa tjeter.Mbasi ta çlirojme Shqiperine nga ky regjim ne do te bejme qe kjo te lulezoje,do te veme ne di pozision per nevojat e saj te gjitha ndihmat e duhura.Ne kete rast ay me tha qe une te beja gishte e mundur qe punimet ne Maliq te ngadaleschesshin s me pare,te mbillnim pakenaqesira nder puntoret sa here qe te gjenim rastin. Ne lidhje me çka permenden ne proces-verbalin e pare rreth ketij takimi me Fulsin ky me tha dhe kete:Duhet qe ti Shara te mbash sekretin me te math dhe mos te kallzosh askujt per te mos dale ne shesh personi i im(Fulsi)qe jam duke lojtur kete politike kundershtare me qellim qe te mos na diktojne organet e Pushtetit se ata do te me veshgojne e s'do te kem mundesi qe te takohem me njerez te tjere Shqiptare per te mbajtur gjalle nje qendrese kundra Pushtetit te sotme.Fulsi shtoj se edhe sikur te binim nje dite ta doren e organeve te qeverise duhet te rezistonim dhe te mbani sekretin me te math duke insistuar.——————————

Ne 13 qershor qe erdhen dy persona te Unrras keta u ndalen tek

ura mbi kanal ,une shkova i pari qe u takova me ta pastaj erdhi dhe Ingj. Vasil Manoa ,Aleks Vasili e Pandeli Zografi;une u hoqa me njane bashke me njerin prej ketyre te Unrres i cili ishte i vjeter nga mosha mesyza dhe bjond nderse tjetri po bisedonte me Vasil Manon etj.Personi i permendur me tregoi shenjen konvencionale ,trikendeshin ngjyre blu me piken e bardhe ne mes e cila me la te kuptoja se ishin te derguara nga Fulsi,dhe ky pastaj me shtroi udhezimet e mara nga Fulsi per sabotimin e punes te Maliqit Ky me tha qe per kete pune te vija ne dijeni edhe shoket e mij me te ngushte qe keshtu puna te pengohesh ne çdo sektor por me porositi qe grupi te ishte sa me i vogel me njerez intelektuale qe mos te bijshin ne sy,te gjenim rastin te provokonim mos kenaqesira nder puntore te vononim ndreqjen e maqinerive e te tjera gjera qe kane te bejne ne proces .Ky me tha gjithashtu se do te na binte nje radio transmetuese qe keshtu te kishim nje lidhj direkte me misionin amerikan ne Tirane ne kete menyre ~~dha~~ ay- do te evitohet ardhja e jone ketu.Me ne fund ky nxori prej gantes nje zarf dhe me tha qe ketu brenda ke rogat qe te dergon Fulsi; une vertetoj se keto te holla nuk i mora per i thashe atij qe ti thoshte Fulsit qe keto te holla tja dergonte vellait tim n'Itali.-----------------------------------------------------

Shtoj se persa i perket perdorimit te radios qe do te na sillnin te Unrras,une bisedova me Pandeli Zografin dhe Ingj. Vasil Manon dhe i thashe te mundoheshin te gjenin nje vend te pershtatshem per ta vendosur ket kur te na vije dhe bashkerisht menduam qe kete bare perfunksionimin e radios t'ja ngarkonim mekanikut italian Adolf Piccolo,natyrisht ky do te vepronte ne baze t'udhezimevet qe do te na vinin per kete qellim bashke me radion nga Tirana;mirepo me mekanikut ne fjale nuk i-a bone nje propozim te tille.-

Ne mbledhjen e dates 15 Qershor q'u mblodhem ne zyren teknike une(shara),Vasil Manoja,Pandeli Zografi,Zorika Mano,Aleks Vasili dhe Scaturo, te cilen mbledhje e bera une me inisiativen t'ime ne lidhje me udhezimet qe me dhane dy personat e Unrras ny dit me pare.Une ne kete mbledhje shtrov te gjitha çkam me kishte thene Fulsi personalisht dhe çka me thane te Unras.Ne perfundim te kesaj mbledhjeje caktuam Zyriken per te shpure raportet informative te punes tone sabotonjese ne misionin amerikan ne Tirane,me qe kajo ishte grua,e zgjuar ,si e buaj dhe e pa okupuar nga ndonjepune ne kantier siç ishim neve .-----------------------------------------

Shtoj se Fulsit i kam derguar 5 raporte mbi situaten e punimeve dhe çkishim vepruar neper sabotimin e tyre .Kur kam derguar keto kam thirur personalisht Zyriken perjashta ne kantier te ciles i kam dhene raportat tre here me radhe edhe e kam keshilluar keshtu; ti do te shkosh ne Tirane per te dorezuar keto zarfe ne legaten Amerikane prandaj duhet te kesh shume kujdes si gjet udhetimit nga ndonje kontroll eventual qe mund te te bejne organet e mbrojtjes ,ashtu edhe kur te hish ne legate te ruhesh dhe mos te diktohesh nga te jashtemit.Kjo (Zyrika) me sigurol duke me thene qe mos te kem merak dhe se do ta kryej kete pune me se miri.-------------------------

Te tre heret qe kam derguar me Zyriken ne legaten Amerikane raportet ,Fulsi me ka derguar tri letra po me Zyriken per-mbledhjen e te e te cilave po e tregoj me poshte.Ja ç'me shkruante ne to:Raportet qe me ke derguar i kam mare duhet qe te vazhdoni dhe ta shtoni sa me teper sabotimin ne pune duke bere qmos qe plani i punimeve t'asaj ndermarjeje mos te kryhet n'afatin e caktuar qe keshtu me von me fillimin e shirave te mbedha te demtohetne menyre seriose.Provokonim mos kenaqesi nder puntoret,mos i paguanim ne regull shkaktoni disorganizime ne pune ,ne perdorimin e puntoris.te beni ato pune qe nuk jane te nevojshme duke lene prapa punen me te nevojshme.Gjith-ashtu kjo menyre veprimi duhet te perdoret edhe per eskavatoret duke i levizur keta poshte e lart, te mundeni ti prishni eskavator dhe vononi riparimin e tyre sa me teper.----------------------------------

Mbi anen politike me shkruante keshtu: Jashte maredheniet midis shtetevet te mbedhenj po keqesohen dhe s'mund te bien ne nje marreveshje Politika nderkombetare eshte e ndare ne dy bloqe n'ate te Lindjes dhe n'ate te perendimit,ne lidhje me kete ,ceshtjen e Shqiperise ne Konferencen e Paqes neve te blokut anglo-amerikan, duhet ta dime, se jemi duke kunderashtuar vazhdimisht kerkesate e saja duke ju derguar raporte ...

se ne Shqiperi nuk ekziston nje qeveri Demokratike por nje qeveri Komuniste e cila mer direktiva nga Rusija.Kemi raportuar se Populli Shqiptar vean se klasa intelektuale pasaniket dhe tregetaret jane te gjithe te shtypur dh vuajne nga kjo qeveri e sotme.--------

Shqiperija-me shkruante Fulsi nuk eshte per tu pranuar ne Konferencen e Paqes dhe as ne te te Unos.Pretekset Greke kundra Shqiperise jane menyra se te perahtateshme per tu shkaktuar nje lufte e trete e aq me teper per Ballkanin te cilin anglo-amerikanet do te perpiqen te shkeputin nga influenca e Rusise Komuniste.Prandaj ju duhet te beni durim se dita e lirinit nga ky regjim i sotme ,do te jete e shpejte.Ju duhet te jepni kontribitin tuaj duke sabotuar ne te gjithe sektoret e jetes se shtetit ku beni pjese.Kini kujdes dhe ruhuni shume qe veprimtarija tuaj te mos kompromentohet sepse qeverija e sotme eshte vigjilente dhe mund te bini shpejt ne gracka .Duhet qe keto letra mbasi ti kendoni me nje here ti gdukni e ti digjnime nje here qe keshtu mos te dali ne shesh kjo pune qe po ben misioni Amerikan ne Shqiperi duke qene se ky eshte nje mision diplomatik i derguar per qellime te tjera pacifike(paqesore).--------

Keto fjalet e fundit i ka thene edhe gojarisht kur u takova me te ne legate.--------

Une Shara them se porosija qe me ka dhene Fulsi per te mbajtur si nje keshtje sekrete dhe qe ne rast se mund te kapesha te rezistonja kjo ka influencuar shume tek mua gjat zhvillimit te procesit.tim dhe kam mbajtur reserven me te madhe per aresyje qe keto vepra mos te zbulosheshin me qene se demaskohem dhe dilte ne shesh politika armiqesore Amerikane kundra Shqiperise.--------

Ne mbledhjen e 15 Qershorit une i kam vene ne dijeni te gjithe sa ishim atje mbi shenjen e nderlidhjes qe kisha une me Fulsin e njerzit e Unras duke i thene se eshte nje trikendesh bije blu me nje pike te bardhe ne mes.--------

Shtoj se ne Maliq kemi pasur nje instrument ,vegel inxhinerije qe sherben per kuotat e pikave te profilit te kanalit.Une per kete ju kam thene dy personave te Unres qe ne rast se vi ne Maliq ,ne do te lidhim nje shami te bardhe ne kete instrument e qe kajo do te kallzonte vendin se ku gjendeshim neve ne kanal dhe ne rast se ndonjeri prej nesh nuk do ti gjente tek ura mbi kanal qe mund te ndaleshim;duke pare kete shenje ata mund te vinin te takoheshin me neve .--------

Ne lidhje me informatat qe i dhashe personave te Unrres ne 13 Qershor 1946 rreth planit te punimevet vertetoj se une kam shjeguar ne kete menyre.--------

Per planin e punes i thashe atij personit te Unrres se kanali qe nga ura e poshte ishte tre kilometra i gjate dhe do te kishte nje gjeresi ne fund prej 25 m. kurse gjeresija e tij ne siperfaqen e tokes arijti deri ne 50 mentra;Ky kanal do te kishte dy skarpate te cilat do te ndaheshin njera nga tjetra nga dy bankina nga nje metro gjeresi secila,tendenca e skarpateve do tiante nje metro e gjysem,skarpata e jashteme e ketij kanali do te vihesh ne gure te gdhendur .Ketij Skarpata do te mbeteshin mbi themele prej blloqesh guri me dimensione nje metro me 60 centimetro. Kanali ne fun de te tre kilomentravet do te kishte nje brilie 2 metra te gjene me dy metra te thelle, mbasandaj ne cdo 50 ose 60 metra do te kishte nga nje brilie tranversale nga nje metro e gjysem te thelle me nje metro e gjysem te gjane d.m.th. do te kishte gjithsesj nga 60 cope brilie tranversale. Keto brilie do te ndreqeshin me gure te mbedhenj te perzier me cimento. Qellimi i ketyre brilieve ishte ay i mbajtjes gjithenje te pa lujtshme ne shtratin e lumit.Ky kanal do te heqi njekubature prej 240 M3 uje ne sekonde kur thellesija e ujit ne te arinte afro tre metro dhe ky kanal do te terhiqte cilka(gati)600 m. uje ne sekonde kur thellesija e ujit te kalonte bankinen prej afro 1,50 m.d.m.th.do te kishte nj'a 5,50 m. shpejtesija e ujit ne kete rast mund te kalonte te dy metrot e gjysme ne sekonde.Gjate ketyre tre kilometrave kanal duhet te regullohesh grykat e te gjitha projeve qe shkarkoheshin ne te.Gjith'ashtu duhesh te regullosheshin pengesat e te gjitha ketyre projeve mbasi keta sjellin shume gurre e zhavor dhe keshtu mbushin kanalin,pjesa e kanalit nga urra deri mbrenda ne kete,ky kanal do

./.

[signature]

të jetë 2400 m. i gjatë dhe do të ketë gjerësi në fund prej 15 m. kurse do t'ishte i thellë afro 4 m. këto dy kanale do të nëshosin nga një urë e re e cila do të mbante paratojat. Këto paratoja do të janë të hekurta dhe kanë me shërbye për rregullimin e portatës së ujit nga kanali i math në kanalin e poshtëm,këto paratoja do të lëvizin me anë të motorave. Nga çelja e këti kanali kanë me monifikue 5000 hektarë tokë dhe kanë me a përmirësue fushat rreth e përqark liqenit,të cilat llogariten në afro 5000 hektarë të tjera.

Për sa deklllarova ma sipër vërtetoj se janë të vërtata dhe i nënëshkruaj me firmën t'ime.-

I p a n d e h u r i:
(Ing. Abdyl Shara)

AIDSSH

## SITUACION RRETH INGJ.ABDYL SHARRES

**Biografija:** 1. Ingj.ABDYL SHARRA: Ka linder ne Vlore e banues familjarisht ne Durres, me sherbim ne Ministrine e P.Botore, i caktuar per drejtimin e punimeve ne ndermarjen e Maliqit, dhe tash se fundit u-transferua ne punimet per hapjen e kanalit ne Uren e Hasan Beut Berat. Ne kohen e okupacionit ka qene Oficer efektiv i Ushteris Italiane. Mbas clirimit u-prek nga reformat e Pushtetit; babai i tij u-burgos per ca kohe dhe vellai ju denua si kriminel lufte nga gjyqi i popullit. Paraqitet kundershtar i Pushtetit.

**Sabotimet:** Ka del si element me i shquar per sabotimet dhe pengesat e shkaktuara ne punimet e Maliqit, drejtimin e se cilles ndermarje e ka pasur vete ky. Ky sabotim i math q'i kushtoi Pushtetit qindra-mijra fr.shq. dhe me humbje kohe, del ne shesh se ka qene organizuar nga Ingj. Sharra me klikon e tej dhe me permjet tij nga pensterimi i reaksionit te huaj.. Ne te gjitha drejtimet ka bere qe puna te mos shkoje mbare, duke krijuar kondita te favorshme per sabotime. Ne kete ceshtje ka patur bashkepuntore te ngushte si Ingj.Aleks Vasilin, gjeom.Mario Guarnierin(italian), Ingj.Sotir Piluskën, gjeom.Pandeli Zografin e Kyrëka Nenon. Ka qendruar spektator ne zhvillimin e punimeve, s'ka dashur te preokupohet ne pergjegjesine q'i ishte ngarkuar dhe drejtimin e tyre e la ne meshiren e fatit. I permenduri ka ndaluar shtimin e forces puntore ne kantier me qellim qe puna te mos ecte perpara. Ska bere ndarjen e mire te reparteve te punes, s'ka krijuar zyren teknike q'ishte teper e nevojshme, nuk zoteronte gjendjen dhe s'dinte se c'behej dhe s'ka bere asnje raport mbi situaten e punimeve (Ministrise). Kur eshte bere ngrehja e kantierit ka harxhuar mjaft shpenzime pa vend.

Ingj.Sharra na ka penguar punen edhe ne ngritjen e urrave si p.sh. n'ate te Kifolit.

[illegible]

**Lidhjet:** Ne nje here mbas clirimit te Shqiperise, ingj.Sharra ra ne lidhje me reaksionin anglo-amerikan, me te cilet ka bere takime te shpeshta sidomos ne Vlore me kolonelin FRIDDEY (Unrra), i cili e ka rekomanduar me elementa te dyshimte si Ali Babogin, Sadik Sorën e Ibrahim Shytin. Gjith'ashtu te tilla takime ka patur edhe me gruan angleze GROCKE, në Sarandë.

Ne kantierin e Maliqit me nisjativen e tij ka krijuar nje grup, teknike te dyshimte e qe jane: [illegible] Ingj.Aleks Vasili, Sotir Piluska, Pandeli Zografi, Mario Guarnieri, Vangjo Treska dhe Kugi Dino. Ingj.Sharra ka patur lidhje edhe me Qemal Shehun e Isuf Zholin, ky i fundit i lidhur me njerez t'Unrra-s. Sharra eshte perpjekur qe keta t'i aktivizoje per kundra Pushtetit ne sabotime me qellim qe puna e tyre te shtrihej mire e te kishte efektin e duhur ne puntoret. Fakti

qe nga katieri dezertuan gati 600 puntore, disfatizma qe i hyri mases punonjese dhe mos besimi ndaj Pushtetit, i dedikohet punes reaksionare t'ingj.Sharres me klikan e tij.

I pepermenduri ka lejuar elementa t'Unnra-e te hyne ne kantier dhe te marin informata dhe skicen e punimeve. Veper kjo qe peshon rende ne mos-ruajtjen e sekreteve te Shtetit. Nga sa thame me siper, ingj;Sharra eshte koka e sabotashit q'u vertetua ne Maliq..

Ne Berat ka rene ne kontakt me keta elementa:Mustafa Demirin, Kigo Beratin, Hajri Kadiun, Patbardhe Zharren e ingj. Thoma Filipin, me te cilet ka biseduar ne forme te dyshimte.

AIDSSH

**Fletë e dosjes me të dhëna për Kujtim Beqirin**



GJENERALITETI I KUJTIM ALI BEQIRAJT NGA VELGA

Kujtim Beqiraj, emeri i babes Ali, emeri i nenes

Lindur ne katundin Velge dhe banues familjarisht ne Durres, vjeç [illegible]
Profesjoni student, nepunesia Inxhinjer, i martuar, emeri i gruas [illegible]
Pate, studime Universitare, gjuhe te huaja di te shkruaj dhe t[illegible]
flasi gjermanisht dhe italisht, rrjeth nga shtres e pasur fshatar[illegible]
Feja Muhamedan Shqipetar, gjendja ekonomike e gjat e mire.

Biografia:

Kujtimi ka qene nje nga organizatoret dhe eksponentet e [illegible]
llit Kombetar, te bere pjes ne Komitetin Qarkor te Ballit ne Vlore [illegible]
tiviteti i tij politik ka qene i qquar per shtimin e radhve te ba[illegible]
dhe per organizimin e tyre kondra forcave te Frontit N.Çl. ; ne [illegible]
liggjenen e tij nuk ka lene gje pa perdorur ne kurriz te popullit [illegible]
menyre te ndryshme organizimi, nderse si ushtar me arme nuk ka ma[illegible]
pjes ne operacjone, vetem se [illegible] organizimet e punes ne [illegible]
tet, nga kjo nuk ka ndo nje [illegible] ne forte nga populli ne kete j[illegible]
dimiem se nuk ka marr pjes ne operacjone; fakte te shumta duhet t[illegible]
ne Vlore ku ka ushtruar aktivitetin e tij kondra popullit.

Familja e tij ka qene dhe e kemi e lidhur ngusht me armi[illegible]
qoft si Fashist ape nazist se qe vellai i tij (Mehmeti) asht i [illegible]
rtuar me grua Gjermane dhe sot asht i arratisur jasht shtetit.

Persa i perket qendrimi te tij sot nuk e dim ne qe si asht [illegible]
mes (Inxhinjer) sh te sherbyer ne vise te ndryshme te shqiperis.

I Besuari i N/Prefektures Kotes

Nr. 15

**Një nga informatat rreth aktivitetit të Abdyl Sharrës ku "Bleta" informon se inxhinier Sharra u thyen hovin e punës punëtorëve kur ata angazhohen ta mbarojnë punën në një afat shumë të shpejtë.**



V.1073

INFORMATE

Ne kethimin nga nje udhetim per inspektim Ingj.Sharhaj qe punon ne
degen teknike me tha se te duket ty qe je ne i vjeter ne Ministri , a ndj[illegible]
net nevoja e teknikeve Jugosllave ne lidhje me punen.
Me kete kuptohet se i permenduri ka njaft te zhvilluar frymen Nacjona-
liste ( nuk eshte Komuniste) e kemi ne kujdes .
Hajdin Mete asistent i kantjerit qe ngrihet ndrukt[h]erije Misto Mame ne
nje mbledhje qe puntoret ishin duke marre angazhim qe kjo pune te mbarohej
me 15 Shtator u thyen hovin e inisjatives punoreve duke ju thene shikoni
puntore kini per te bere nemiro metro suve e çati prandaj mos te merret
angazhim i shpejte , kjo parrulla e te permendurit u godit me nje here ne
nje mbledhje te dyte qe beri inspektori i Ministris dhe angazhimi mbeti per
tu mbaruar me daten 15IX/946 por i permenduri duhet patur ne kujdes pse
ka qene ish sipermarres.-

" Bleta" 8/IX/946.-

**Fletë procesverbali. Bie në sy përcaktimi “rrethi i tij i gjithë reaksionar, familje bejlerësh në Vlorë“.**



Vlore. Z.A.Jones,me daten 29/XII/45 kane vajtur ne Vlore s
bashku me perkthyesin Shaban N Balla.Ne Vlore kane vizituar Sh
len sebashku me kolonelin Friday.Ne oren 10 para dite jane nis
per ne Sarande.Ne Sarande jane takuar me Abdulin Shera e Skend
Frasherin.

V L O R E. Antaret e UNRRA e Zejushe CROCKE dhe [illegible] jane t
takuar ne Vlore me MITO FRASHERIN dhe SKENDER FRASHERIN dhe mbasi
shetiten pak shkuan ne shtepi te Skenderit.
Me daten 17 jane nisur per ne Sarande,me daten 17/XII/45 u
kthyen nga Gjirokastra bashke me [illegible],Kane shkuar tek tr
getari SKID KRUTA ku aty jane takuar me Ingj.ABDYL SHARRA dhe se
bashku me Abdylin kane shkuar ne Kartolerin e Rekip Begesa.
Me daten 18/XII/45 u nisen per ne Vlore.

Ingj. Abdyl Sharra (Ingj. ne Seksionin e Uravet).

Aftesija ne Pune.- Ingjinier i ri por i afte teknikisht, dhe i zoti per organizim punimesh. Nuk ka vrullin e ndergjegjshem ne pune, por punon pse asht i specializuem ne teknik, siç jane dhe shumica e Ingjiniervet ambicioz. Synon me heshtje per ndonji posite ma te mire.

Qendrimi Politik.- Rrethi i ketij i gjithe reaksjonare. Prej familjesh bejleresh te Vlores. Tip i pa kenaqun, sidomos ka pa- kenaqesi i asht shtue me rastin e denimit te jatit te tij si armik i popullit. Nuk ndjen dhe nuk punon per Pushtetin, e sotshem, mbasi nuk e lidh kurrgja me te.

**Shënime për procesverbalin e Avdyl Sharrës.**
**Jepen udhëzime që procesverbali duhet zgjeruar.**



140

Shënime mbi Proces verbalin e
Abdyl Sharrës.

1) Të shikohet mirë qëndrimi përpara .... .... —
2) Që kur është njoftur me Fulvin? Si i foli
me një herë për sabotim? (Parat që mori).
3) Si i rregulluan lidhjet me një herë? (Agjent [illegible]
(Ka informata seksioni I-të?).
4) Ç'farë udhëzime konkrete i dhanë atje te
Ulmadres për sabotimin?
Kush dilte përfaqësues [illegible]?
5) Forca (3). Si u lidhëu me organizimin e tyre?
Ç'punë kanë bërë përpara?
Më 9 maj rregull [illegible] — [illegible] e [illegible]
nga rojali (sabotimi).
Ç'kanë bërë.
6) Si ia u kanë dhënë lidhjet [illegible]
Ulmadres (po [illegible] Amerikanvet)?
Pse e caktuan [illegible] (Të shikohet mirë [illegible]
armëte? letra, kapselet? — — —
Po përgjigje? udhëzime të reja?
Po personat e Ulmadres [illegible] i u shpeg[illegible]
gjë?

duhet zgjeruar. —

**Fletë raportimi për lëvizjet e A Sharrës kur punonte në Berat.**



DREJTORIJA E SIGURIMIT [illegible] VDEKJE [illegible]
(SEKSIONI SIGURIMIT [illegible]) LIRI POPULLIT
B E R A T

Nr. 899/1 Prot.

899

50

[illegible]at më 26/IX/946.

DREJTORIA SIGURIMIT [illegible]

T I R A N Ë

Në lidhje me shkresën t'uaj Nr.08-185 dat 9/[illegible] këtu poshtë ju përshkruajmë takimet dhe lëvi[illegible] që ka bërë në këtë Qark me elementët e dyshimtë Inxhiner [illegible] Sharra.

Ky qëkur ka ardhur këtu ka shërbyerë pranë [illegible] marrjes Shtetnore, gjatë ditëve të para ky qëndronte [illegible] por tashti në kohët e fundit sidomos gjatë këtij muaji [illegible] konstatuarë që të bëjë takime me disa elementa ku nga bis[illegible] e rezervuara që këta bëjnë me [illegible] të dyshojmë.-

Takimet e tija janë me Murtezë Demirin [illegible] në Bankë, Kiço Beratin Drejtor i Bankës Shtetit, [illegible] Kadiu Përgjegjës i ndërmarrjes Shtetnore, [illegible] teknik ndërmarrje, Thoma Filipin nga [illegible] Inxhiner me shërbim në [illegible] në. Ka ardhur për inspektim [illegible] me këtë të fund[illegible] ka shumë takime.

[illegible] shumë na [illegible] të dyshojmë sebebi se më [illegible] 24/IX/946 kur fliste [illegible] Inxhiner Filipi me gjith[illegible] lin qeshin me mënyrë [illegible]

Ndonjë lëvizje tjetër nuk i kemi konstatuarë.

Shefi i Seksionit Sigurimit Shtetit
([illegible] Halili)

**Deklaratë e inxhinier A. Sharrës.**



55

DEKLLARATE

Une Ingj.ABDYL SHARRA deklaroj se gjate zhvillimit te punimeve qe une kam qene pergjegjes,na eshte sabotuar puna prej vjetit 1945 e deri sot si ne poshte.—

Ne uren e Mifolit punimet na jane sabotuar ne kamparvin e fundit nga ana e Vlores,per kete na eshte bequr vrejtja nga Ministrija e Botores. Nuk kam bere asnje situacion rreth punes qe zhvillohesha ne uren e Mifolit,per arsye se i kam raportuar verbalisht. Sabotimi i ures se Mifolit i dedikohet asistentave te derguar prej Ingj. Stacioli t,asistent Jessi Vamillos dhe nje fare Karlinos,te cilat mundoheshin me ç'do kusht qe punimet e ures ne fjale te mos i perfundonin ne kohen e caktuar dhe nga ana tjeter perpiqeshin me ç'do menyre te mos vinin materialin e caktuar ne pllan me qellim sabotimi.—

Veç kesaj une di se na eshte sabotuar puna tek ura e Penkovës te Vlores nga Ingj.Tamulini e Munaj te dy banuesa ne Vlore,keta jane munduar me ç'do kusht qe te mos mbarohet ura ne kohen e caktuar dhe shpesh here mundoheshin qe urren te mos e benin me materialin e paracaktuar me qellim te mos rezistonte dhe si fakt mund te permendim santatullave elektrike dhe shterngimin e bullonave.—

Puna ne Maliq na eshte sabotuar.Ingj.Aleks Vasili nuk ka plotesuar punen dhe kur i kerkoheshin sasit e gurrit qe nevojiteshin ai dergonte sasira te vogla. Veç kesaj ne Maliq na eshte sabotuar puna ne rrugen e dekovilit prej Ingj.Vasil Manos dhe gjeom.Pandeli Zografi duke shkaktuar rezultimin e punes per nje kohe te gjate.—

Po ne Maliq puna na eshte sabotuar dhe ne kanalin prej gjeom.Mario Guarnieri,gjeom.Pando Sara dhe nga asistent Tili Nàni,Gjaka Prelevig,Mihal Stratobardha dhe nje Polak,qe te tere keta jane munduar me ç'do menyre qe te ngadalesojne punen me qellim sabotimi,per keto sabotime une dihesha te raportonja Ministrise per nga neglizhenca t'ime nuk ja kam raportuar dhe kjo eshte nje faj per mua; me nje fjale puna ne Maliq na eshte sabotuar ne gjithe drejtimet.Dhe nje tjeter shembull po paraqes ate te Ingj.Vasil Manos, i cili ka shkaktuar vonesen e nderrjes te moto-kompresorit per nje kohe te gjate.—

Anglezet nuk kane ardhur ne Maliq. Asnje parulle nuk kam degjuar ne Maliq.Petro Bicken nuk e njoh. Per punen e dezertimeve te puntoreve asgje nuk dij gje. Me asnjeri ne Maliq nuk kam biseduar per puna politike.Asgje tjeter nuk di per ne Maliq.—

Tirana,me 5/10/1946.-

Dekllaruesi:
(Ingj.Abdyl Sharra)

Abdyl Sharra
A.Sharra

**Raport i inxhinier A. Sharrës për punimet në urën e Mifolit, Vlorë.**



Vdekje Fashizmit-Liri Popullit

Durres 6/IV/46

Ministria P.Botore
(Drejtoria Rruga-Ura)

Tiranë

Simbas urdhërit t'Uej nr.71/8 datë 29/III/946 shkova në Mifol ku kontrollova punimet e saldaturës elektrike, të cilat janë krye mirë dhe në bazë të urdhnave që dona nga Drejtori Rruga Ura Z.Ing.Gjindri.

N'atë Urë vazhdojnë punimet e lyemjes me bojë vaji, por tue qenë se numuri i specjalistëve, vetëm 4 vetësh, asht i pakët, këto punime mundë të zgjatën afro dy muej. Prandaj për mbarimin e shpejtë të bojatisjes së Urës do t'ishte mirë që Ajo Ministri të urdhëronte Ish Sipërmarrjen Stacciali që të shtoj numurin e bojaxhijve.

Në këtë rastë njoftojmë at Ministri që nuk asht marrë ndonji masë për terheqjen e materjalit nga Ura Mifolit, si nga Seksjoni i P.Botore Qarkut Vlorë ashtu dhe nga Sipërmarrja Shtetnore.

Ing.Abdul Sharra

**Urdhër i Ministrisë së Brendshme për seksionin e sigurimit të shtetit për vëzhgimin e inxhinierit A. Sharra.**



V.F.L.P.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E P. TË MBRENDSHME
DREJTORIJA E SIGURIMIT SHTETIT

Tiranë, më 3/9/ 1946

Nr. 01-165

SEKSIONIT SIGURIMIT TE SHTETIT

Korcë

Ne punimet qe [illegible] per hapjen e kanalit ne [illegible] Hasan Beut si drejtor eshtë derguar Inxhiner Avdul Shara.

I permenduri te survejohet [illegible] qendrimin e tij te keq politik duke na njoftuar [illegible] konstatimet t'uaja mbi tij [illegible] per çdo here qe ky largohet prej atij qarku te na njoftohet [illegible] ne qarqe te tjera.

Kjo nuk vlen vetem [illegible] por duhet te vlejë per ter kohen qe ky do jetë [illegible] n'atë qark.

P. MINISTRI I P. TE BRENDSHME.

**Deklaratë e shkruar nga A. Sharra ku pranon të dënohet me vdekje sipas ligjit ushtarak në fuqi nëse i provohen lidhje me armiqtë e pushtetit.**



73

Deklaratë

Unë i nënshkruari Ing. Abdyl Sharra i [illegible] Pirgge-
gjësë [illegible] në Kampin e Maliqit deklaroj se në rast se më
vërtetohet nga ndonjë gjeometër ose Inxhinier se që
unë të kem dhënë ndonjë plikë (zarfe) nënpuna-
sit të Ushtrës kur kanë ardhur në Maliq për vi-
zita gjithë ashtu edhe në qoftë se kam marrë unë nga
nënpunësit e Ushtrës ndo një zarf, pranoj që në
bazë të ligjeve në fuqi, të ligjit Ushtarak
të nenit 18 germës A. edhe të nenit 18 germës
G. të dënohem me vdekje (të pushkatohem).

Deklaroj
Ing. Abdyl Sharra
[illegible]

Tiranë 10.X.46.

AIDSSH

**Dokument si nëpunës në Ministrinë e Punëve Botore**






**Listë e inxhinierit A. Sharra për punonjësit e huaj që punonin në ndërtimin e urës së Penkovës.**



95

E L E N C O degli operai che lavarano a Penkova. Militari

1°)- MANCINI Gino di Domenico e di Beni Rosa, nato il 21/2/1915 a Fiuminata ( Macerata).

2°)- MORELLINI Vivaldo di Armando e di Roboli Onorina , nato il 13/10/1919 a S.Michele di Bagnolo Piano (Reggio Emilia)

3°)- BARATTI Rinaldo di Giuseppe e di Montanari Adalgisa; nato il 18 marzo 1916 a Calderara di Reno ( Bologna)

4°) DI GIACINTI Egisto fu Giovanni e di Grilli Angela Adele; nato il 17/1/1911 a Offignano (Ascoli Piceno)

5°)- PANIZZA Giuseppe fu Eraldo e di Mantovani Arta, nato il 1/10/1916 a Cazzoni di Luzzara (Reggio Emilia)

6°)- GIACOBELLI Pietro fu Venerio e di Bianchi Marianna; nato il 27 maggio 1917 a Villa Minozzo (Reggio Emilia)

7°)- MARCHETTI Emelino di Angelo e fu Nannari Iside, nato l'8/4/1920 a Forcoli (Pisa)

8°)- LAURINO Salvatore di Pasquale e di Gasti Giuseppina, nato il 4/12/1913 a Tito ( Potenza);

9°)- MICAI Franco di Giovanni e di Cristofori Rosa, nato il 13/7/1921 a Corenella ( Ferrara)

10°)-MATTINA Raimondo di Pasquale e di Immo Giovanni, nato l'11/11/922 a Milena (Caltinessetta)

11°)- FATTORI Giovanni di Federico e di Belletta Filomena, nato il 19/2/1911 a Cingoli (Macerata)

12°)- ZANARDI Giovanni di Battista e di Peretti Maria, nato il 23/12/1923 a Pronitngano (Brescia)

13°)- VULLO Vincenzo di Giuseppe e di Lamalaco Antonina, nato il 15/giugno 1922 a Mussomeli ( Caltanissetta)

14°)- AMICI Domenico fu Vincenzo e di Geini Scolastica, nato il 2/10/1920 a Montecavallo (Macerata)

15°)- D'IGNAZI Gioacchino di Sante di Marzini Teresa, nato il 21/10/923 a Monsampolo del Tronto (Ascoli Piceno)

16°)- FAINI Pierino di Giuseppe e fu Michelini Elvira, nato il 13/12/923 a Melzo (Milano)

17°)- MANNI Claudio fu G.Battista e fu Vaselli Annunziata, nato il 16/2/1911 a Monteroni D'Arbia ( Siena)

18°)- RICCI Mario di Nazzareno e di Nicoletti Colomba, nato il 28/2/923 a Marta ( Viterbo)

19°)-ROVBA Gino di Luigi e di Zoppeletto Sennta, nato il 19/4/1915 a Gazzo (Padova)

20°)- DI SCALZO Libertario fu Angelo e di Ceccherini Giuseppina, nato il 9 /11/1920 a Vecchiano ( Pisa)

21°)- MALAVOLTA Renzo di Giuseppe e di Barbieri Guglielma, nato il 23/6/1916 a Bondino (Ferrara)

22°)-LABATTIA Antonio di Antonio e di Crisci Lucia, nato il 22/3/1920

AIDSSH

26°)- DE DOMITIS Domenico di Francesco e fu Assunta Vecchioni nato il 10/9/1915 a Pescara.

27° )-Mainqua Giulio fu Raffaele e Feragati Santina nato il 14/4/1911 a Fermo

F.to Ambrosano

AIDSSH

31) BUCCARI Imolo di Aurelio e di Porchetti Ottavia, nato il 29/9/1919 a Collestatte (Terni)
32) SBARGANI Enrico di Costantino e di Arbiancsi Maria, nato il 22/12/1914 a Preia (Macerata)
33) MARRA Gaetano fu Gaetano e di Di Guido Brisia, nato il 22/3/1917 a Calimera (Lecce)
34) MICCI Franco di Giovanni e di Cristofori Rosa, nato il 13/7/1921 e Coronella (di Ferrara)
35) PERLA Emilio di Angelo e di Garaffini Adele, nato il 21/10/1907 a Monterchi (Arezzo)
36) BILLA Guido fu Bortolo e di Broccardo Maria, nato il 4/1/1911 a S.Orso (Vicenza)
37) DALLA VECCHIA Faustino fu Giovanni e di Dalla Vecchia Faustina, nato il 30/7/1911 a Tretto (Vicenza)
38) PIETRI Bruno di Sperandio e di Canini Davide, nato il 24/11/1913 a Mandario (Reggio Emilia)
39) Pronesti Paolo di Michele e di Ferrara Antonio, nato il 30/9/1915 a Nuow Jorch (S.U.A.) e residente ad Avellino
40) D'ANTONIO Guido di Giuseppe e di Sabbotina Annunziata, nato il ~~[illegible]~~ 5/12/1922 a Costelalta Canzano (Teramo)
41) ZAMPER Egidio fu Antonio e di Coloricchio Elisa, nato il 30/9/1923 a Cervignano (Udine)
42) BERTOLETTI Pietro fu Giuseppe e di Cerri Teresa, nato il 30/6/1921 a Ciovedolmi (Cremona)
43) FRAPICCINI Giuseppe di Luigi e di Giovagnoli Teodora, nato il 22/4/1916 a Recanati (Macerata)
44) PROSPERI Corinto di Paolo e di Melutiori Iamata, nato il 12/6/1916 ad Atanasio Cadefranco (Teramo)
45) MELOTTI Mario fu Ernesto e di Tinorelli Adolfa, nato il 24/5/1916 a Castelfranco Emilia (Modena)
46) DI GERARDO Carlo di Alfredo e di [illegible] Coselli, nato il 26/1/1922 a Isola del Gran Sasso (Teramo)
47) CERVI Valsenc di Santo e di Bognesconi Angela, nato l'1/12/1914 a Brescello (Reggio Emilia)
48) PANCIROLI Pietro fu Antonio e fu Franchi Elinda, nato il 25/5/1914 a Villa Cadè (Reggio Emilia)
49) MENICHELLI Dante di Antonio e di Fusori Rosa, nato il 15/3/1921 a S.Severino (Macerata)
50) CARLI Giovanni di Giuseppe e di Valente Angela, nato il 7/1/1916 a S.Pietro in Gù (Padova)
51) STORTI Elia di Costantino, e di Vezzosi Maria, nato il 15/3/1921 a Vico Belligpano (Cremona)
52) TAMBALEO Michele fu Tommaso e fu Nicolò Angela Rosa, nato il 1/1/1919 a S.Giulio (Napoli)
53) MUSOLINI Girolamo fu Tommaso e di Cua Giuseppina, nato il 12/6/1904 a Careri (Reggio Calabria)
54) LOBCIO Fioravante di Filippo e di Favo Francesco, nato il 24/4/1920 a Penna (Pescara)
55) ANTONINO Beniamino fu Giovanni e di Angelini Melitiore, nato il 17/7/192[illegible] a Campano (Teramo)
56) GIACOBBE Giuseppe di Pantaleo e Sciutteri Angela, nato il ____________ a Bordonaro (Messina)
57) MARCHI Argi di Ferdinando e di Righi Udosin, nato il ____________ a Limiti di Salemma (Modena)
58) CAMARDA Bruno fu Giuseppe e di Schirripa Maria, nato il 16/4/1919 a

62) NICCI Mario di Nazzareno e di Nicoletti Colomba, nato il [illegible] a Lerte ( Viterbo)

63°)- GOBELLANI Guido di Giuseppe e di Maria Servoli , nato il 10/I/1923 a Garano (Pola)

F.to Amadana

AIDSSH

**Fotot: Vasil Mano me bashkëshorten e tij Zyrika Mano**





Sot me daten tetembedhjete Tetor njemijenandeqinddyzet'egjashte,ne Zyrat e Seksionit Sigurimit Shtetit Tirane,u-muar ne pyetje i pandehuri Ingj. VASIL MANO,biri i Theodhorit dhe i Aferditee te dy te gjalle,lindur ne njemijenandeqind e dymbedhjete ne Korçe me arsim te larte,mbaruar studimet n'Universitetin e Torinos(Itali) Ingjiner i Ministris Botore me sherbim ne Maliq,i martuar pa-femije,i pa denuar,i cili deklaron si më poshte:--------------------------------------------------------

Aktiviteti t'im kundra Pushtetit ka filluar qysh ne vjetin 1945 ne punimet e urrave te ndryshme si p.sh.Ura e Kupit,e Mbrostarit,e Pallasës e Becir Efendiut,e Petranit e Lanës etj.Gjate ketyre punimeve kam ndjere mos kenaqesi nga ana e eproreve,mbassi mua me dukej sikur nuk e çmonin punen t'ime.--------------------------------------------------------

Me 15 Prill te njemijenandeqind dyzet'egjashtes kur isha ne Shkoder si kryetar zyre dhe qe isha ngarkuar me ndertimin e **Molos** te Shen-Gjinit, ketu qendrova fare pak afro 20 dit,vendin t'im e zuri Kujtim Beqiri dhe une (Vasili) me urdherin e Drejtoris Ndermarjes Shtetnore u kthyesh ne Tirane. Kjo me ngarkoi me sherbim ne kantierin e Maliqit si drejtues i krejt punimeve duke me thene se do te kesha nen mvaresine t'ime keta ingjinere:Aleks Vasilin,Pllushkën,perveç gjeometrave qe do te na dergoheshin dhe si ndihmes te porheresben Ingj.Sharrën,i cili ishte caktuar kryetar i Zyres teknike te Degës Korçes. Mirpo me te arrijtur atje Drejtorija e kantierit ne vend in t'im caktoi Ingj.Abdyl Sharrën si drejtues te krejt punimeve dhe mua(Vasilit)me ngarkuan repartin e kantierit dhe punimet e brendeshme.Mua kjo me beri pershtypje duke me shkaktuar pa-kenaqesi dhe njekohesisht te humbes besimin t'im ndaj Pushtetit.-----

Keshtu fillova nga puna me zemër te thyer dhe mundohesha qe te ketilla pa-kenaqesira te krijonja dhe n'elementa te tjere si p.sh.tek Hans Vala,Luigj Feci,Eugenio Scaturo etj.--------------------------------

Punimet ne Maliq duhet te fillonin me pesë Maj dhe te mbaronin me 1.Tetor po te vitit njemijenandeqind dyzet'egjashte. Ne **fillim** dukej sikur puna shkonte mire por pas pak kohe pashe se kjo filloi te ngalonte. Kjo i dedikohej krejtesisht Abdyl Sharrës.i cili nuk desh te tregonte asnje interesim qe puna te shkonte mbare pse ky(Sharra) siç do t'a permend dhe me poshte eshte elementi i cili ne lidhje me reaksionin e jashtem perpiqej dhe na shtronte tek ne te gjithe pergjegjesat e tjere te reparteve te kantierit propaganden dhe udhezimet per menyrat e sabotimit ne planin e punimeve te ketij kantieri. ------------------------------------

Per keto ngadalesi te punimeve une bisedova me gruan t'ime Zyryka duke i thene qe une s'po mar vesh si shkojne keto punime,ajo me tha le të shkojne si te duan,ti veshtro ate qe te kane ngarkuar dhe mos u bej merak per te tjerat.--------------------------------------------------------

Ne Maliq kishim dhe Pandeli Zografin i cili ishte ngarkuar me pergjegjesine e lokomotoreve dhe transportin e gurrëve nga gurroret/Une kam konstatuar se pas pak kohë puna filloi te ngadalesohej dhe te mos tregohet kujdesi i duhur nga pergjegjesi ne fjale(Pandeliu). Per keto konstatime te mija u fjalosa me ingj.Abdyl Sharrën qe si do te veje puna kreshtu Abdyli me nje buzeqeshje ironike me tha:" e ç'mejton t'i more se do te punojme si hamaj,apo mejton se me keto mjete qe kemi do te mbarojme kanalin ne kohen e caktuar? Kanali nuk mbarohet as mot ne qofte se U.N.R.R.A.

**Fletë nga proces-verbali i marrjes në pyetje të inxhinierit Vasil Mano**



124

SHTOJCE PROCES VERBALI

Sot me 24 Tetor 1946, ne Zyrat e Seksionit Sig.Shtetit ne Tirane, u rimuar ne pyetje e burgosura Zyrika Manua, dhe mbasi u pyet dekllaroj si me poshte :

"Para 6-7 ditevet se te nisesh Sharra per Berat,ne Maliq kishte ardhur Kujtim Beqiri per t'a zevendesuar. Gjate ketyre ditevet Sharra provokoi nji mbledhje me qellim qe ky te prezantonte bashkepunetoret e tij Kujtim Beqirit.

Mbledhja u be 2-3 dite para se te largohesh Sharra, ne zyren e tij. Ne kete mbledhje benin pjese: Ing.Sharra,Ing.Kujtimi,Hana Vala,Pandeli Zografus,Scaturus,burri t'im-Vasua dhe Aleks Vasili. Une, ne kete mbledhje,s'kam bere pjese; porse qellimin e mbledhjes dhe ç'ka u bisedua atje ma vune ne dijeni burri t'im-Vasua dhe Ing.Kujtim Beqiri.

Ne kete mbledhje,te permendurit kishin biseduar si me poshte: Sharra kishte bere prezantimin e gjithe bashkepunetoreve te tij,Ing. Kujtim Beqirit dhe njikohesisht kishin shtruar problemin e sabotimit ç'ka ishte bere deri ate dite dhe ç'do te behesh. Ishte vendosur qe puna e sabotimit te vazhdohesh si me pare,mbeshtetur programit qe Sharra kishte shtruar ne mbledhjen e 15 Qershorit dhe se lidhjet me Kujtimin duhesh t'ishin me te shpeshta per arsye se Kujtimi ishte i ri ne pune dhe per t'u orientuare keto lidhje qe keta kane patur me Sharren, t'ja njoftojshin Kujtimit me te shpeshta.

Sharra kish thene: "se per lidhjet qe kemi ne Tirane me Fulxin do te shkonte vete te raportonte punen se si ay kishte lene zevendes Kujtim Beqirin dhe se Fulxi,per punerat e Maliqit,t'i mbante lidhjet me Kujtimin.

Mbas dy dite te kesaj mbledhjeje,Sharra u nis per Tirane dhe nga Tirana i kishte derguar nji leter Kujtim Beqirit ne menyre indirekte,ne te cillen shkruante se punet me Fulxin i kishte rregulluar dhe se shpejti Kujtim Beqirit do t'i vente lidhja. Me sa mbaj mend une letra e Sharres fliste keshtu: "u takova ne Tirane me vellan tend me te cilin kam biseduar gjate,prandaj ti mos u preokupo se çeshtja eshte e rregulluar". Fjala vella,ishte Fulloi. Kur ka ardhur kjo leter nga Sharra Kujtimit,ay me ka thene vete se kishte marre leter,dhe veç kesaj,ay me tha se Sharra eshte njeri shume i zgjuar dhe punon me sistem dhe eshte nji element shume i vlefshem për né.Kjo kuptohet haptazi nga letra qe me kishte derguar,e cila fliste per vellane,me qellim qe ne rast se kjo leter,do te kontrollohesh ose do te binte ne duart e Sigurimit,te mos kuptohesh permbajtja. Per te tillo elemente si Sharra,kemi shume nevoje. Gjithe keto bisedime ay mi ka thene verbalishte,duke qene vetem ne te dy.

Mbas ikjes se Sharres,Kujtim Beqiri ja filloi punes se tij se bashku me shoket,si me pare per sabotimin ne Maliq. Mbas pak dite te largimit te Ing.Sharres,Kujtim Beqiri perpilloi nji Raport te punes per Fullxin,te cilin me dha mua per t'ja quar Fulloit ne Tirane. Kur une mora Raportin nga Kujtimi per te Fulxi,ka qene prezente dhe burri t'em-Vasua.Kujtim Beqiri me tha: se kishte pregatitur nje Raport dhe se ishte nevoje t'i shkonte Fulloit se me pare.Une kete nuk desha t'a çoja por burri t'em-Vasua me tha se kjo duhesh te vente pa tjeter dhe une shume lehte mund t'a çoja tek Fuloi me anën e Bianka Maliqit.Keshtu me tha Vasua,qe te mos kishja as me te voglen frike. Une Raportin nuk e kendova,por e dija me siguri se qe perpilluar me

**Fletë nga procesverbali i marrjes në pyetje të znj. Zyrika Mano**

**Akt-akuzë për të pandehurin Eugenio Scaturo**



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
PROKURORIJA E GJYKATES NALTE
U S H T A R A K E
Nr. 96 Regj.

Vdekje fashizmit
Liri Popullit

125

A K T - A K U Z E
( K O M U N I K A T E )
GJYKATES NALTE USHTARAKE
A R T O

Sikurse do te konstatohet dhe nga proçes-verbalet e mbajtura prej Seksionit Sigurimit Shtetit Tiranes, qe bashkangjitur paraqiten, i pandehuri EUGENIO SKATURO, i biri Françeskos dhe i Sanuzes, vjeç 29, lindur ne Leçe t'Italis e banues ne Tirane, me arsim te larte, me profesion llogaritar ne Kantierin e Maliqit, i rreshtuar me daten ________ akuzohet se:

1) Ka marre pjese ne te gjitha mbledhjet me qellim sabotimi, qe jane bere ne shtepin e Ingjiner Vasil Manos dhe kudo gjetke.

2) Ka sabotuar ne sektorin e punes se tij dhe ka raportuar ne mbledhjet e ndryshme sabotimet e kryera duke marredhe udhezime te reja.

3) Ka marre pjese ne perpillimin e raporteve te ndryshme qe u dergoheshin agjentave te huaj, mbi sabotimet e Maliqit, duke u shperblyer prej tyre materialisht.

4) Ka pritur ndrimin e situates ne vendin t'one.

Mbassi faji i tij parashikohet i ndeshkushem prej Nenit 1 te Ligjit Nr.21 date 15 Dhjetor 1944, mbi sabotatoret e Pushtetit, dhe Nenit 15 te Ligjit Nr.41 date 14 Janar 1945, mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake, eshte pare e nevojshme qe ky te gjykohet.

P r a n d a j:

Kerkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji qe akuzohet, ne perfundim te vendoset ndeshkimi i tij ne baze te Nenit 15 te Ligjit Nr.41 date 14 Janar 1945, mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake.-

Tirane, me 6/XI/1946.-

P R O K U R O R I:
( Kapiten'i Ire Nevzat Haznedari)
Nevzat Haznedari

**Fletë nga procesverbali i marrjes në pyetje e të pandehurit Pandeli Zografi**



**Proces-Verbal**

I mbajtur sot, me daten 7/10/946 ne dhomen e Prokuririe se Gjykates Nalte Ushtarake, para meje Kapiten Petrit Hakani, me cilesi Prokuror i Gjykates Ushtarake te Tiranes, duke qene i asistuare prej Sekretarit Halil Grapshi, u thir dhe u muar ne pyetje i pandehuni PANDELI ZOGRAFI, bir'i Dhimitrit dhe i Elenit, vjeç 34, lindur e banus ne Korçe, i martuare me nji djale, me Aresim te mesme, profesjon Mekanik, i pa denuare ndonji here me Vendim Gjyqi, me profesjon te ma perahem si Kondoktor Rrugash, i cili mbasi u pyet deklaron si ma poshte:------------------------------------------

Çprej Clirimit te Shqipnis deri ne 15 Prill 1946 kam punue ne Seksionin e Botores te Prefektures Korçes si Teknik duke sherbyer me nji roge prej 1050 Frangash. Me 15 Prill te ketij viti u gradova Gjeometer ne punimet e Kantierit te Maliqit me roge baze 1200 Franga. Deri ne kete date qe shkova me Pergjegjesi Gjeometer ne Maliq nuk kam pasun ndonji urejtje karshi Pushtetit Popullor, por siç do ta shpjegoj dhe ma poshte qysh me njofjen e pare qe pata me Inxhinjer Abdyl Sharen, i cili qe ngarkuare nga Ministrija e Puneve Botore si Drejtor Teknik i zhvillimit te punimeve te tharjes se Maliqit, fillova te ndryshoj Opinijonin karshi Pushtetit Popullor dhe te ushqej nji urejtje kunder tij. Inxher Abdil Shara patai besim te me flase haptazi kundra Pushtetit Popullor pse ai njifej me mue qysh ne Shkollen Teknike kur ishim nxanes. Persa Kohe qe ndejtem ne Korçe bashke me Inxhinjer Sharen nuk bisedues çashtje politike por me ardhejen e tij ne Maliq si Drejtor Teknik ai filloj per nji here mbitasjonin e tij tek mue per kundra Pushtetit Popullor ne menyre sistematike dhe te rafinuar, ne fillim filloj te paraqise te pa mundeshme punimin ne Kantierin e Maliqit dhe ne kondita shume te veshtira qe na nuk mundeshim ti perballonim, si, p, sh, mungese Lokalesh fjetje per N/Punes etjere, mungese Menxa per N/Punes, Ushqim te keq mungese mashinerish veglash punonjese dhe teknikesh te ndryshme, keshtu qe ai ne fillim me bindi se Pushteti i Popullit kerkon te baje pune pa mjete dhe me sakrifice shume te madhe, ai thosh se keto pune nuk kryhen me Vullnetare, tharja e Ligenit te Maliqit do Miljone Napolona dhe teknike te personin, keto fjale zune vend tek une dash e pa dash. Mandej ai vazhdimisht filloj te propagandoje tek une dhe duke u bazuem ne aprovimin qe une i bajshe mendimeve t'atija ai besoj tek une dhe çfaqi haptas qellimet e tija per kundra Pushtetit Popullor, duke paraqitun situaten e brendeshme ne Shqipni shume te turbullte se Qeverija Demokratike e Shqipnis ishte nji Qeveri Terrorriste qe shtypte pakicat si: Nacjonalistat dhe gjithe Intelektualet qe nuk kishin kontribue ne Luften Anti-Fashiste. Me fliste per situaten Politike Nder Kombetare, ndamjen e saj ne dy blloqe ne ate te Perendimit me Anglo Amerikanet ne krye dhe ne ate te Lindjes me Bashkimin Sovjetik dhe se shpojti keto dy Blloqe do te ishin ne nji lufte.------------------

Provokacjonet Greke, thoshte ay jane nxitje te Anglo-Amerikaneve per nji agresjon karshi Ballkanit dhe se nji Sulm i Forcave Anglo - Amerikane kundra Shqipnis ishte çashtje ditesh dhe keshto do te shpetojshim nji here e mire prej kesaj Situate te krijueme ne disfavorin tone.---------------

Keshtu Inxhinjer Abdyl Shara brenda nja 15 diteve qe propagandoj tek mue me bindi plotesisht se bota gjendej ne pragun e nji Lufte te trete Botnore dhe se Neo-Fashistet Greke do te Sulmonin pa tjeter Shqipnin, me ndihmen e Anglo-Amerikaneve dhe se jeta e Qeveris Demokratike ne Shqipni ishte me dite. Kur ai pa mire se prapaganda e tij e kishte ba efektin e duhun tek une, filloj te me flase se: Ne kete gjendje te krijueme na nuk duhet te rime me duer kriq, duhet te ndihmojme edhe na ne rrezimin e Push-

**Letër- rreshtim për në burgun e Tiranës për Mario Guarnierin**


REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E
GJYKATES USHTARAKE E NALTË

214

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

Nr. 100 i R.P.

Letër - rreshtim

Kondra:

Mario Guarniari bir i Giuseppes dhe i Grusepinës

vjeç 37 nga Italija me profesion Gjeometer

Efektiv

Akuzohet

Se Ka sabotuar punimet në Italie

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nen 1 i Ligjit Nr.21.D.15.XII.45 mbi sabotatoret e Pushtetit dhe Nenit 15 i Ligjit Nr.41 Date 14.I.45 mbi organizimin e funksionimin e Gjyka.Ushtarake.

Ne Prokuror'i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenevet te sipërmë.

Urdhërojmë:

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranes

Organet e M. P., Policia dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet më zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

Tirane më 5.XI. 1946

PROKURORI
Kapiten'i Ire Nevzat Haznedari
Nevzat Haznedari

KRYETARI OSE ANTARI
Major Frederik Nosi

AIDSSH

## Letër –rreshtim për në burgun e Tiranës për Mihal Stratobërdhën



222

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E
GJYKATES USHTARAKE E NALTE

Nr. 101 i R.P.

Vdekje Fashizmit - Liri Popullit

Letër - rreshtim

Kondra:

Mihal Statoberdha bir'i Llukes dhe i Linoses

vjeç 34 nga Korça me profesion Asistent'i puni

Efektiv

Akuzohet

Se ka sabotuar punimet në Maliq

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenit 1 i Ligjit Nr.21 D.15.XII.4 mbi sabotatoret e Pushtetit dhe Nenit 15 i Ligjit Nr. 41 Dt 14.I.1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjyka.Ushtarak

Ne Prokuror'i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenevet të sipërme.

Urdhërojmë:

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranes

Organet e M.P., Policis dhe çdo faqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e kësaj letër-rreshtimi.

PROKURORI

Kapiten Ira Nevzat Hazmedari
Nevzat Hazmedari

Tirane më 5.XI. 1946

KRYETARI OSE ANTARI

Major Frederik Nosi
F.Nosi

MOD. 651

AIDSSH

**Fletë dëshmie e punonjësve të thirrur si dëshmitarë kundër inxhinierëve**



DESHMUES IKUZES

NELLA KERENXHI,PER PANDELI ZOGRAFIN

Ne Brigaeda e Rinise me ka derguar nje llokomotor te prishim,me qellim qe te me pengonte punimin per 500 puntore dy dite resht.

2) Ka mbushur peruan e Maliqit me dhe,me,qellim qe te vinte dekovilin,nga ana tjter me kete veprimtari kerkonte te hoe ekspozohej kur te vinte per roj me uje dhe t'a derthte te gjithe kete matrjal ne lume. Udesh te punoj nje eskavotor tete dite me radhe. 3000 m3 zhavorr.

PER ING.KUJTIM BEQIRIN:

1)Nuk pohoj pengimin qe i beri Brigaedes se Rinise,duke mos urdheruar dergimin e lokomoretrin. Ka penguar 12000 m3 germim e trasport,me gjithese thihesh ne mbledhjen teknike,iskuzuari thoshte se do te dergojme dy eskavatore.

PER ING.ALEKS VASILIN:

1) Ka ndaluar Venin e eskavotirit ne brylin I-re pikete 33-60 me preteksse do t'a kryenim me punetore. Kemi harxhuar 3000 puntore dhe nuk u kryeas 1/10 punes,mbassi rentabileti ishte i paket me puntori,me qe toka ishte e njome(argjoloze baltez keqe)

**Fletë dëshmie e punonjësve të thirrur si dëshmitarë kundër inxhinier Kujtim Beqirit, Vasil Manos, Aleks Vasilit, etj.**

Dëshmitar

POLIKRON CANGJA, AKUZON ING. KUJTIM BEQIRIN

833

1°- Iakuzuari nuk ponoj se ka bere 315 ml. themel ne [illegible] te kanalit, duke dhene udhezime per sabotimi dhe as qe e vuri ne dijeni ne mbledhjen te nike. Punuan 12 punetore e muratore per 12 dite rresht. Mbi [illegible] komunikua ky sabotim iakuzuari u detyrua t'i boje perseri, duke prishur punen e bere dhe suri te justifikohet sikur e ka bere Asistent Gjok Prelevic.

2- Ka lojtur nje rol ne ulzertimin e punetoreve nga puna, duket iu thene: sikur te largohi nuk kanë se ç't'u bëjne. Keto akuivitet e ka treguar ne kohen e fundit. _ Dëshmi [illegible] .

3- Udhezimet e Ministris qe qene qe te hapej nje savanello (hendek te thell ne kanalin (shtretin e lumit) me qellim qe te mbledhe ujrat dhe te jepe mundesi te punohet ne kanal per t'arritur ne kuote. Kjo u be objekt bisedime dhe nuk realizua.

4- Ka grumbulluar forca te shumta ne sektorin e "[illegible] Adhamit". Me gjithe se ky grumbull pengonte punën, te terhiqte verektyten per nje ergullim te tille, por inalparuendurit, iakuzuari nuk tregoj interesin e duhur. Ketu ka sabotuar sistematikisht.

5-

PER VASIL MANON-E:

1) Kerkonim llokomotore per te transportuar materjalin qe sihte ne shtrati e kanalit, iakuzuari pretendonte se nuk jane ne gjendje dhe ne fund do t'ju dergojme, ne te vertet nuk dergonte, si konsekuence solli qe nje pjese e baltes mbeti ne kanal. Gjithashtu kane mbetur 1000 ml. dekovili.

2) Ky ishte besnik i fashizmit, sepse parullat plot vrer i kishte kundra puntoris qe punonte ne [illegible] te ligenit me vrull dhe me entusiazme.

3) Ka sabotuar funksionimin e motopompave t'ujtit. Solli si perfundim që te mos behen themelet dhe te punoj deri ne brez me uje te ftohet.

4) Ka sabotuar dy motore dritedhenes, i ka nxjerre jashte perdorimit dhe nuk i ka vene ne dijeni. Nuk i jepte drite kinemase per argetimin e punetoreve, me preteks se nuk punon motori.

PER ALEKS VASILIN:

1) Ka sabotur venien ne funksion motokompresorin per te bere [illegible]

AIDSSH

**Fletë nga mbrojtja në gjyq e znj. Zyrika Mano**



MBROJTJA E TË PANDEHURËS ZYRIKA MANO

Aktiviteti i zhvilluar prej të pandehurës në fjalë paraqitet në trajtat vijuese :

1) Është e vërtetë se ajo ka kryer disa herë shërbimin e ndërlidhjes të grupit sabotues të Maliqit me qendrën e tij në Tiranë.-
Karakteristike për këtë veprimtari të saj është se :

a) ajo nuk ka pasur lidhje direkte me planin teknik të sabotimit në vet-vehte ;

b) se aktiviteti i sipërshënuar i saj nuk ka qënë i domosdoshëm, dhe kjo vërtetohet me circonstancën se disa herë kur ju është paraqitur okazioni kryetarët e grupeve kanë bërë vetë punën e ndërlidhjes pa patur nevojë të rikurojnë në ndihmën e të pandehurës;

2) Nuk na duket i themeluar ngarkimi që i bëhet nga i pandehuri Pandeli Zografi që të ketë shërbyer njëkohësisht dhe si informatore, për këto dy shkaqe :

a) nuk konfermohet nga të pandehurit e tjerë,- kurse po të ishte me të vërtetë informatore ajo sigurisht do të kishte ngarkuer dhe të pandehurit e tjerë, si më të afërm që i kishte, për t'i sjellë informata.--Kjo nuk rezultoj n'asnjë mënyrë.--

b) sepse nuk kuptohet ç'farë interesi mund të përfaqsonte për mandantët e saj në Tiranë dijënija mbi faktin se kishin fituar motor nga personeli ose punëtorët e Maliqit,- duke u ditur se një komunikim me një përmbajtje të tillë do të ishte një auto-bluash për ta,- megjë të fitosh vetëm motër vetëm në një vend ku punojnë me mijëra punëtorë nuk përfaqson sigurisht një aktivitet i denjë për t'u vënë në dukje.-

Pra, meqë veprimtarija e saj zhvillohet në një sektor që nuk ka lidhje të drejtë me punët dhe ky është kufizuar në disa veprime xxxxxxxxxx të pakta dhe meqë nga ana tjetër nuk na rezulton i justifikuer ngarkimi që i bëhet si informatore,- duke përsëritur konkluzionet e përgjithshme kërkoj që ndëshkimi i saj të jetë në armoni me entitetin e vërtetë të veprës saj.--

Tiranë më 16 Nëntor 1946

Mbrojtës:

Av. Eftim [illegible]

**Fletë nga mbrojtja në gjyq e Eugenio Scaturo**



247

MBROJTJA E TË PANDEHURIT SCATURO EUGENIO

Veprimtarija e këtij të pandehuri përmban këto karakteri-stika :

1) ky bën pjesë nga ata që pësuan kontaminimin me anë të agjentave të kontagjionit,- me fjalë të tjera ky është një i kontaminuar i gradës së II-të.--

2) Sektori i aktivitetit tij, sigurisht me rëndësi,- në çdo rast nuk mund të krahasohet me rëndësinë e sektorëve të tjerë, që kishin të bënin drejt për së drejti me punimin e kanalit.--

Aktiviteti i zhvilluar prej tij në sektorin e Intendencës ka marrë proporcione modeste: ky vetë ka pohuar se kishte angazhuar 30 nëpunësa në shërbim të Intendencës, ndonëse puna mund të kryhej dhe me 10 ose 15 prej tyre.-

Duke e krahasuar këtë sabotim me atë të ndodhur në sektorët e tjerë të kantierit mund të afermohet se i pandehuri ka në aktivin e tij minimumin e "rendimentit sabotues".--

Se me të vërtet ky është realiteti këtë e dëshmojnë si pohimet e tija ashtu dhe mungesa një atribuimi kategorik ndaj këtij konkrete sabotimi si nga ana e të pandehurve të tjerë ashtu dhe nga ana e dëshmitarëve të akuzës të dëgjuar para Jush.-

Nuk është shënuar asnjë deklaratë nga ana e punëtorëve të kantierit në ngarkim të tij, sepse me të vërtet sabotimi i tij nuk ka pasur siç duket asgjë që t'a dallojë dhe të provokojë ankime nga ana e të interesuarve.-

Prandaj, për të gjitha këto, përsërisim konkluzionet e përgjithëshme dhe në lidhje me këtë të pandehur dhe duke marrë parasysh [illegible] e fajit tij, ju lutem të [illegible] për të dhe në konsideratë dhe të minimalitetit tij t'i caktoni një ndëshkim privimi të lirisë personale.---

Tiranë më 15 Nëntor 194[illegible]

Mbrojtësi :

Av. Eftim [illegible]

**Fletë nga mbrojtja në gjyq e Vasil Mano, Zyrika Mano, Pandeli Zografi dhe Eugenio Scaturo**

249

Mbrojtja e të pandehurve

VASIL MANO, ZYRIKA MANO, PANDELI ZOGRAFI dhe SCATURO EUGENIO

para Gjykatës së Naltë Ushtarake.-

---

Zotërinj Gjyqtarë,

Diskalimet publike të ketij gjyqi të rëndësishëm, që kanë mujë provokuar nji'a anë'anë Shqipërisë ( dhe me të drejtë ), dhe rezultatet e tyre na imponojnë ne, si mbrojtës të të pandehurve, një detyrë specifike.- Me të vërtet, mbasi fajtorija e tyre âshtë e padiskutueshme,- dhe këtë gjë nuk kanë mujtur t'a afermojnë vetë të pandehurit, të vilët jo vetëm pranuan në tjesën më të madhe faktet që ju ngarkohen, por cilësuan vetë aktivitetin e tyre duke e quajtur atë tradhëti kundrejt Popullit dhe Atdheut ose faj të rëndë;- ne të të tillin kushte e kemi si detyrën tonë në radhë të parë:

a) në analizim të kondita ve të lindjes të grupit sabotator të përbëra nga të pandehurit kryesorë, që do të thotë se ne do të orgëzojmë në së pari në anatominë e gjenezës të grupit sabotator,- dhe këtë do t'a bejmë me qëllim që të venë në dukje disa tipare karakteristike që konspiracionit të të pandehurve të cilat [illegible] në determinimin e përgjegjësisë kolektive të të pandehurve si bashkëpuntorë në veprën e sabotimit të punimeve të Maliqit.-

dhe në radhë të dytë :

b) në përcaktimin e pozicionit exakt që ka sejcili nga të pandehurit që mbrojmë në gjirin e grupit sabotues,- dhe këtë natyrë do t'a përmbushim duke fiksuar extremet e veprimtarisë individuale të sejcilit dhe në bazë të këtyre elementave të determinojmë pozitën që okupon çdo i pandehur në jerarkinë e përgjegjësisë personale të çdo pjestari të grupit nga i cili bënte pjesë.-

Ky mision i ynë bazohet në bindjen se ekziston efektivisht një shkallëzim në përgjegjësinë personale të të pandehurve sipas rolit që ka lojtur sejcili prej tyre dhe sipas karakteristikave të përgjithëshme të veprimtarisë së tij,- dhe na duket se caktimi i përgjegjësisë të sejcilit duhet të manifestohet dhe në sanksionin që do t'ji aplikohet individualisht sejcilit prej tyre.-

---

Duke vepruar me këto kritere, të hyjmë në analizën të detyrës parë. Në këtë pikëpamje imponohet qysh në fillim një e vërtetë themeltare : se formimi i grupit sabotator i detyrohet kontaktit të intervenuar ndërmjet dy faktorëve : njëri i përfaqësuar nga agjentët e reaksionit të huaj dhe tjetri nga pjestarët e grupit sabotues.-

Faktori i parë âshtë një element aktiv, fekondues,- ndërsa i dyti ka natyrë pasive dhe receptive.

Pa dyshim kontaminimi nuk do të ishte prodhuar sikur elementi aktiv të mos kishte gjetur terren adapt (të përshtatshëm) për kontaminimin në elementin parë,- dhe ky terren adapt ishte predispozimi i brëndëshëm i tyre për të pranuar në mënyrë të favorëshme ndikimin kontaminues të elementit parë.-

AIDSSH